Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9-11 (193-194) SHTATOR - NËNTOR 2022. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market

PESHKOPI MAQELLARË

Plot oferta dhe surpriza...

VENDLINDJA

Fushë Bulqiza – Katundi i enigmave, vendeve të shenjta...

Nga **ADRIATIK BALLA** — Faqe 14

PORTRET

Ibrahim Kolari, një jetë mes sfidash të fituara

Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 16

PROFIL

Hajri Shehu, filolog, përkthyes dhe leksikolog i vyer

Nga **AKAD. GJOVALIN SHKURTAJ** — Faqe 8-9

SUPLEMENT I GAZETËS "RRUGA E ARBËRIT"

Letrat e Arbërit

LIBËR I RI

100 personalitetet e gomarit të madh

Faqe 2

TRADITA POPULLORE

Alegoria nga Dibra

Faqe 3

TREGIM

Shejf e shkruej!

Faqe 6

Çarku

TREGIM

Ketë numër: Falas me gazetën "Rruga e Arbrit" edhe suplementi letrar "Letrat e Arbërit"

HEC I SKAVICËS: QEVERIA DHE BECHTEL VAZHDOJNË ME PLANET PËR NDËRTIMIN

Banorët vazhdojnë protestat: **Lugina e Drinit** të Zi **duhet të mbrohet**

- **Kryeministri Rama: Përfituesit më të mëdhenj nga Skavica do jenë ata që janë aty rreth e rrotull.**
- **KESH: Raporti i VNMS-së do të ndahet me komunitetet nëpërmjet dëgjesave të hapura publike përpara se të paraqitet për aprovim nga autoritetet.**
- **Bechtel kërkon financuesit e mundshëm të projektit të Skavicës apo nënkontraktorëve për të zhvilluar fazën e dytë të projektit**
- **Shoqatat mjedisore letër DFC: Qeveria Shqiptare nuk është konsultuar me mijëra qytetarët të cilët preken prej këtij projekti. Korrupsioni është një faktor që ndikon vendimarrje të tilla**
- **"Po Dibrës, Jo Skavicës", një nismë e cila u mbështet nga EuroNatur, organizoi takimet në të 32 fshatrat, të cilat mbulohen nga uji i Skavicës.**

Foto: KESH

OPINIONE&REPORTAZHE

RRUGA E ARBRIT, FLASIN DY NGA NISMËTARËT

20 arsye pse nuk duhet ndërtuar Skavica

Nga **prof. SAZAN GURI**

Projekti i Skavicës ndjell frikë dhe pasiguri në luginën e Drinit të Zi

Nga **HYSEN LIKDISHA / BIRN**

Hidrocentrali i Skavicës, projekti i kundërshtuar prej dekadash

Nga **ELONA ELEZI / DEUTSCHE WELLE**

Skavicë do të thotë mjegull, zymtësi, zhdukje e Dibrës së Poshtme

Nga **MAJLINDA HOXHA**

LEXONI SPECIALEN NË FAQET 5-12

Në foto: Bashkim Lleshi dhe Hysen Uka gjatë një ekspedite në terren, gusht 2013

Qeveritë kanë paguar 53 mln euro për Rrugën e Arbrit, para se të jepej koncesioni

Bashkim Lleshi: "Problemet gjeologjike në Rrugën e Arbrit nuk qëndrojnë, **politika nuk ka pasur vullnet për ta përfunduar**"

Hysen Uka: "**Rruga** aktuale **e Arbrit nuk është ajo çfarë kemi konceptuar** me bashkëpunëtorët"

Nga **SAMI CURRI**

LEXONI NË FAQET 3,4,13

NË BRENDËSI:

- **Liqeni i dashurisë...**
- **Identiteti ilir-arbëror** i kalabardhasve nuk është plaçkë tregu
- Në pritje të "**28 Nëntorit të Tretë**" – ditës së bashkimit etnik të shqiptarëve
- **Klodian Tanushi**, përjetësimi i heroit të paqes në shkollën 9-vjeçare Qesarak
- **Beqir Sina** në "Një biografi për dy kohë"
- Nderi i Kombit Margarita Xhepa në promovimin e poezisë së **Demir Rusit**
- "Kushtetuta e dheut të **Lurës**"
- **Çeta e Martaneshit**
- Nuk e dua lirinë duke hedhur poshtë bindjet e mia
- **Kajan Karafili**, e vërteta e origjinës dhe veprës së Heroit të Popullit
- **Abdulla Musa Hoxha** i Dibrës...
- **Kurt Zebi**, ushtaraku që ruajti deri në fund vlerat e larta të dibranëve
- **AGRON TUFA**: Paqja e përgjakur e Adamit

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 9-11 (193-195).
Shtator - Nëntor 2022
Gazeta doli nga shtypi, 28 nëntor 2022.
Gjendet në treg deri në fund muajit dhjetor 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sami CURRI
Hysen LIKDISHA
Elona ELEZI
Sazan GURI
Gjovalin SHKURTAJ
Enver HALILI
Majlinda HOXHA
Adriatik BALLA
Kadri DAUTI
Halil RAMA
Zabit LLESHI
Arif SHUTINA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Qeveritë kanë paguar **53 mln euro për Rrugën e Arbrit**, para se të jepej koncesioni

Para se të jepej me koncesion, qeveritë ndër vite kanë paguar rreth 6,5 miliardë lekë, ose 53 milionë euro fatura për ndërtimin e disa segmenteve në Rrugën e Arbrit.

Të dhënat, që burojnë nga Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave (lista shumëvjeçare e investimeve), tregojnë se thesari i shtetit ka paguar 6 fatura të ndara në lote sipas segmenteve të cilat janë paguar gjatë periudhës 2015-2017, para se segmenti të jepej me koncesion (shiko tabelën bashkëngjitur).

Të dhënat tregojnë se, financimet para se jepej koncesioni janë përfituar nga kompania "Gener 2" dhe "Gjoka Kontruksion", e cila më vonë fitoi edhe koncesionin mbi rrugën.

Kontrata e ndërtimit me koncension nisi në vitin 2018 dhe përfundon në vitin 2031, gjatë të cilit do të realizohet edhe gjithë pjesa e financimit nga qeveria.

Rruga e Arbrit është e gjatë rreth 73 kilometra, rreth 20 kilometra u ndërtuan me 6,5 miliardë lekë që u dhanë deri në vitin 2017, ndërsa 52 kilometrat e tjera që u dhanë me koncension kushtuan 36 miliardë lekë sipas të dhënave të përditësuara nga Ministria e Financave.

Para se të jepej me koncesion një kilometër në rrugën e Arbrit kushtoi mesatarisht 2,6 milionë euro, ndërsa me koncesionin rreth 6 milionë euro, ndërkohë që mbetet e papërfunduar ende vepra kryesore e rrugës, Tuneli i Murrizit.

Ashtu si edhe për koncesionet e tjera, fatura për rrugën e Arbrit, sidomos për koncesionin PPP nuk është ende e qartë, pasi Ministria e Financave raporton vlera të ndryshme vit pas viti.

Sipas raportimit më të fundit të Ministrisë së Financave është 36 miliardë lekë ose 297 milionë euro .

Kodi i projektit	**Segmente të rrugës së Arbrit të cilat kanë marrë pagesa nga buxheti i shtetit para se rruga të jepej me koncension**	fatura të paguara	Periudha e pagesës
M062126	Ndërtim i rrugës se Arbrit (seg.Ura e Brarit-hyrje tuneli)	2,332,157,398	2015
M062129	Ndërtim i rrugës se Arbrit (dalje ura e Vashë -Bulqizë)	1,589,458,582	2015
M062127	Ndërtim i rrugës se Arbrit (Ura e Vashës -Bulqizë shtesë punimesh)	764,339,042	2015
M062128	Ndërtim i rrugës se Arbrit (dalje Ura e Vashes -Bulqize)	725,961,852	2017
M062739	Ndërtim i rrugës se Arbrit (dalje ura e Vashë -Bulqizë) loti 2	597,628,290	2017
M062967	Ndërtim i rrugës se Arbrit (segm Ura e Brarit-Hyrje Tuneli)	466,302,975	2017
	Totali	6,475,848,139	

Pagesat e kryera në vite. Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Thesarit

> Ashtu si edhe për koncesionet e tjera, fatura për rrugën e Arbrit, sidomos për koncesionin PPP nuk është ende e qartë, pasi Ministria e Financave raporton vlera të ndryshme vit pas viti. Sipas raportimit më të fundit të Ministrisë së Financave është 36 miliardë lekë ose 297 milionë euro .

Në raportin vjetor të koncesioneve 2020, që u hartua nga Ministria e Financave, vlera e investimit për ndërtimin e Rrugës së Arbrit raportohet 26 miliardë lekë, ndërsa Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave (projektet e investimeve) për arsye të pagesave e ka kontabilizuar kontratën e Rrugës së Arbrit me 39 miliardë lekë në vitin 2020. Në buxhetin e vitit 2019 Ministria e Financave e pat raportuar financimin e Rrugës së Arbrit në 58 miliardë lekë në projektbuxhetin që paraqiti në parlament.

Rruga e Arbrit ka një historik të gjatë zvarritjeje që nga koha e qeverisë "Berisha" ku në disa pjesë të saj ishin kryer punime. Kur nisi koncensioni ishin përfunduar plotësisht 20.12 kilometra të saj, me 15.1 kilometra shtesë të përfunduara pjesërisht dhe 26.3 kilometra të tjera për t'u ndërtuar sipas projektit ekzistues. /B.Hoxha

Marrë nga www.monitor.al

Tender për skarpatet, 20 milionë euro shtesë për Rrugën e Arbrit

> Bashkë me kontratat e supervizimit për këto tendera, kap një vlerë prej afro 20 milionë euro. Në termat e referencës, thuhet se koha e nevojshme për përfundimin e punimeve është katër muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Pas më shumë se afro 10 vite, në trasenë e rrugës së Arbërit nga qafa e Buallit në Bulqizë deri tek ura e Vashës në Klos, punimet kanë nisur sërish. Tenderi për këtë pjesë të rrugës së Arbërit u mbyll pak ditë më parë, fituar nga bashkimi i kompanive Selami, Riviera 2008 dhe Garden Line. Sistemimi dhe rivitalizimi i skarpateve në Planin e Bardhë do ti kushtoj buxhetit të shtetit afro 10 milionë euro shtesë (pa tvsh). Po me një vlerë të tillë është edhe tenderi për segmentin në shkallën e Tujanit, Tiranë.

Në total, bashkë me kontratat e supervizimit për këto tendera, kap një vlerë prej afro 20 milionë euro. Në termat e referencës, thuhet se koha e nevojshme për përfundimin e punimeve është katër muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Rruga e Arbërit është e gjatë afro 72 kilometra, rreth 20 kilometra u ndërtuan me 6,5 miliardë lekë që u dhanë deri në vitin 2017, ndërsa 52 kilometrat e tjera që u dhanë me koncension kushtuan 36 miliardë lekë sipas të dhënave të përditësuara nga Ministria e Financave.

Para se të jepej me koncesion një kilometër në rrugën e Arbërit kushtoi mesatarisht 2,6 milionë euro, ndërsa me koncesionin rreth 6 milionë euro, ndërkohë që mbetet e papërfunduar ende vepra kryesore e rrugës, Tuneli i Murrizit.

Para se të jepej me koncesion, qeveritë ndër vite kanë paguar rreth 6,5 miliardë lekë, ose 53 milionë euro fatura për ndërtimin e disa segmenteve në Rrugën e Arbërit. Por me ndryshimet e fundit, vlera për ndërtimin e rrugës së Arbërit, në total parashikohet të shkojë në 400 milionë euro.

bulqizaime.al

Na ndiqni:
RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres
www.rrugaearberit.com
Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

intervistë

Prof. dr. Bashkim Lleshi, një ndër autorët e studimit të fizibilitetit, flet për problematikat e ndërtimit të Rrugës së Arbrit.

“Problemet gjeologjike në rrugën e Arbrit nuk qëndrojnë, **politika nuk ka pasur vullnet për ta përfunduar”**

Nga SAMI CURRI / bulqizaime.al

Një prej studiuesve të të gjithë formacioneve shkëmbore dhe gjeologjike nga kalon gjurma e rrugës së Arbërit, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, hodhi poshtë pretendimet e Kryeministrit Rama se problemet gjeologjike në tunelin e Murrizit, kanë qenë arsyeja për zvarritjen e punimeve. Në intervistën për Bulqizaime.al, Lleshi thotë se gjurma e ndërtimit të rrugës ka devijuar nga projektet fillestare, duke rritur në këtë formë edhe koston. Ai thekson se zvarritja e punimeve prej dy dekadash, tregon se politika nuk ka pasur vullnet për ta përfunduar, por ta shfrytëzojë në zgjedhje për vota, si partitë nga e majta ashtu edhe djathtas. Pak ditë më parë Autoriteti Rrugor Shqiptar njoftoi shpalljen e dy procedurave të tjera tenderuese lidhur me rrugën e Arbërit. Konkretisht ajo për sistemimin dhe rivitalizimin e skarpateve në Planin e Bardhë dhe në Shkallën e Tujanit, ku bashkë me kontratat e supervizimit për këto tendera, kap një vlerë prej afro 20 milionë euro – duke e çuar koston e rrugës në afro 350 milionë euro. Sipas Lleshit, punimet e kryera në rrugën e Arbërit nuk janë cilësore dhe në shumë segmente është dëmtuar.

Prof. Bashkim Lleshi gjatë një vëzhgimi të pavarur në terren gjatë fazës së kryerjes së punimeve

Z. Lleshi, jeni ndër personat e parë që keni punuar për ndërtimin e rrugës së Arbërit, por gjithashtu edhe një zë i vazhdueshëm në opinionin publik për zvarritjen e punimeve. Mund të më thoni shkurtimisht një kronologji të ndërtimit të rrugës së Arbërit?

Kemi folur gjatë në media, artikulli më i fundit është një kronologji e premtimeve duke nisur që nga studimi i fizibilitetit në vitin 2003 e me atë se çfarë po bëhet sot, botuar në gazetën “Rruga e Arbërit” nga Bujar Karoshi. Dua të them se që prej vitit 1996 është derguar një peticion drejtuar qeverisë për ndërtimin e rrugës së Arbërit. Në vitin 2003 përfundoi Studimi i Fizibilitetit (SF)i cili u miratua në korrik të vitit 2004 në Këshillin Kombëtar të Rrugëve (KKR) që drejtohej nga kryeministri, Fatos Nano. Në vitin 2004 presupozohej se do të fillonin projektet teknike me segmente të veçanta gjithashtu edhe fillimin e punimeve, por këto projekte nuk filluan. Vetëm 20 ditë para zgjedhjeve të vitit 2005 në dalje të Bulqizës, vihet një tabelë e madhe ku thuhej se filloi ndërtimi i rrugës së Arbërit, “Bulqizë-ura e Çerenecit”, ndërkohë që nuk kishte filluar puna për përpilimin e projektit teknik me studime të detajuara gjeologjike për gjurmën se ku do të kalonte rruga. Pas përfundimit e miratimit të projektit teknik jepet detyra për fillimin e ndërtimit të rrugës. Projektet teknike çojnë në përmirësimin e aksit të miratuar në Studimin e Fizibilitetit, por jo në ndryshime të mëdha të Sudimit të Fizibilitetit të miratuar në KKR. Por të bësh detajime për çdo segment ose vepra të caktuara. Por siç dukej ajo nuk u mor aspak seriozisht.

> Ky investim i rëndësishëm është kthyer në rrugë politike dhe premtimesh elektorale për vota, si majtas dhe djathtas. Vetë zvarritja tregon se politika nuk ka pasur vullnet për ta përfunduar. Së pari që kur u fillua ndërtimi nga Bulqiza deri në urën e Çerenecit, duhet të themi që ishte rikonstruksion i rrugës ekzistuese dhe nuk është rruga e Arbërit. Fondet janë dhënë për të bërë rrugë me trase të re me parametra evropiane. Gjurma në Studimin e Fizibilitetit ishte në anën e majtë të Zallit të Bulqizës.

Investuar kaq gjatë në rrugën e Arbërit bashkë me shumë të tjerë, kur kaluat për herë të parë pasi u hap për qarkullim, çfarë ndjesie kishit? Ishte ashtu siç ju e kishit menduar?

Ajo rrugë nuk plotëson standardet e një rruge europiane, jo vetëm e pa përfunduar, por ka ngelur copë-copë. Është fatkeqësi që ky investim i rëndësisshëm të jetë në këtë gjendje. Kjo rrugë duhej të kishte përfunduar brenda një mandati. Studimi i fizibilitetit ka mbaruar në vitin 2004 dhe deri në vitin 2009 ajo rrugë do të duhej të kishte përfunduar. Por është fakt që ka 20 vite që po zvarritet ndërtimi. Ky investim i rëndësishëm është kthyer në rrugë politike dhe premtimesh elektorale për vota, si majtas dhe djathtas. Vetë zvarritja tregon se politika nuk ka pasur vullnet për ta përfunduar. Së pari që kur u fillua ndërtimi nga Bulqiza deri në urën e Çerenecit, duhet të themi që ishte rikonstruksion i rrugës ekzistuese dhe nuk është rruga e Arbërit. Fondet janë dhënë për të bërë rrugë me trase të re me parametra evropiane. Gjurma në Studimin e Fizibilitetit ishte në anën e majtë të Zallit të Bulqizës. Edhe kur u bënë projektet e zbatimit, ndërtimin e rrugës e filluan po aty ku e nisi Fatos Nano, pa projekt teknik të miratuar. Në atë kohë i dërgova një letër ministrit të atëhershëm të Infrastrukturës, Lulzim Basha – edhe si dibran – për ti thënë se rruga po fillonte aty ku nuk duhej të fillonte, pasi gjurma e SF e miratuar e miratuar edhe në KKR ishte në krahun tjetër të luginës. Pjesa nga përmendorja e Skënderbeut në Vajkal dhe deri në Fushë-Bulqizë është në hije dhe gjatë dimrit bëhet shumë e rrezikshme. Së dyti, kur kalon urën e Qytetit, rruga nuk duhej të kalonte në drejtim të Godvisë, por të ndiqte krahun e majtë të zallit të Bulqizës deri tek tre Çezmat e Zerqanit.

Ndryshimet në qeveri në vitin 2013-të, sollën premtime të reja nga Kryeministri Rama, sipas jush sa seriozisht u mor ndërtimi i rrugës?

Premtimet kanë qenë të mëdha, por në zbatim jo. Pasi përfundoi keq rruga nga Bulqiza në Çerenec, filloi ndërtimi i tunelit në qafë të Buallit. Ju deshën katër ose pesë vite punë dhe zvarritje për të përfunduar një tunel afro 460 metra. Në Studimin e Fizibilitetit (SF) tuneli i Qafës së Buallit ishte projektuar e miratuar 850 metra. Pas shumë diskutimesh për t’a kaluar Qafën e Buallit me tunel apo pa tunel, filloi hapja e këtij tuneli në vendin më të keq të mundshëm, pa projekt teknik, jo aty ku ishte miratuar. Edhe një minatori që ka punuar në gjeologji ose minierat e Bulqizës, po ti thuash a hapet tuneli këtu do të thoshte që nuk hapet. Fillimi i punës për ndërtimin e këtij tuneli nuk mund ta bëhej nga një specialist, pa patur të miratuar studimin gjeologo-inxhinierik të detajuar në aksin e tunelit me shpimet gjeologjike përkatëse për gjatë aksit. Me qënëse shpimet gjatë aksit të tunelit nuk janë kryer të paktën të shfrytëzoheshin të dhënat e shpimeve të gjeologjisë së Bulqizës të kryer në objektin e kromit të Qaf Buallit, të cilët janë kryer aty ku ishte parashikuar tuneli në SF me gjatësi 850m. Pa studimin gjeologo-inxhinierik të nevojshëm tuneli u spostua dhe u ngrit më lart, kjo gjoja për të kursyer qeverinë në dëm të cilësisë. Rruga do të duhej të kalonte poshtë varrezave të Bulqizës, por e ngritën tunelin 20 metra dhe bën një gërmim në formë useku mbi 300 metër sipër varrezave, një batërdi që nuk t’a merr mendja se si mund të veprohet ashtu me papërgjeshmëri. Kjo sepse u zgjerua me shpejtësi edhe dampa e fabrikës në drejtim të lindjes aty ku duhet të fillonte hyrja e tunelit.

Kanë kaluar afro 10 vite që kur punimet në trasenë nga qafa e Buallit deri tek ura e Vashës kanë përfunduar. Pak ditë më parë ARRSH, njoftoi se ka shpallur dy procedura tenderuese me afro 20 milionë euro të tjera për skarpatat në këtë segment dhe në Shkallën e Tujanit. Ju si e komentoni një zvarritje të tillë?

> Lidhur me Urën e Vashës, edhe kur nuk mungonin studimet dhe teknologjia e sotme, para 200 vitesh, lumi u kalua me urën e ndërtuar me harqe prej guri, aty ku ishte pjesa më e ngushtë e lumit. Ndërsa sot, megjithëse duhet të kryejmë studimin gjeologo-inxhinierik të detajura për ndërtimin e Urës, atë e ndërtojmë aty ku është lugina më e gjërë.

Ndërtimin e tunelit të Qafës së Buallit dhe segmentin nga Plani i Bardhë deri tek Ura e Vashës e ka kryer po firma Gjoka. Pra supozohej që kjo kompani do të duhej ta kishte dorëzuar këtë segment. Por në fakt jo vetëm që nuk u dorëzua, por u la për t’u shkatërruar. Lidhur me Urën e Vashës, edhe kur nuk mungonin studimet dhe teknologjia e sotme, para 200 vitesh, lumi u kalua me urën e ndërtuar me harqe prej guri, aty ku ishte pjesa më e ngushtë e lumit. Ndërsa sot, megjithëse duhet të kryejmë studimin gjeologo-inxhinierik të detajura për ndërtimin e Urës, atë e ndërtojmë aty ku është lugina më e gjërë. Po të kryhej studimi gjeologo-inxhinierik i aksit ku do të vendosej ura, aty ku ishte miratuar në Studimin e Fizibilitetit, mbi urën me harqe guri të Vashës, aty ku lugina e lumit është më e ngushtë, kjo urë do të ndërtohej ndoshta me gjysmën e shpenzimeve. Në SF nuk ishte parashikuar të ndërtohej një urë tjetër e madhe si ajo e fshatit Fshat, por do të ndërtohej një tunël në perëndim të Gurit të Bardhë dhe rruga do të dilte në luginën poshtë Xibër Murrizës, duke eliminuar dhe tunelet matanë Urës së Fshatit, si dhe deformimet që ka pësuar rruga në këtë pjesë të luginës. Më vjen keq kur e shoh rrugën në atë gjendje. Ato deformime në trasenë e rrugës në Xibër do të eliminoheshin po të ishin marrë masat e nevojshme dhe të ishte bërë studimi i detajuar i rrugës. Por sot për ta vënë për vije këtë pjesë të rrrugës kërkohen ndoshta dyfishi i shpenzimeve.

Tunelin e Murrizit e dëgjojmë vazhdimisht nga Kryeministri Rama dhe drejtues të tjerë të qeverisë të thonë se ka probleme gjeologjike, çfarë ka sjellë vonesë në përfundimin e rrugës. Sipas jush, sa qëndrojnë këto arsyetime?

Çështja e tunelit të Murrizit ka qenë kryesorja që ka pasur edhe debatet më të mëdha. Në SF ka qenë projektuar në 3.4 km gjatësi. Por të dhënat për kryerjen e SF janë marrë duke ndërtuar profilin e tunelit nga harta dhe me vrojtime sipërfaqësore, ndërsa studimi gjeologo-inxhinierik i detajuar me shpime gjatë aksit të tunelit do të jepte një tabllo të saktë të formacioneve që do të përshkojë tuneli. Mungesa e një studimi të tillë gjeologo-inxhinierik ka çuar që para vitit 2014-të në diskutime për ngritjen e tunelit 200 metra sepse ka probleme gjeologjike dhe sasi të mëdha të ujit etj. etj. Në fakt teknikisht ato nuk qëndrojnë sepse formacionet e tunelit të Murrizit në afro 80% të gjatësisë janë në shkëmb gëlqeror pllakor të çimentuar, masiv dhe pa prishje tektonike. Minatorët tanë kanë bërë tunele si ai nga Klosi në Bulqizë prej afro 14 km që janë dy tunele paralel dhe me

(vijon në faqen 13)

Rruga e Arbërit nr. 193-195

“Rruga aktuale e Arbërit nuk është ajo çfarë kemi konceptuar me bashkëpunëtorët

Rruga e Arbërit nuk është menduar si një rrugë lokale, si një rrugë vetëm për Dibrën. Kur e ngushtojmë konceptin për rrugën e Arbërit, thjeshtë dhe vetëm për Dibrën do të thotë se ne nuk e kemi kuptimin e plotë për idenë fillestare të nismëtarëve për këtë projekt. Rruga e Arbërit fillon nga buza e detit Adriatik, njësohet me segmentin e autostradës Durrës – Tiranë, e cila konsiderohet nga ne si pjesë e rrugës së Arbërit, vazhdon në lindje të Tiranës, depërton qafën e Murrizit, përshkon luginën e Planit të Bardhë, luginën e Bulqizës, grykën e Radikës dhe përfundon atje ku kyçet në Korridorin e Tetë në Izvor (Kërçovë) ose në fushën e Pollogut.

Nga SAMI CURRI / bulqizaime.al

Një nga nismëtarët e idesë për ndërtimin e rrugës së Arbërit, Hysen Uka, tregon se ajo çfarë sot konsiderohet si rruga e Arbërit, nuk është ashtu siç e kishin konceptuar me bashkëpunëtorët. Në intervistën për Bulqizaime.al, Uka shprehet se për rrugën e Arbërit nuk janë bërë studime fizibiliteti dhe një projekt inxhiniero-teknik i detajuar për ndërtimin me standardet aktuale evropiane. Mungesa e transparencës dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile nga kompania ndërtuese, për Ukën, tregon një mendësi feudale në kryerjen e punëve.

Jeni ndër nismëtarët e idesë për ndërtimin e rrugës së Arbërit. Po të kthehemi pas në kohë, kur flitej për ndërtimin e rrugës, çfarë synonte ajo? Ishte një rrugë vetëm për Dibrën, Bulqizën dhe Matin apo si rrugë lidhëse për rajonin?

Ka nevojë për një sqarim rreth të kuptuarit të projektidesë fillestare mbi rrugën e Arbërit. Rruga e Arbërit nuk është menduar si një rrugë lokale, si një rrugë vetëm për Dibrën. Kur e ngushtojmë konceptin për rrugën e Arbërit, thjeshtë dhe vetëm për Dibrën do të thotë se ne nuk e kemi kuptimin e plotë për idenë fillestare të nismëtarëve për këtë projekt. Rruga e Arbërit fillon nga buza e detit Adriatik, njësohet me segmentin e autostradës Durrës – Tiranë, e cila konsiderohet nga ne si pjesë e rrugës së Arbërit, vazhdon në lindje të Tiranës, depërton qafën e Murrizit, përshkon luginën e Planit të Bardhë, luginën e Bulqizës, grykën e Radikës dhe përfundon atje ku kyçet në Korridorin e Tetë në Izvor (Kërçovë) ose në fushën e Pollogut. Rruga e Arbërit është një e tërë në konceptin tim dhe nuk mund të segmentohet e sakatohet, si nismëtar e kam konceptuar pikërisht në këto përmasa dhe në këtë funksion, si një kordon jetësorë që do të lidhte e do rijetësonte dy pjesë të ndara politikisht të shqiptarëve; shqiptarëve të Shqipërisë dhe të shqiptarëve në pjesën perendimore të FYROM-it (sot Maqedonia e Veriut).

Rruga e Arbërit po u trajtua si një çështje vetëm për Dibrën do të thotë se askush nuk ka kuptuar qëllimin dhe karakterin strategjik të projektidesë fillestare. Unë këtë ide e kam formësuar dhe e kam shpallur më 9 tetor 1995, në Radio Tirana, atëherë si korrespondent terreni i saj për Dibrën. Me që më jepet rasti në këtë intervistë tuajën, dua të theksoj se Radio Tirana, si e vetmja media radiofonike në atë kohë, ka transmetuar vazhdimisht radiokronika, për të gjithë hapësirat shqiptare brenda dhe jashtë, duke e bërë të njohur dhe duke promovuar këtë ide. Kjo ishte arsye që nisma u “përqafua” shumë shpejt edhe nga gazetarë në Dibër të Madhe, pasi ata e kuptonin dhe e kishin ëndërruar lidhjen e komunikimin me Tiranën e Durrësin, një lidhje historike të ndërprerë dhunshëm nga politika me aneksimin e trojeve nga fqinjët. Ata sikur mezi e kishin pritur një nisëm të tillë, që shqiptarëve të Maqedonisë t’u hapej dera e daljes së natyrshme në detin Adriatik. Rruga e Arbërit, përmbushte dhe realizonte pikërisht këtë aspiratë të tyre; përmes këtij projekti strategjik të infrastrukturës rrugore, rrëzoheshin muret ndarëse, çliroheshin hapësirat e rivendosej komunikimi në kohët moderne midis trojeve të tyre, si një tërsi e natyrshme në mbarë hapësirat shqiptare; Durrës, Tiranë, Gostivar, Tetovë (Lugina e Pollogut), Kërçovë, në Maqedoninë e Veriut.

Rruga e Arbërit nuk është një rrugë thjeshtë dhe vetëm për Dibrën, është keqkuptim e gabim i madh të trajtohet si ide e projekt i tillë. Pagëzimi me emrin që ka sot rruga, nuk njihet dhe nuk gjendet në dokumentohet historike. Nuk ka asnjë dokument ku emërtohet rruga e Arbërit. Por ky pagëzim përmban dhe shpreh idenë dhe qëllimin e projektit, të lidhura me terrenin topografik ku konkretizohet ideja. E kemi pagëzuar me këtë emër, për faktin se ajo gjendet në territoret e Arbërisë mesjetare, përshkon mes për mes tokate Arbërore, nga bregdeti në Durrës e deri në kufijtë e Arbërisë mesjetare. Duhet të kuptohet se ka edhe një spekulim që nuk është pjesë e rrugës “Via Egantia”. Ai që e njeh mirë traktin se nga kalon rruga Egnatia në të katërta portat e arta për të përfunduar në Stamboll e din që nuk ka lidhje. Kjo është një rrugë që lidh territoret Arbërore – Principata e vjetër e Arbërit që i shkon mes për mes dhe për këtë arsye është pagëzuar edhe me emrin rruga e Arbërit. Pasi kalon mes për mes trojeve Arbërore, prandaj e meriton që të quhet e tillë.

Premtime shumë, punë pak. Janë me miliona euro të shpenzuara deri më sot për këtë vepër, por në terren kemi një situatë zhgënjyese, nëse mund të them kështu. Kampet politike sa mbështetëse kanë qenë për një ide të tillë?

Fillesat e rrugës, kanë qenë angazhimi im me disa shokë në Peshkopi. Aty ku lind problemi lind edhe nevoja për një zgjidhje. Banorët e Dibrës ishin përdorues të rrugës për të shkuar në Tiranë, një lodhje e përditshme dhe përhershme që na kishte munduar dhe për këtë arsye ne e strukturuam dhe e promovuam nismën. Politika në fillesat e para ka qenë mohuese ndaj kësaj ideje. Madje para disa kohësh të njëjtin qëndrim që ka pasur në prill të vitit 1996, Dashamir Shehu në cilësinë e zv-ministrit e ka shprehur edhe vjet në tetor në cilësinë e deputetit. Duke e quajtur rrugën e Arbërit një investim të pa nevojshëm. Se nuk është e nevojshme të shpenzohen gjysmë miliardi euro për një rrugë ku njerëzit po ikin. Për Shehun dibranët duhet të përfitojnë nga liria për të lëvizur. Ky nuk e kupton rrugën e Arbërit siç është në thelbin e vet, që të lidhi shqiptarët e Maqedonisë me bregdetin e Shqipërisë. Aspektin politik dhe rëndësinë strategjike që ka kjo rrugë. Të gjitha ata që e nxjerrin rrugën e Arbërit nga ky kontekst dhe e nxjerrin si një rrugë që lidh Dibrën, Bulqizën, Klosin dhe Matin, do të thotë se nuk kanë kuptuar thelbin e projektit. Edhe në hartimin e studimit të fizibilitetit nga studio e Faruk Kabës, ka pasur një vëzhgim të cunguar edhe pse ne ja kemi kërkuar si shoqatë me insistim që rruga të shikohej në të gjithë dimensionin e vet. Në atë kohë u vendos në dispozicion një studio nga Shkupi, në pronësi të një shqiptari, Shefki Haliti i cili vuri në dispozicion studion e tij që të bashkëpunonte me institucionet shqiptare dhe të studiohej e të projektohej në tërësi rruga e Arbërit nga fillesat dhe deri aty ku kyçej në korridorin e tetë. Politika në fillim ka qenë shumë skeptike, duke mos e pranuar. Po në vitin 1996, pas insistimit të dibranëve dhe drejtuesve lokal, Sali Berisha e ka përmendur se ky projekt duhet pranuar dhe studiuar.

Sot teorikisht nga qeveria thuhet se rruga e Arbërit është e hapur për kalim. Është kjo rruga e pritshmërive tuaja? E kishit menduar se do të ndërtohej me të tillë kushte që janë sot?

Figurativisht, kjo është si një lindje pas një pritje të gjatë. Nëse një nënë jeton pritjen e ëmbël, duke përfytyruar fëmijën e saj të bukur, engjëllor, plotë dritë... por kur asaj i vënë në dorë të shohë fëmijën, lumturinë e saj e kaplon trishtimi nëse fëmija lind me probleme shëndetësore. E megjithatë ajo, edhe ashtu do të dojë me gjithë shpirt tërë jetën fëmijën e saj, deri në frymën e fundit. Edhe rruga kështu ka ngjarë, në jemi të lumturuar që u lind, por me shumë probleme. Edhe kështu si është ne e duam. Rruga aktuale nuk është ajo çfarë unë dhe bashkëpunëtorët e mi kemi konceptuar dhe menduar, si në aspektin e zgjidhjeve inxhinjerike, përmasave, ritmit të lëvizshmërisë dhe efekteve ekonomike, aktualisht në kemi të prekshëm vetëm një gjysmë projekti, nga projekti i plotë (si vizion strategjik), pasi ende nuk ka filluar ndërtimi i rrugës në Maqedoninë e Veriut. Unë e shoh idenë time sot të paplotësuar.

Përgjegjësitë fillojnë që në studimin e fizibilitetit nga studio e inxhinierit Faruk Kaba. Nisur nga qëllimi i tij i mirë, z. Poçi i’a besoi realizimin e studimit, ish-shoku të tij të fakultetit, dibran nga origjina, studios së Ing. Faruk Kaba. Në fillimin të marsit të vitit 2003, ministri Spartak Poçi, ftoi një përfaqësi të shoqatës “Nisma Dibrane”, që kish lobuar, punuar, promovuar idenë, në kabinetin e tij dhe na dha lajmin e gëzuar: qeveria ka ndarë një fond 120 mijë dollarë për studimin e fizibilitetit dhe se studimin do ta bëjë studio e Kabës. Unë njihesha me të pasi në nëntor 2001, i kisha dorëzuar një dosje të tërë me të gjithë punën në terren dhe hartën 1:2500 m ku paraqitej grafikisht skicë ideja e rrugës, shumë foto të shoqatës nga ekspeditat njohëse në terren, korrespondencën e Këshillit të Rrethi të Prefekturës dhe Bashkisë Dibër me Qeverinë Shqiptare ndër vite, si dhe shumë dokumente të tjera. Z. Kaba nuk e ka përmendur asnjëherë këtë fakt. Ky studim fillestar kishte shumë mungesa në themel, ku më kryesori sipas meje ishte moskoordinimi dhe mos komunikimi më studion e projektimit nga shqiptarët në FYROM (Maqedonin e Veriut). Për ilustrim të asaj se çfarë Z. Kaba ka punuar, mjafton të shohim cilësinë e zgjidhjeve inxhinierike dhe të realizimit në segmentin e rrugës së Arbërit nga qafa e Buallit tek ura e Çerenecit, (për të cilin janë shpenzuar mbi 17 milionë euro), i cili është vetëm përmirësim i rrugës së vjetër.

Thuhet vazhdimisht se problemet gjeologjike e kanë zvarritur kaq gjatë përfundimin e rrugës. Në intervistën me Prof. Dr. Bashkim Lleshi, hodhi poshtë një pretendim të tillë. Sa seriozë kanë qenë kompanitë e përzgjedhur nga qeveria për të kryer punimet në një vepër kaq të rëndësishme që lidh Shqipërinë me Maqedoninë e veriut?

Njerëzit që kanë synuar të marrin këtë copë të madhe investimi, pa patur kapacitete inxhiniero-teknologjike, kanë improvizuar mbi projektin. Për të të mos cënuar fitimin

(vijon në faqen 13)

- **“Banorët e zonave që preken direkt apo indirekt nuk kanë patur në asnjë moment mundësinë për t’u shprehur ndaj këtij projekti”**
- **“Po Dibrës, Jo Skavicës”, një nismë e cila u mbështet nga EuroNatur, organizoi takimet në të 32 fshatrat, të cilat mbulohen nga uji nëse ndërtohet diga e HEC-it Skavica.**

Banorët: Lugina e Drinit të Zi duhet të mbrohet

Nga **Hysen LIKDISHA**

Pamje nga takimet në Muhurr. Foto: Hysen Likdisha

Vijojnë protestat e dibranëve kundër ndërtimit të HEC-it në luginën e Drinit të Zi. Në të njëjtën kohë gjatë muajit Tetor 2022 janë zhvilluar disa takime me dhjetëra banorë, të cilët preken direkt nga ndërtimi i digës së Skavicës.

“Po Dibrës, Jo Skavicës”, një nismë e cila u mbështet nga EuroNatur dhe u zbatua nga organizata mjedisore “North Green Association”, organizoi takimet në të 32 fshatrat, të cilat mbulohen nga uji nëse ndërtohet diga e HEC-it Skavica.

Kjo nismë, përtej takimeve, ka bashkëpunuar me ekspertë të fushave të ndryshme për të nxjerr në pah disa të dhëna shkencore për ti publikuar. Gjithashtu, një fushatë ndërgjegjësuese në mediat dhe rrjetet sociale do të jetë e vazhdueshme.

Takimet, ku veç banorëve të zonës, morën pjesë edhe të shpërngulur për arsye të ndryshme në zona tjera të vendit, intelektualë etj, u hapën nga Edi Truka, drejtori ekzekutiv i organizatës “North Green Association” që zbaton projektin

Takimet e organizuara kishin një risi nga takimet e tjera të organizuara më parë. Një ndër to ishte prezantimi mjaft domethënës me video-projektor, ku shfaqeshin pasojave negative në të gjithë rajonin e Arbërit nëse do të ndërtohet projekti i HEC-it Skavica. Kjo mënyrë e përzgjedhur nga organizata mjedisore NGA, ishte për të përçuar më në detaje informacionet tek banorët e zonave, në mënyrë që ato të ishin të vetëdijshëm përtej fakteve sipërfaqësore të dëgjuara. Kjo do t’i ndihmojë ato të jenë të kujdesshëm në momentet kurë përfaqësues/kontraktues të kompanive të ndryshme do të shfaqen për të realizuar dëgjesat publike.

Duhet theksuar që në takime, përveç banorëve të zonave, aktivistë, organizata lokale ishin prezent edhe intelektualë të profesioneve të ndryshme që kontribuan në forcimin e mëtejshëm të frontit kundër projektit që zhduk Dibrën.

Edi Tuka, në fjalën e tij, renditi disa nga rreziqet kryesore që mbart me vete një projekt i tillë si: humbje direkte dhe të vazhdueshme të biodiversitetit, me rezultat final, zhdukjen e specieve të florës dhe faunës; rrezikohen dhe zhduken fauna e egër, një ndër to specia në mbrojtje si Reqebulli i Ballkanit; me ndryshimin e mikroklimës rrezikohen dhe zhduken të gjitha speciet në librin e kuq, por edhe mbi 70 përqind të bimëve autoktone medicinale dhe bujqësore, ; humbet prodhimtaria e tokave bujqësore që e kërkon e gjithë Shqipëria; shkelen dhe nuk zbatohen aspak strategjitë e miratuara për zhvillimin e qëndrueshëm të Dibrës; ndryshimi i mikroklimës shkatërron përfundimisht potencialin e jashtëzakonshëm turistik në të gjithë zonën sëbashku me pjesën e fundit të mbetur dhe më e bukur të lumit Drinit të Zi etj.

Edi Truka pohoi se për këtë projekt kaq të rëndësishëm, është bërë me ligj të posaçëm në parlament dhe ku kompania është e paracaktuar, duke mos bërë asnjë tender ndërkombëtar të hapur. Gjithashtu, nuk është bërë apo miratuar asnjë dokument nga autoritete vendore që është “pro” apo “kundër” këtij projekti, duke iu referuar ligjit për autonominë vendore të vitit 2015.

“Banorët e zonave që preken direkt apo indirekt nuk kanë patur në asnjë moment mundësinë për t’u shprehur ndaj këtij projekti”, thotë Truka, duke e quajtur edhe abuziv deklarimet e qeveritarëve se “HEC-i Skavica do të ndërtohet nga Amerika”.

Majlinda Hoxha, koordinatore e projektit “Po Dibrës, Jo Skavicës”, thotë për gazetën “Rruga e Arbërit”, se deri më tani nuk kemi asnjë info për këtë projekt.

“Qeveria nuk ka bërë një studim të mirëfilltë, që të merrte për bazë mendimin e banorëve për humbjen e identitetit nga shpërngulja, mbytja e zonës më të shëndetshme historike dhe cënimi i pronës private nga mbytja e një të tretës së të territorit të Bashkisë Dibër”, thotë aktivistja Hoxha.

“Shumë njësi administrative në këtë bashki si Zall-Reçi, Zall-Dardha, Arrasi dhe Lura, nuk do të kenë akses të drejtpërdrejtë lidhje me Dibrën”, thekson Hoxha. Sipas saj, “një projekt i tillë do të ketë ndikim social-ekonomik, jo vetëm për fshatrat që shpërngulen, por edhe për të gjithë fshatrat e Dibrës së Poshtme, pasi mbulohet nga uji pjesa më e begatë e Luginës së Drinit të Zi. 32 fshatra humbin lidhjen direkte me Peshkopinë, si dhe “mbytet” trashëgiminë kulturore –historike 3000 vjeçare”.

“Nuk duhet të na shkojë ndër mend, - thotë koordinatorja e projektit Majlinda Hoxha, - se mund të ketë dibran, që të pranojë të diskutojnë për të shitur me çfarëdollojë çmimi, sado të lartë, trojet e të parëve, që na i kanë lënë trashëgim”.

Në lidhje me këtë projekt, Hoxha thotë se “nuk është marrë dakordësia e banorëve dhe sa i takon fillimit të punimeve, na është thënë se vetëm po kryhen disa punime për studimin e fizibilitetit “.

BANORËT KUNDËRSHTOJNË PLANET E QEVERISË PËR NDËRTIMIN E SKAVICËS

Në këto takime mjaft të irrituar janë edhe banorët. Ata kundërshtojnë në bllok ndërtimin e Skavicës dhe bëjnë thirrje për rezistëncë.

Haxhi Drizi, 76 vjeç, një banor që preket drejtëpëdrejtë nga liqeni i Skavicës, thotë në fjalën e tij, se “Muhurri e ka ruajtur tokën, jemi të lidhur me të. Këtu, ndër vite, thuhet se edhe “budallat e Muhurrit,

“Kujdes, mos firmosni asnjë lloj letre, që mund tu afrohet. Do ta ndalojmë ndërtimin e Skavicës, me të gjitha format e mundshme të protestës e revoltës tonë, pasi ndërtimi i Skavicës, është baraz me ‘s’ka Dibër më’.”

nuk dalin jashtë katunit”. Këtu edhe ata me të meta fizike, nuk e kalojnë urën e Muhurrit. Shqipëria ka pak sipërfaqe toke të punueshme, si mund të zëmë me ujë këtë pak sipërfaqe që kemi?! Inxhinierët na kanë thënë se aktualisht nuk jemi duke punuar, por duke bërë studime. Këtu nuk ka transparencë”, thekson ai.

Nazmi Drizi kryetar i shoqatës për Mbrojtjen e Luginës së Drinit të Zi, tha se “Skavica përmbyt Dibrën dhe e ndan atë në katër pjesë. Punimet janë ndal, por kjo s’ka besë”.

Shemsi Prençi, -ish drejtor i Emergjencave Civile, tha në fillim të fjalës së tij, se “ndjehet mjaft i emocionuar që të flasë para bashkëqytetarëve të tij”.

“Këtu nuk jemi mbledhur as për Sali Berishën e as për Edi Ramën”, tha Prençi. “Mallkuar qoftë ai që shet pronën e baballarëve, për një punësim në shtet. Sot askush nuk më ndalon të jem përkrah vëllezërve të mi murrakë. Nuk vdes kush për bukë, për një punë në shtet”.

Prençi vuri në dukje faktin se “nuk e ndërton Amerika Skavicën, por qeveria shqiptare, për të pastruar paratë”.

“Nuk e duan Muhurrin, se e kanë planifikuar për ta mbytur në ujë”.

Prençi, gjatë diskutimit të tij theksoi edhe njëherë faktin se “pretendimi i ndërtimit të Skavicës, për të shpëtuar Shkodrën nga përmbytjet nuk qëndron, pasi ajo është përmbytur e do përmbytet nga keqmenaxhimi i ujit në kaskadën e Drinit”.

Më tej, Shemsi Prençi tha se “jemi kundër projektit të Skavicës, pasi ai është tejet anadollak, pasi ka mjaft alternativa të tjera për të siguruar energjinë elektrike, veç asaj të ujit”.

Ai u bëri thirrje banorëve të jenë të kujdesshëm “kur t’ju vijnë për të firmosur formularë, se ju mashtrojnë. Edi Rama nuk e do Dibrën dhe ka vendosur për ta ndërtuar Skavicën”.

Prençi theksoi se “me organizatat e mbrojtjes së natyrës, do ti drejtohemi edhe Gjykatës Kushtetuese, për ta ndaluar ndërtimin e Skavicës, me procedurë kushtetuese”.

“Ndaj kujdes, - porositi të pranishmit në këto tubime Prençi, - mos firmosni asnjë lloj letre, që mund tu afrohet”. “Do ta ndalojmë ndërtimin e Skavicës, me të gjitha format e mundshme të protestës e revoltës tonë, pasi ndërtimi i Skavicës, është baraz me “s’ka Dibër më”.

“Lugina e Drinit të Zi duhet të mbrohet fort dhe jo të mbulohet nga uji, pasi duan ta shpopullojnë dhe pastaj ta shfrytëzojnë për interesat e tyre, pa njerëz”, tha në diskutimin e tij Shemsi Prençi.

Haxhi Xhani, një banor i Muhurrit, në fjalën e tij, u bëri thirrje dy deputetëve të Dibrës, dhe veçanërisht Lavdrim Krrashit, i cili e ka origjinën nga shkëmbi historik i Arrasit, që “të ngrejnë zërin në mbrojtje të banorëve, për mbrojtjen e Luginës së Drinit të Zi, pjesë e së cilës është edhe ai vetë”.

Aktualisht qeveria shqiptare hodhi hapin e parë për vënien në lëvizje të projekti, në qershor të këtij viti. Në zonën ku do të ndërtohet hidrocentrali, një projekt ky me vlerë rreth 500 milion euro, lartësia e digës do jetë 443 m. Qeveria ka përgatitur projekt-ligjin për negocim me kompaninë Bechtel International, për ndërtimin e këtij HEC-i. Aktualisht banorët konfirmojnë se aty ku do ndërtohet hidrocentrali, kanë parë të bëhen punime, por nga stafi inxhiniero-teknik është pohuar se nuk bëhet fjalë për fillim punimesh për ndërtimin e hidrocentralit, por për studimin e fizibilitetit.

Rruga e Arbërit nr. 193-195

HEC i Skavicës:

aktualitet

Qeveria dhe Bechtel vazhdojnë me planet për ndërtimin,

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Përfituesit më të mëdhenj nga Skavica do jenë ata që janë aty rreth e rrotull", provokoi kryeministri Rama dibranët gjatë vizitës së tij në Dibër në fund të tetorit të këtij viti.

"Përfituesit më të mëdhenj nga Skavica do jenë ata që janë aty rreth e rrotull se Skavica nuk është thjesht çështja që do na garantojë ne një nga gurët themelorë të sovranitetit energjetik që në kohët e sotme është gjë e jashtëzakonshme, por do të hapë perspektivë të jashtëzakonshme për gjithë atë zonën atje, pa llogaritur që ata, të cilët do të spostohen që aty do marrin shtëpi e të gjitha me radhë" tha kryeministri Rama gjatë një takimi me operatorët turistikë në qark.

Por pikërisht, "që janë aty rreth e rrotull" që sipas kryeministrit do të jenë përfituesit më të mëdhenj, ata janë aktualisht më të shqetësuarit dhe më të painformuarit.

Gjatë muajit tetor, një projekt i realizuar nga organizata "Noorth Green Asocciation" (NGA), mbështetur nga EuroNatur, arriti në konkluzionin që jo vetëm që banorët e luginës së Drinit janë më të painformuarit, por edhe se ndërtimi i hidrocentralit do ti sjellë vendit dëme të pariparueshme mjedisit.

"Ky projekt mbart disa rreziqe, si humbja përgjithmonë e tokës dhe prodhimeve të saj, shkelen dhe nuk zbatohen strategjitë e miratuara për zhvillimin e qëndrueshëm të Dibrës, humbet biodiversiteti, me rezultat final zhdukjen e specieve të florës dhe faunës, rrezikohen dhe zhduken fauna e egër, por edhe mbi 70 përqind të bimëve autoktone medicinale dhe bujqësore. Ndryshimi i mikroklimës shkatërron përfundimisht potencialin e jashtëzakonshëm turistik në të gjithë zonën, sëbashku me pjesën e fundit të mbetur dhe më të bukur të lumit Drinit të Zi", thotë Edi Truka, drejtor Ekzekutiv i NGA.

Kundërshtimet për Skavicën janë përcjellë gjatë këtij viti me protesta të ndryshme, duke filluar nga Zallë-Dardha deri në Gjoricë. Më 1 shtator, Aleancës për Mbrojtjen e Dibrës, drejtuar nga biznesmeni Zenel Hoxha, organizoi një protestë në Fushë-Alie, ku ekspertë dhe qytetarë të ardhur nga qytete të ndryshme të vendit, nga Shkodra deri në Vlorë, kërkuan që qeveria të ndalonte projektin.

SKAVICA NË SKENËN POLITIKE

Çështja e Skavicës është kthyer tani edhe në debatin politik. Një pjesë e opozitës e udhëhequr nga ish-kryeministri Berisha është shprehur kundër ndërtimit të Skavicës. Gjatë fushatës për zgjedhjet vendore në Dibër në fillim të vitit, ish-kryeministri Berisha, duke dalë kundër projektit aktual që po zhvillon KESH, kishte shprehur qëndrimin e tij për "ndërtimin e hidrocentralit pa përmbytur asnjë centimetër tokë, përmes një tuneli devijimi".

Ferzileta Gjika, aktualisht profesore në CUNY - Universitetin e Qytetit të New Yorkut, e cila po udhëheq një grup banorësh për të kundërshtuar planet për ndërtimin e Skavicës, u shfaq në fillim të nëntorit në Tiranë, në një miting të organizuar nga opozita e drejtuar nga ish-kryeministri Sali Berisha, ku kërkoi ndalimin e planeve të qeverisë për ndërtimin e Skavicës.

Pamje nga protesta e komunitetin dibran në Londër pranë zyrave të Bechtel.

"Vij nga SHBA-të për të protestuar kundër padrejtësive që i bëhen popullit shqiptar. Jam me origjinë nga Dibra. Jam këtu sot për t'i thënë jo eksodit të shqiptarëve. Unë i them jo korrupsionit dhe krimit dhe projekteve mafioze si ai i Skavicës. HEC-i i Skavicës do të shkatërrojë peizazhin madhështor të Dibrës, do të vjedhë ujin e Drinit, do të shuajë Dibrën dhe dibranët dhe të gjithë speciet unike në Shqipëri dhe Ballkan. Është një vdekje e lumit Drin. Sot i bëj thirrje qeverisë, ndaloni këto pazare që bëhen me Dibrën. Dibranë e shqiptarë kudo që jeni historia po ju thërret. Sot kemi përgjegjësinë historike ndaj brezave që do vijnë, që Dibrën ta trashëgojmë siç e ka krijuar Zoti", deklaroi Gjika në mitingun e opozitës.

BECHTEL NË KËRKIM TË NËNKONTRAKTORËVE. PROTESTË NË LONDËR

Më 10 dhe 21 Nëntor, Bechtel se bashku me kompaninë "UK Export Finance" organizuan në Londër një prezantim përpara financuesve të mundshëm të projektit të Skavicës apo nënkontraktorëve për të zhvilluar fazën e dytë të projektit.

Bechtel deklaroi për mediat britanike se "ishte i interesuar për marrëveshje me kompanitë aktive në inxhinierinë civile, strukturore dhe mekanike, pajisjet e ndërtimit dhe fushat elektrike".

Ky njoftim i Bechtel nxiti komunitetin dibran në Londër të organizonte një protestë më 20 tetor 2022 përballë zyrave ku kompania do të prezantonte projektin përpara nënkontraktorëve.

"Mos shkatërroni Dibrën", "Mos u dorëzoni", "Bechtel largohu, lëre Dibrën" - ishin disa nga pankartat të shkruara në gjuhën angleze. Folësit në këtë tubim kërkuan ndalimin e planeve për ndërtimin e Skavicës dhe i bënë thirrje kompanisë të tërhiqej nga projekti.

Ndërkohë në Tiranë, një studio avokatie ka bërë hetime në lidhje me ligjin e posaçëm që i jep Bechtel studimin, projektimin dhe ndërtimin e Skavicës.

"Studio ka gjetur mbi 20 shkelje antikushtetuese në këtë ligj të posaçëm, ndërsa tani po shihet mundësia se cila është rruga më e mirë për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese ligjin".

Në qoftë se kjo betejë ligjore fitohet, pra ligji shpallet antikushtetues, do të jetë një fitore e parë e kundërshtarëve të Skavicës.

LETËR DFC-SË: MOS FINANCONI PROJEKTIN

Një grup shoqatash vendore dhe ndërkombëtare, me fokus ruajtjen e mjedisit, i kanë dërguar një letër Korporatës Financiare të Zhvillimit Ndërkombëtar të SHBA-së (US International Development Finance Corporation - DFC), duke i kërkuar kësaj të fundit të mos financojë projektin e Skavicës.

Në kundërshtim të idesë ata paraqesin disa argumente.

"Qeveria Shqiptare nuk është konsultuar me mijëra qytetarët të cilët preken prej këtij projekti. Protestat e qytetarëve nuk janë marrë në konsideratë", shkruhet në letrën drejtuar DFC-së.

Gjithashtu, në letrën e dërguar nga Andrey Ralev, një ekspert i mjedisit nga organizata Bankwatch Network, shkruhet se "korrupsioni është një faktor që ndikon vendimarrje të tilla, qoftë nga ana e qeverisë shqiptare, qoftë nga ana e kompanisë Bechtel", e cila përmendet në letër si e përfshirë në disa projekte të dyshimta në Ballkan.

"Nën dritën e fenomenit të ngrohjes globale, një investim i tillë nuk ka kuptim, duke pasur parasysh rënien në vazhdimësi të rezervave ujore", shkruhet mes të tjerash në letër. Gjithashtu, në letër shkruhet se burime të tjera të energjisë, si energjia diellore, nuk janë marrë akoma në konsideratë nga qeveria shqiptare.

Më 10 dhe 21 Nëntor, Bechtel se bashku me kompaninë "UK Export Finance" organizuan në Londër një prezantim përpara financuesve të mundshëm të projektit të Skavicës apo nënkontraktorëve për të zhvilluar fazën e dytë të projektit. Bechtel deklaroi për mediat britanike se "ishte i interesuar për marrëveshje me kompanitë aktive në inxhinierinë civile, strukturore dhe mekanike, pajisjet e ndërtimit dhe fushat elektrike".

"Biodiversiteti i zonës do të vihej në rrezik, duke përfshirë kafshë të rralla dhe ndryshimin e klimës në zonë', shkruhet në letrën drejtuar DFC.

Drejtuesit e DFC vihen në dijeni se hidrocentrali do të "do të zhvendosë më shumë se 5000 banorë, të cilët akoma nuk e dinë fatin e tyre".

Në këto rrethana, në letrën e firmosur nga 22 organizata mjedisore brenda dhe jashtë vendit si dhe 111 qytetarë nga rajoni i Dibrës, i kërkohet DFC-së që të mos marrë në konsideratë financimin e projektit.

KESH: BANORËT DO TA THONË QËNDRIMIN E TYRE GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Faza e parë e studimit për Skavicën, parashkuar sipas ligjit të posaçëm të miratuar në Parlament, parashikon një buxhet prej 16 milionë euro. Kjo shumë, e cila paguhet nga KESH, parashikohet për më shumë se 90 studime të ndryshme. Deri më tani, nëntor 2022, janë dorëzuar mbi 70 studime në KESH, të cilat edhe janë paguar, ndërsa pritet të përfundojnë edhe 20 studime të tjera, më i rëndësishmi i të cilave është ajo për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social.

Këtë studim e ka marrë përsipër Golder, një kompani ndërkombëtare me përvojë në këtë fushë, e mbështetur nga kompani lokale të konsulencës. Studimet e gjendjes ekzistuese mjedisore janë kryer tashmë për periudhat e verës, vjeshtës dhe dimrit. Një pjesë e madhe e këtij studimi është kryer.

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social do të vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të projektit, si ato negative ashtu edhe ato pozitive; mënyrat se si ndikimet negative mund të shmangen, minimizohen ose korrigjohen; ndikimet e mundshme në jetesën e komuniteteve të prekura, grupet në nevojë, infrastrukturën sociale, trashëgiminë kulturore si dhe burimet natyrore si dhe qasjen dhe parimet e kompensimit dhe zhvendosjes.

Raporti pritet të jetë gati për opinionet dhe komentet e publikut gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022.

Raporti duhet të hartojë edhe Planin e Veprimit dhe të Zhvendosjes, ku duhet të jepen të detajuara popullsinë e prekur, sipërfaqen e tokës që do të përmbytet, vlerat e kompensimit për tokën dhe asetet, planin e zhvendosjes etj. Ky proces do të shoqërohet edhe me një census të popullsisë dhe aseteve në territorin që do mbulohet nga ujërat e liqenit.

ZHVENDOSJA DHE KOMPENSIMI, NJË STUDIM I VEÇANTË NGA KESH

Në fazën e parë të studimit KESH thotë se do të duhet të jenë të studiuara edhe parimet e kompensimit dhe zhvendosjes.

"Përfituesit më të mëdhenj nga Skavica do jenë ata që janë aty rreth e rrotull", provokoi kryeministri Rama dibranët gjatë vizitës së tij në Dibër në fund të tetorit të këtij viti.

Në foto: Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me operatorët turistikë në Dibër, tetor 2022

Faza e parë e studimit për Skavicën, parashkuar sipas ligjit të posaçëm të miratuar në Parlament, parashikon një buxhet prej 16 milionë euro. Kjo shumë, e cila paguhet nga KESH, parashikohet për më shumë se 90 studime të ndryshme. Deri më tani, nëntor 2022, janë dorëzuar mbi 70 studime në KESH, të cilat edhe janë paguar, ndërsa pritet të përfundojnë edhe 20 studime të tjera, më i rëndësishmi i të cilave është ajo për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social.

banorët të painformuar vazhdojnë me protestat

Shoqatat mjedisore letër DFC:

- **Qeveria Shqiptare nuk është konsultuar me mijëra qytetarët të cilët preken prej këtij projekti.**
- **Protestat e qytetarëve nuk janë marrë në konsideratë.**
- **Korrupsioni është një faktor që ndikon vendimarrje të tilla, qoftë nga ana e qeverisë shqiptare, qoftë nga ana e kompanisë Bechtel.**
- **Nën dritën e fenomenit të ngrohjes globale, një investim i tillë nuk ka kuptim, duke pasur parasysh rënien në vazhdimësi të rezervave ujore**
- **Do të zhvendosë më shumë se 5000 banorë, të cilët akoma nuk e dinë fatin e tyre**

Ekspertë në terren duke mbledhur të dhëna për studimet paraprake për raportin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social.(Foto: KESH)

"KESH dhe partnerët e tjerë të projektit janë të angazhuar të trajtojnë në mënyrë të drejtë banorët dhe komunitetet dhe vrojtimi social në terren si dhe konsultimet e gjera me publikun do të jenë mundësi për të marrë informacion dhe opinionin e tyre. Raporti i VNMS-së do të ndahet me komunitetet nëpërmjet dëgjesave të hapura publike përpara se të paraqitet për aprovim nga autoritetet. Opinionet dhe komentet e marra nga publiku do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar të VNMS-së"

Në foto: Përfaqësues të banorëve dhe grupeve të studimit përplasen me tyre. Ata i kanë ndaluar grupet e studimit të vazhdojnë punën e tyre në terren, duke u shprehur kundër Projektit

"Projekti është i angazhuar të trajtojë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë individët dhe komunitetet e prekura. Qasja ndaj kompensimit dhe zhvendosjes do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të sektorit", thonë KESH në një njoftim për publikun.

Sipas KESH, "projekti do të shmangë ose minimizojë zhvendosjen e pavullnetshme kudo që kjo është e mundur duke vlerësuar alternativa të ndryshme gjatë fazës së projektimit".

Gjithashtu, projekti do të adresojë ndikimet negative sociale dhe ekonomike që mund të vijnë për shkak të sigurimit të tokës ose kufizimeve në përdorimin e saj nëpërmjet sigurimit të kompensimit për humbjen e aseteve bazuar në vlera e tregut plus koston e transaksionit, si dhe të sigurojë aktivitetet e zhvendosjes duke zbatuar masat e nevojshme për shpërndarjen e informacionit, konsultimet dhe pjesëmarrjen e informuar të personave të prekur.

Në qoftë se qeveria shqiptarë do të vendosë të kalojë në fazën e dytë, që është ai i ndërtimit të hidrocentralit, duhet që në projekt të jenë të përcaktuara edhe hapat e duhura , me qëllim që të garantojë se "projekti do të përmirësojë ose kthejë në gjendjen fillestare mjetet dhe kushtet e jetesës së personave që do të zhvendosen, do të përmirësojë kushtet e jetesës të personave të zhvendosur nëpërmjet sigurimit të strehimit të përshtatshëm me pronësi të sigurt në zonat e zhvendosjes".

"Objektivi i përgjithshëm është që në përfundim të procesit të zhvendosjes jetesa e personave që do të zhvendosen të përmirësohet ose minimalisht të jetë e njëjtë me nivelin që ishte", thotë KESH

Drejtori i KESH, Ergys Verdho, gjatë kthimit të përgjigjeve individëve dhe organizatave të ndryshme, bazuar në kërkesa për informacion, thotë se deri më tani "nuk ka një vendim përfundimtar mbi treguesit teknik të projektit. Nga kontraktori po mblidhen dhe vlerësohen të gjitha informacionet e nevojshme për realizimin e procesit të përzgjedhjes së alternativës më fizibël".

"Vendndodhja e saktë e digës dhe kufijtë e rezervuarit nuk janë përcaktuar akoma dhe aktualisht janë duke u studiuar dy vendndodhje alternative", shkruan Verdho.

Sipas tij, "përcaktimi i vendndodhjes së saktë të digës dhe kufijtë e rezervuarit do të përcaktohen nëpërmjet një studimi fizibiliteti, i cili do të marrë në konsideratë faktorët mjedisorë, socialë, teknikë dhe ekonomikë".

"KESH dhe partnerët e tjerë të projektit janë të angazhuar të trajtojnë në mënyrë të drejtë banorët dhe komunitetet dhe vrojtimi social në terren si dhe konsultimet e gjera me publikun do të jenë mundësi për të marrë informacion dhe opinionin e tyre. Raporti i VNMS-së do të ndahet me komunitetet nëpërmjet dëgjesave të hapura publike përpara se të paraqitet për aprovim nga autoritetet. Opinionet dhe komentet e marra nga publiku do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar të VNMS-së", thotë Ergys Verdho, drejtor i KESH, në një letër drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

***

Ndërkohë që ky shkrim botohet, sipas parashikimeve të KESH, duhet të kishte filluar diskutimi me publikun, por deri më tani asnjë takim zyrtar nuk ka ndodhur. Sipas ligjit, njoftimet duhet të bëhen disa ditë përpara, për tu dhënë mundësi banorëve të përgatiten, por aktualisht nuk ka asnjë njoftim publik në asnjë nga agjencitë shtetërore që e kanë për detyrë ta ndjekin këtë proces, si në njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë kombëtare apo rajonale të mjedisit.

Gjatë muajit të kaluar disa takime informale, madje edhe me përplasje verbale mes banorëve dhe përfaqësuesve të Bechtel dhe grupeve të studimit kanë ndodhur në Muhurr dhe Fushë Alie, por këto takime nuk kanë qenë të planifikuara. Banorët janë të përgatitur për tu përballur me qeverinë në këtë procesin e diskutimeve, por frika e tyre për një proces fallso mbetet e madhe.

Pamje nga protesta e banorëve të Dibrës në Fushë-Alie, 1 shtator 2022

KESH: Vazhdojmë bashkëpunimin me Bechtel për zhvillimin e projektit

Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) është zhvilluesi i Projektit të Hidrocentralit të Skavicës. KËSH ka theksuar përmes njoftimeve për shtyp gjatë gjithë kësaj kohe se "qëllimi i ndërtimit të HEC Skavica është të sigurojë furnizim shtesë me energji elektrike si dhe të përmirësojë menaxhimin e kaskadës së Drinit si dhe reduktimin e përmbytjeve në rrjedhën e poshtme nga nivelet e larta të reshjeve sezonale".

Bechtel, kompania globale e inxhinierisë dhe ndërtimit, është duke punuar më KESH për të realizuar një studim realizueshmërie të HEC Skavica, si dhe realizimin e vlerësimit të kostove të Projektit.

KESH mendon se "Skavica, si diga e sipërme e kësaj kaskade, do të jetë diga kontrolluese që do të ndihmojë në optimizmin e kaskadës".

Në fazën aktuale të studimit, që përkon me fazën e parë të punimeve sipas parashikimeve të ligjit Nr. 38/2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International, Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës" dhe VKM nr.485, datë 30.7.2021 "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "kontratë për shërbime teknike - projekti Hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH SHA dhe Bechtel Limited", shoqëria Bechtel është duke zhvilluar fazën e parë të projektit për ndërtimin e HEC Skavica.

KESH thotë se "studimi po kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe Bechtel është angazhuar për të menaxhuar këtë proces për KESH-in me mbështetjen e kompanive të tjera ndërkombëtare si Mott MacDonald për pjesën inxhinierike, Golder për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor e Social (VNMS) si dhe WeBuild për pjesën teknike dhe të ndërtueshmërisë së veprës". Burime nga KESH theksojnë se "në këtë fazë Projekti po mbështetet edhe nga kompani lokale të konsulencës".

Studimet aktuale po shqyrtojnë alternativat për vendndodhjen e digës dhe elementeve të tjera të projektit, llojin dhe lartësinë e digës, korridorin e linjës së transmetimit, rrugët hyrëse, vlerësimet gjeologjike, gjeoteknike, hidrologjike, të ndryshimit të klimës dhe përmbytjeve, studimet për fuqinë dhe prodhimin e energjisë si dhe për tunelet për skemën hidrike.

Kërkesës nëse këto studime mund të jenë të hapura për publikun, KESH thotë se "është paraparë që këto studime të dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe atje do të jenë të disponueshme për të interesuarit".

"Studimet gjeoteknike kanë nisur rreth fundit të vitit 2021 së bashku me vrojtimet tokësore dhe ajrore bazë të zonës së propozuar të Projektit. Studimi dhe alternativat pritet të vendoset brenda vitit 2022, ndërsa Vlerësimi i Ndikimit Social e Mjedisor pritet të mbarojë deri në qershor të vitit 2023, thuhet në njoftimet publike të KESH.

Projektimi i veprës, sipas planeve të KESH, pritet të zgjasë dy vite, deri në fund të vitit 2023, ndërsa faza e parë e ndërtimit pritet të fillojë në mesin e vitit 2023.

Në qoftë se qeveria shqiptare parashikon të ece përpara më ndërtimin e Skavicës, ajo pritet ta përfundojë atë në fund të vitit 2026, ndërsa viti 2027 do të shërbejë edhe si fazë kolaudimi dhe do të fillojë mbushjen përfundimtare të rezervuarit.

Rruga e Arbërit nr. 193-195

“Mbi 32 fshatra humbin lidhjen direkte me Peshkopinë, si dhe “mbytet” trashëgimia kulturore –historike 3000 vjeçare”

Projekti i Skavicës ndjell **frikë dhe pasiguri** në luginën e Drinit të Zi

Punimet pregatitore për hidrocentralin e Skavicës. Foto: Andrey Ralev

Banorët e Dibrës që preken nga ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës e kundërshtojnë projektin që pritet të përmbysë 35 fshatra, ndërsa kanë frikë se nuk do të marrin dëmshpërblim të drejtë për pronat e tyre nësë ai ndërtohet.

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Pas nënshkrimit të një marrëveshje me kompaninë amerikane Bechtel në korrik 2021 për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, qeveria shqiptare dhe vetë kryeministri Edi Rama kanë qenë të zëshëm mbi suksesin që kjo kontratë nënkuptonte.

Në prill Rama e cilësoi hidrocentralin, i cili sipas tij rrit me 20 për qind prodhimin e energjisë hidrike në vend, një “ëndërr të gjatë”.

Madje së fundmi ndërsa vizitonte Dibrën në 29 tetor, Rama i cilësoi si të pakuptueshme kundërshtimet ndaj projektit dhe akuzoi opozitën se kishte nxitur kundërshtimet.

“Çfarë ka këtu, pse duhet me qenë kundër? Duke dëgjuar hienat”, tha Rama, i cili premtoi shtëpi për ata që prekeshin dhe punë për ata që jetonin rreth e rrotull luginës.

Por ndërsa kryeministri premton dhe zhurma rreth hidrocentralit shtohet, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH, që është pronare e hidrocentralit në gati një duzinë përgjigjesh për palë të treta të publikuara në faqen e saj pas kërkesave për informacion, bën me dije se ende nuk ka një projekt përfundimtar dhe po ashtu as bisedime dhe as vendimmarrje mbi fatin e banorëve.

Paqartësia për të ardhmen i ka bërë dyshues banorët e fshatrave që preken nga ndërtimi i HEC-it.

“Këtu mungon transparenca,” tha Haxhi Idrizi, 76-vjeç, nga fshati Muhurr, ndërsa shpjegoi se banorët e tij kurrë nuk e kishin braktisur tokën.

“Ne vijojmë të mbetemi në dilemë se ç’farë na premton qeveria ne, për ndërtimin e hidrocentralit”, shtoi ai.

Dyshimet e banorëve ngrihen mbi një histori të gjatë të kompensimit të padrejtë që u ofrohet atyre që shpërngulen në favor të projekteve publike në Shqipëri.

Në vitin 2016 BIRN gjeti se banorët e fshatrave që u përmbytën nga ndërtimi i hidrocentralit të Vaut të Dejës prej 45 vjetësh ende presin kompensimin e premtuar, ndërsa jetojnë në kapanone të mbuluara me eternit që shërbyen si fjetore për punëtorët e digës së parë mbi lumin Drin.

Konfliktet e hapura me të shpronësuarit nga qeveria me çmime reference shumë më të ulëta se sa tregu, janë lajme të zakonshme në Shqipëri, ndërsa BIRN ka gjetur se edhe në këto raste pagesat vonohen duke u pamundësuar të shpronësuarve një jetë normale.

ANKTHET E SHPËRNGULJES

Lëvizja “Jo Skavicës-Po Dibrës”, e krijuar nga dibranë që preken direkt prej projektit apo të emigruar që kërkojnë të ruajnë zonën, zhvilloi gjatë tetorit takime në 19 fshatra që sipas planeve të publikuara preken direkt prej HEC-it.

Majlinda Hoxha, aktiviste e lëvizjes dhe koordinatore e takimeve i tha BIRN se pavarësisht se ku kishin shkuar, qëndrimi i banorëve kishte qenë i unifikuar kundër projektit.

“Gjetja më interesante, nëse mund ta quaj kështu, ishte se në çdo fshat kemi marrë të njëjtin feedback;- ne do sakrifikojmë jetën për të mbrojtur pronën, tokën dhe varret e gjyshërve tanë”, tha ajo.

Hoxha thotë se hidrocentrali do të ishte fundi i Dibrës dhe se lëvizja ka marrë mbështetje nga organizata mjedisore ‘EuroNatur’ për ti bërë ballë projektit.

“Jo pak, por 32 fshatra humbin lidhjen direkte me Peshkopinë, si dhe “mbytet” trashëgimia kulturore –historike 3000 vjeçare”, tha ajo, ndërsa shtoi se ndikimi shkon përtej atyre zonave që mbulohen nga uji.

Hoxha shtoi se ata po ndihmojnë banorët që të jenë të qartë në takimet e mëvonshme të konsultimit publik, në të cilat projekti duhet të kalojë.

“Në këtë fazë banorët duhet të paraqesin problematikat që kanë dhe ne do angazhohemi që të kemi edhe disa të dhëna mbi efektet negative të këtij projekti, që banorët të jenë më të përgatitur”, shpjegoi ajo.

Pjesmarrës në një prej takimeve të lëvizjes të zhvilluar në 17 tetor në Muhurr, Nazmi Drizi, kryetari i shoqatës “Për mbrojtjen e Luginës së Drinit të Zi”, tha se projekti e ndante krahinën në katër pjesë dhe përmbyste një pjesë të mirë të saj.

“Punimet janë ndal, por kjo s’ka besë,” tha ai. “ Dibrën don ta zhbëj me një të rënë të lapsit, Edi Rama”, shtoi Drizi duke fajësuar kryeministrin.

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku tha gjatë një fjalimi në parlament në tetor 2022 se punimet do të nisnin brenda 9 muajve, por se ende vijonin negociatat për financimin e digës.

Por ndërsa bëhen gati për të kundërshtuar projektin, banorët janë duke bërë edhe llogaritë se çfarë mund të shpëtojnë prej asaj që kanë trashëguar në vite.

Hysen Uka, studiues-publiçist, njëherësh edhe kryetar i shoqatës *Nisma Dibrane*, thotë se ndërsa e kundërshtojnë në tërësi projektin, banorët duhet të bëhen gati që ai mund t’iu imponohet. Ai thekson se nëse projekti ndërtohet ata duhet të marrin një kompensim të drejtë për pronat e humbura.

Uka kërkoi që qeveria duhet të marrë përsipër që të financojë banorët e “zhvendosur, për ringritjen e veprimtarive bujqësore-blegtoriale, agroturizëm, bletari, peshkim etj”.

Sipas tij qeveria duhet tu ofrojë banorëve jo dëmshpërblim monetar për pronën, por tokë bujqësore prodhuese, banesa dhe një paketë investimesh që duhet të përfshijë edhe ngritjen e një qyteze në njësinë administrative Kastriot, si dhe infrastrukturë që do të mundësonte lidhjen e zonave që izolohen nga liqeni i hidrocentralit me aeroportin e Kukësit dhe “rrugën e Arbërit”.

Por frikërat dhe dëshirat e banorëve janë për momentin të bazuara vetëm në fjalët e dëgjuara në mitingje elektorale. Korporata Elektroenergjitike thotë se ende nuk ka përfunduar faza studimore e projektit dhe as kishte deri në fund të tetorit një ide të qartë të numrit të atyre që preken.

KESH në përgjigje të njërës prej kërkesave për të drejtë informimi mbi Skavicën, të publikuara në faqen e saj në 27 shtator, thotë se ende nuk kishte përfunduar faza e parë që parashikon studim teknik, atë të fizibilitetit dhe vlerësim mjedisor të projektit.

“Analiza e fizibilitetit teknik, social, mjedisor dhe ekonomik do të përcaktojë edhe avantazhet dhe disavantazhet projektit të cilat do të analizohen e konsultohen edhe me publikun përpara marrjes se një vendimi përfundimtar”, thuhet në përgjigje.

KESH shprehet se ende nuk e ka të qartë se cilët do të jenë fshatrat e prekur dhe as numrin konkret të banorëve që do të zhvendosen.

“Aktualisht studimi i fazës së pare është akoma në proces. Propozimet për vendin e zhvendosjes do të jenë të sakta pas realizimit të kontakteve në vend me banoret e zonës, gjatë fazës së njoftimit të rezultateve të fazës së parë të projektit”, thuhet në përgjigjen e KESH të tetorit 2022.

NDIKIMI NË MJEDIS

HEC-i i Skavicës është një projekt që ka nisur fillimisht në vitet 1970 si pjesë e kaskadës së Drinit, për plotësimin e nevojave të vendit me energji elektrike dhe si një rezervë ujore për pjesën tjetër të kaskadës

Aktualisht qeveria shqiptare hodhi hapin e parë për vënien në lëvizje të projekti, një vit më parë me nënshkrimin e një marrëveshje me kompaninë Bechtel, e cila sipas kontratës po kryen studim teknik të zonës, fizibiliteti dhe po ashtu edhe vlerësim të ndikimit në mjedis.

Kosto të projektit janë ende të paqarta por shifrat e përmendura publikisht në varësi të digës dhe madhësisë së hidrocentralit variojnë nga 250 milion euro deri në 500 milion euro. Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku tha gjatë një fjalimi në parlament në tetor 2022 se punimet do të nisnin brenda 9 muajve, por se ende vijonin negociatat për financimin e digës.

Projekti pritet të hasë në kundërshtime të forta të organizatave të mjedisit që e shohin atë si rrezik për biodiveristetin në zonë.

Andrey Ralev, një aktivist i biodiversitetit shkroi në faqen e organizatës mjedisore ‘Bankwatch’ në korrik të këtij viti se diga mbi Drin ishte “gjëja e fundit që i duhej Shqipërisë”, ndërsa arsyetoi se ndërtimi do të zhdukte përfundimisht Rreqebullin e Ballkanit.

Në të njëjtën kohë organizata si EuroNatur dhe Riverwatch kanë qenë gjithashtu të zëshme në kundërshtimin e planeve për ndërtimin e digës, që i shohin si jo të qëndrueshme.

EuroNatur është ndërkohë aktive në mbështetje të aktivistëve lokalë në organizimin e banorëve kundër projektit. Në një takim në fshatin Muhurr në 17 tetor, Edi Truka drejtues ekzekutiv i ‘North Green Association’, një OJF me qendër në Tiranë, e mbështetur nga EuroNatur, u foli banorëve mbi pasojat mjedisore të digës në mjedisin e zonës.

Sipas Tukës një pjesë e faunës së egër rrezikon të zhduket dhe bashko më atë edhe 70 për qind e bimëve autoktone medicinale dhe bujqësore.

Marrë nga Reporter.al

Shkrimi = n origjinal e gjeni në: https://www.reporter.al/2022/11/08/projekti-i-skavices-ndjell-frike-dhe-pasiguri-ne-luginen-e-drinit-te-zi/

cyan magenta yelloë black

reportazh

Deutsche Welle: **Hidrocentrali i Skavicës, projekti i kundërshtuar prej dekadash**

Rajoni i Dibrës: Natyra ka qenë dorëlëshuar në këtë pjesë të verilindjes në Shqipëri, ku gjen diell, erë dhe ujë me bollëk Foto: Kristi Çavo / DW

Nga **ELONA ELEZI** / Deutsche Welle

Një hidrocentral me kapacitet instalimi 210 megavatë, që planifikohet të ndërtohet në Skavicë të Kukësit, në lumin Drini i Zi, rrezikon më shumë se 30 fshatra në Dibër, zona kufitare me Skavicën.

Një rrugë thuajse e pakalueshme dhe sfilitëse lidh fshatrat e Dibrës me Skavicën në Kukës, aty ku pritet të ndërtohet hidrocentrali aq shumë i debatuar këtej pari. Natyra ka qenë dorëlëshuar në këtë pjesë të verilindjes në Shqipëri, ku gjen diell, erë dhe ujë me bollëk. Por pavarësisht të gjitha këtyre burimeve të energjisë së rinovueshme, qeveria ka zgjedhur të ndërtojë një vepër energjetike duke shfrytëzuar sërish lumenjtë e vendit. Këtë herë, mbi lumin Drin, parashikohet të ngrihet një digë me lartësi 147 metra, rezervuari i së cilës do të përmbyste rreth 15 mijë hektarë tokë bujqësore dhe pyje si dhe më shumë se 30 fshatra të luginës së Dibrës.

Majlinda Hoxha e kaloi fëmijërinë e saj duke dëgjuar për hidrocentralin e Skavicës, i planifikuar për t'u ndërtuar nga shumë qeveri shqiptare, që nga diktatura e deri më sot. Fshati i saj Çidhën është një nga dhjetra fshatrat që do të vuajnë pasojat nëse projekti gjen zbatim. Xhaxhai i saj është një ndër të parët qëndrestarë të kësaj kauze dhe traditën e familjes po e çon përpara Majlinda. Shpeshherë, ajo dhe banorët e tjerë janë akuzuar se protestojnë për arsye politike, por këto fjalë nuk e zprapsin. "Kemi më shumë se 20 vite që protestojmë dhe nuk kemi asnjë agjendë. Ne do të kundërshtojmë çdo kompani private dhe çdo nismë që planifikon përmbytjen e Dibrës, shuarjen e historisë së Dibrës dhe vështirëson jetën e dibranëve" – thotë ajo për Deutsche Welle.

Por banorët që jetojnë aty nuk janë të vetmit që protestojnë. Edhe përtej kufijve, ata janë organizuar e kanë ngritur zërin në mbrojtje të kauzës. Një prej tyre është edhe Agron Damzi, emigrant në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në 4 nëntorin e një viti më parë, sëbashku me qindra të tjerë, ata protestuan para zyrave qendrore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Në qershorin e këtij viti, marshuan sërish, më të shumtë në numër. "Ne nuk do të ndalojmë së protestuari, deri në anulimin e këtij projekti që zhduk dhe varros përfundimisht Dibrën" – thotë Damzi.

Dibër, lugina e Skavicës Foto: Kristi Çavo / DW

"SKAVICA", NGA "DUART" E BE, TEK SHBA

Ndëkaq në Skavicë, kompania amerikane Bechtel pritet të nisë së shpejti punën. Kostoja e projektit nuk është ende e përcaktuar qartë, por qeveria shqiptare ka përmendur shumën prej 500 milionë eurosh. Skavica u mbështet fillimisht nga Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian. Por në janarin e vitit 2021 BE u tërhoq. Në një kërkesë që Deutsche Welle i drejtoi Komisionit Europian, zëdhënësja e këtij institucioni, Ana Pisonero, sqaroi se: "Pas informacionit në lidhje me një memorandum mirëkuptimi midis Shqipërisë dhe SHBA-së për financimin dhe zbatimin e projektit të hidrocentralit të Skavicës dhe pas një sërë konsultimesh me qeverinë e Shqipërisë, BE informoi Shqipërinë për vendimin për të përfunduar grantin e Fondit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor, mbi përgatitjen e investimit, më 15 janar 2021. Edhe pse i takon Shqipërisë të vendosë projektet që përfshihen në Planin Ekonomik të Investimeve, është e rëndësishme të ruhet qendrueshmëria në përparësitë që investimet e mëdha të zbatohen me sukses. Projekti Skavica u përfshi në Planin Ekonomik të Investimeve për Ballkanin Perëndimor me kërkesën e Shqipërisë, dhe më pas u tërhoq, pas marrëveshjes midis Shqipërisë dhe SHBA".

Pasi mori përgjigjen e BE-së, Deutsche Welle i dërgoi një sërë pyetjesh edhe zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë, në disa kërkesa të ripërsëritura, për të mësuar më shumë rreth tërheqjes nga marrëveshja fillestare me BE-në dhe me fatin që do të kenë banorët e fshatrave të Dibrës që preken nga projekti. Pyetjet tona nuk morën përgjigje.

Deri tani banorët janë krejtësisht të paqartë dhe të painformuar se çfarë do të ndodhë me ta, tokat dhe bagëtinë e tyre. "Po të ndërtohet Skavica, ne na përmbyt tokat, shtëpinë e na përmbyt shpirtërisht të gjithëve" – i tregon DW Hazis Çerpja, banor i Zall-Dardhës, një nga fshatrat e Dibrës që do të preket nga ndërtimi i hidrocentralit.

Marrë nga Deutsche Welle
www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-hidrocentrali-i-skavic%C3%ABs-projekti-i-kund%C3%ABrshtuar-prej-dekadash/a-63703762

Skano ose ndiq linkun e mëposhtëm për të parë videone: https://www.facebook.com/dw.shqip/videos/5593277497419334

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 193-195

KËSHILLA PRAKTIKE PËR DËGJESAT PUBLIKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS:

aktualitet

Mos harroni kurrë të **dokumentoni gjithçka** nga këto takime, **që të keni dëshmi ligjore të vlefshme**

Procesi për ndërtimin e Skavicës, të paktën nga deklarime publike, duket se po vazhdon. Pjesë e qenësishme e këtij procesi, është përfshirja e banorëve në konsultime. Kompania ndërtuese dhe agjenci të ndryshme shtetërore e kanë për detyrë ligjore që të përfshijnë banorët, të cilët preken direkt nga projekti, në këto konsultime publike.

Në kushtet kur banorët duan të shprehin kundërshtinë e tyre ndaj projektit - ose të paktën, të kërkojnë të plotësohen të drejtat e tyre në cilëndo situatë, konsultimet publike janë një ndër mënyrat më efikase për ta shprehur këtë kundërshti.

Shikoni udhëzimet më poshtë, të p7rgatitura nga ekspertë ligjore, dhe merrni pjesë aktivisht. Megjithëse opinionet e shprehura me zemërim, me tone të forta, komentet në rrjetet sociale kundërshtuese ndoshta kanë një lloj ndikimi, baza e reagimit duhet të jenë opinione të shprehura me qetësi, me argumente dhe me kërkesa legjitime. Mos e humbisni rastin të merrni pjesë, të komentoni dhe të dokumentoni ngjarjet. Për më hollësisht, lexoni më poshtë disa këshilla të përgatitura nga ekspertët ligjorë.

Sigurohuni që të ketë një procesverbal të diskutimit. Sigurohuni që komentet tuaja janë shënuar saktësisht në procesverbal dhe shkruani çdo informacion të ri ose shtesë të diskutuar ose referencë eksperti. Sigurohuni që e praktikoni të drejtën tuaj për të marrë pjesë - jepni komentet tuaja dhe sqaroni pyetjet tuaja gjatë seancës. Nëse nuk është kështu, mbani prova dhe kërkoni që ky fakt të vihet në dukje siç duhet nga autoritetet. Shmangni diskutimin jashtë regjistrimit dhe diskutimin jashtë temës. Lidhu me përfaqësuesit e pranishëm të mediave që raportojnë për dëgjimin publik. Ju mund të tërheqni vëmendjen e tyre për dështimet e mundshme në procedurë. Kushtojini vëmendje folësve të tjerë. Ju mund të gjeni aleatë që mbështesin komentet tuaja.

SHKURTESAT:
VNM- Vlerësimi I Ndikimit në Mjedis
NJQV-Njësia e Qeverisjes Vendore
AKM-Agjencia Kombëtare e Mjedisit
DRM-Drejtoria Rajonale e Mjedisti
ARM-Agjencia Rajonale e Mjedisit

I. KONTROLLET PARA SEANCËS PUBLIKE PËR VNM:

1. Kontrolloni vazhdimisht (çdo javë) nëse është publikuar njoftimi për dëgjesat publike nga Bechtel.

Linqet për të kërkuar informacionin për këtë janë:

- nga AKM në **https://akm.gov.al/publiku/;**
- nga DRM Dibër në **http://drmtirane.akm.gov.al/faces/konsultimmepublikun.xhtml; dhe**
- nga DRM Kukës në **http://drmlezhe.akm.gov.al/faces/konsultimmepublikun.xhtml**

Nëse njoftimi publikohet edhe nga AKM dhe ARM, shkarkoni dokumentet për t'i pasur në arkivën tuaj.

2. Pasi AKM të jetë njoftuar, Zhvilluesi (Bechtel në këtë rast) duhet të publikojë në mediat audiovizive lokale dhe kombëtare, si dhe në faqen e projektit, njoftimin për dëgjimin publik, të paktën 20 ditë rresht, përpara datës së njoftimit për dëgjesat publik.

Gjithashtu, data e seancës publike duhet të caktohet të paktën 30 ditë nga dita e njoftimit të AKM-së. Njoftimi për media duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a. Emri dhe adresa e Zhvilluesit;

b. Qëllimi dhe vendndodhja e Projektit;

c. Vërtetim që AKM është njoftuar për seancën dëgjimore - Për t'u kontrolluar dhe verifikuar, shih pikën 1 më sipër;

d. Vërtetim se kopjet e raportit të thelluar të VNM-së janë të ekspozuara në ambientet e ARM-së dhe ambientet e NJQV-së (duhet të ketë 30 kopje në çdo ambient) – Të kontrollohen dhe verifikohen edhe me foto.

e. Vërtetim se Kopjet e Përmbledhjes jo-teknike të VNM-së janë të ekspozuara në ambientet e ARM-ve dhe të NJQV-ve (duhet të ketë 100 kopje në çdo ambient) - Të kontrollohen dhe verifikohen në ambiente me foto.

f. Konfirmimi që versioni elektronik i Përmbledhjes joteknike të VNM-së është publikuar në faqet e internetit të AKM-ve, ARM-ve dhe NJQV-ve - Për t'u kontrolluar dhe verifikuar, shihni 1 më sipër.

g. Konfirmimi se materialet informuese të Dëgjesave Publike mund të gjenden gjithashtu në zyrat e zhvilluesit (Bechtel) dhe/ose në faqen e projektit për Skavicën.

h. Ftesë për këdo që të japë komente ose opinione me shkrim, afatin për paraqitje të tilla (jo më pak se 20 ditë nga publikimi i njoftimit), personin e kontaktit të Zhvilluesit dhe adresën (postë ose nëpërmjet e-mail) si dhe adresën e kontaktit të AKM-së (postë ose nëpërmjet e-mail) për paraqitjen e komenteve.

3. Kini parasysh se njoftimi duhet të përfshijë gjithashtu informacion të mjaftueshëm për kohën dhe vendin ku do të mbahet seanca dëgjimore. Është gjithashtu e rëndësishme të kontrollohet nëse të gjitha dokumentet e sipërpërmendura janë të disponueshme në të gjitha ambientet e listuara më sipër gjatë periudhës që do ndodhë dëgjesa.

4. Përsëri: Dokumentoni, regjistroni, dokumentoni gjithçka!!!

II. PËRGATITJA PARA SEANCËS PUBLIKE TË VNM-SË:

1. Kontrolloni dhe inspektoni përmbajtjen e dokumenteve në dispozicion. Mbani shënime për dokumentet që mungojnë dhe reflektoni këtë çështje në komentet tuaja (veçanërisht në formë të shkruar).

2. Kontrolloni informacionin e dhënë p.sh., vendndodhjen e projektit, madhësinë, etj.

3. Përgatitni paraprakisht pyetje dhe komente fillestare, ndoshta të mbështetura me të dhëna dhe referenca për disa çështje (mjedisore – toka, uji, ajri, biodiversiteti, zonat e mbrojtura, sociale, ekonomike, trashëgimia kulturore dhe arkeologjia, ndikimet ndërkufitare)

4. Informoni dhe ftoni OJQ-të në dëgjimin public.

5. Informoni dhe ftoni mediat të raportojnë për dëgjimin publik.

III. GJATË SEANCËS SË DËGJIMIT PUBLIK:

1. Sigurohuni që të ketë një procesverbal të diskutimit dhe që komentet tuaja të jenë shënuar siç duhet.

2. Kontrolli për pjesëmarrje – Të gjithë ekspertët e përfshirë në përgatitjen e VNM-së duhet të jenë të pranishëm; Pyetni për emrat e tyre dhe pjesët e përgatitura nga secili. Gjithashtu, duhet të ketë të paktën një përfaqësues nga AKM, ARM dhe NJQV. Kontrolloni gjithashtu nëse dokumentet e identitetit të pjesëmarrësve janë duke u mbajtur shënim në procesverbal nga organizatorët.

3. Sigurohuni që komentet tuaja janë shënuar saktësisht në procesverbal dhe shkruani çdo informacion të ri ose shtesë të diskutuar ose referencë eksperti.

4. Sigurohuni që e praktikoni të drejtën tuaj për të marrë pjesë - jepni komentet tuaja dhe sqaroni pyetjet tuaja gjatë seancës. Nëse nuk është kështu, mbani prova dhe kërkoni që ky fakt të vihet në dukje siç duhet nga autoritetet.

5. Shmangni diskutimin jashtë regjistrimit dhe diskutimin jashtë temës.

6. Lidhu me përfaqësuesit e pranishëm të mediave që raportojnë për dëgjimin publik. Ju mund të tërheqni vëmendjen e tyre për dështimet e mundshme në procedurë. Për më tepër, ju mund të përdorni mjetet e mediave sociale (si Facebook Live) për dokumentacion dhe komunikim.

7. Kushtojini vëmendje folësve të tjerë. Ju mund të gjeni aleatë që mbështesin komentet tuaja.

IV. PAS DËGJIMIT PUBLIK/ PARAQITJA E KOMENTEVE

1. Përgatitni komentet tuaja (përfundimtare) në formë të shkruar dhe dërgojini ato në AKM, sigurohuni që të gjitha ato të jenë shënuar siç duhet dhe sigurohuni që të merrni konfirmimin me shkrim nga autoriteti publik për marrjen.

2. Këshilla për përgatitjen e komenteve:

- Mundohuni të përfshini sa më shumë fakte.
- Referimi në punime shkencore, opinione të ekspertëve dhe dokumente të ngjashme do t'i sjellë peshë serioze komenteve tuaja.
- Marrja e mbështetjes nga komuniteti i ekspertëve ose komuniteti lokal është një pasuri.
- Nga pikëpamja teknike, përpiquni t'i strukturoni komentet sa më qartë që të jetë e mundur (organizojini ato në kapituj/paragrafë dhe referojini ato me pjesët e VNM-së që po kundërshtoni etj.).
- Në fund të komenteve/deklaratës suaj, kujtojini autoritetit publik se ata kanë detyrimin të marrin parasysh siç duhet komentet. Mos harroni të shtoni të dhënat tuaja të kontaktit.

3. Është shumë e rëndësishme që komentet t'i drejtohen autoritetit kompetent brenda kornizës kohore të caktuar ligjore. Prandaj, llogaritni saktë datat/afatet – Kontrolloni afatin për komente në njoftim sipas pikës 2 më sipër. Shmangni dërgimin e komenteve në momentin e fundit, përveç nëse është mundësia e vetme.

4. Sigurohuni që të ketë prova të dorëzimit të komenteve tuaja në kohë (p.sh., postoni dokumentin e konfirmimit, numrin e arkivit të autoritetit përkatës, emailin, etj.).

koment

Skavica nuk mund të ndërtohet, sepse do jemi përballë faktit që lumi Drin do jetë i vetmi lumë në botë që futet i tëri në kaskadë, duke u kthyer i tëri në një lumë artificial, ç'ka mund të sjellë pasoja të rënda për shirat lokalë, për faunën dhe florën, për lagështinë e për ekosistemin.

20 arsye pse nuk duhet ndërtuar Skavica

Nga prof. **SAZAN GURI***

Për të gjithë ju që mendoni se duhet ndërtuar Skavica!? Si dikur më 1961 t'i bëhej qejfi druzhe Titos, sot del prapë si ëndërr nga sirtari për t'i bërë qejfin druzhe Vuçiç, dhe ndërtohet një fabul perfekte propagande se:

- Gjoja do të rregullojmë përmbytjet në nën Shkodër!
- Gjoja na duhet një rregullator i bilanceve energjetike!
- Gjoja, ndaj kemi krizë, se nuk shfrytëzojmë si duhet potencialin e lumenjve tanë!

Një HEC si Skavica na shpëton përfundimisht dhe sot, inxhinierë e ambientalistë shqiptarë të keqinformuar e titistë, meqenëse iu pëlqen të jetë kështu, as e vrasin trurin fare që të pyesin pjesën e majtë të trurit që mbart logjikë, a mund të jetë me të vërtetë kështu?

Absolutisht jo, përkundrazi, sepse:

1. Vepra të tilla iu përkasin diktaturave, të cilat nuk marrin parasysh të drejtat e pronës dhe të lirive njerëzore;

2. Skavica nuk përngjet me kaskadën e digave të njohura mbi lumi Drin, ku niveli i ujit ngrihet brenda kanionit shkëmbor;

3. Skavica nuk ndikon aspak ose nuk luan rol fare në përmbytjet e zonës së nën Shkodrës, sepse janë pesë lumenj të tjerë si Moraca dhe Kiri mbi Bunë, si dhe lumenjtë e Shalës, e Nikaj Mërturaj dhe të Valbonës që derdhen nën Fierzë ose mbi Koman. P.sh. 80% e përmbytjes në Bunë nduk ndodh për shkak të Drinit të zi, por për shkak të lumit Moraçë që mbledh tre të katërtat e prurjeve ujore të Malit të zi, pastaj edhe të Kirit, dhe ajo pjesë tjetër për shkak të prurjeve të Drinit të zi që lidhet totalisht me prurjet e Drinit prapa Fierzës, duke filluar me lumi Valbonë që ndodh të këtë edhe 200mm shi / ditë, me lumenjtë e Nikajt Mërturaj e të atij të Thell-Shalë e Shoshaj.

4. Drini i Zi e ka vendosur ekuilibrin e vet natyror me Fierzën, qysh kur ai komandohet në mënyrë natyrore nga portat e liqenit të Ohrit në Strugë, si dhe nga dy diga apo liqene të tjerë në territorin e Maqedonisë së Veriut;

5. Skavica nuk është HEC rentabël, sepse 1MW energji ajo nuk e prodhon për 10-12ha tokë të përmbytur, por e prodhon 1MW për 50-60ha tokë të përmbytur, që do të thotë që me këtë pesëfish tokash të përmbytura të prodhimit të saj, prej 9000 ha, energjia mund të blihet me një njësi prodhimi dhe të ngelen katër njësi të tjera;

6. Skavica shpërngul 20,000 banorë, që arrin të përmbytë deri në 16,000ha, gjë e cila quhet përmbytje e përhershme dhe me dëme të pakthyeshme, ndërkohë që përmbytja në Shkodër, sidoqoftë është përmbytje e përkohshme, disa ditore dhe me dëme të kthyeshme.

7. Digat në Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës janë të inkastruara në shkëmbinj të fortë e të kapur si darë në shkëmbinjtë gëlqerorë silicorë pelalgjik dhe në rreshpe argjilore të Jurasikut të mesëm e të sipërm, që janë shkëmbinj natyrorë të papërshkueshëm, ndërsa në Skavicë, diga sado të kapet e inkastruar dhe e çimentuar fort në shkëmbinjtë e saj, por nuk ndihmohet nga pjesa tjetër e shkëmbinjve pranë e përreth, të cilët përfaqësohen me një përbërje litologjike, duke filluar nga brekciet ofiolotike e ranorë të Jurasikut të sipërm, pastaj aty pranë vazhdohet me konglomerate të Pliocen Quaternarit, diku më tej me karbonate silicore të Jurasikut të mesme e të sipërm, pak më tej me gravelite e ranorë të Perm – Triasit, e pak më tej rreshpe silicore të Silurian-Devonianit dhe e mbyllin qarkun rreth digës rrëzime e horizonte vidhisës, që të gjithë këta komponentë litologjikë, ndryshe nga kaskada e njohur e lumit Drin janë të përshkueshëm, duke përbërë një nga faktorët përcaktues për mosndërtimin e saj. Kjo do të thotë që uji mund të shpërthejë dhe të depërtojë anash digës, duke e rrezikuar seriozisht ndërtimin e saj, qoftë me çimentim të një shkalle të lartë, sepse e keqja nuk vjen nga diga, por nga bazamenti shkëmb që mban digën. Pra, edhe Zoti apo natyra po na thotë se Skavica nuk duhet të ndërtohet.

8. Skavica ndodhet në një zonë tektono-sizmike më të lartë se ajo e kaskadës së Drinit të njohur, dhe si e tillë pesha e ujit prej 7 miliardë m3, (tre herë më shumë se Fierza ose dy herë më shumë se kaskada e sotme e njohur e Drinit) mund të 'trigerojë' tërmete shtesë dhe të nxisë kështu tërmetet natyralë të zonës.

9. Nëse larg qoftë, ndodh diçka në kaskadën e Drinit mund të kemi përmbytje, sikundër kemi deri në Shkodër, ndërsa përmbytja e Skavicës, për shkak të një tërmeti ose të një rrjedhje shkëmbore të njohur, mund të sjellë cunam për Digën e Fierzës, dhe të dyja së bashku mund ta çojnë cunamin deri në brigjet e Italisë, përfshi përmbytjet në Kukës,

Në foto: Sazan Guri me mbrojtësit e lumit të Setës në gjykatën administrative

Prizren, Gjakovë e Pejë.

10. A nuk është absurde, edhe Skavicë me tokë të përmbytur e dëbim popullsie, edhe 1260 Hec-e të vegjël e të mesëm, duke lënë pa ujë bujqësinë, blegtorinë dhe banorët e zonave malore në veri, lindje e juglindje të Shqipërisë?

11. A nuk është absurde që me bërjen e Hec-it të Banjës, Bushatit, Moglicës me përmbytje tokash bujqësore, plus edhe 30% të tokave të bukës të kthyera në toka urbane, të vazhdosh me monokulturë prodhimi energjie, siç po na serviret kjo e ujit. Këtu shtrohet pyetja tjetër: a nuk kanë male Zvicra, Serbia, Mali i Zi etj., dhe a nuk mund të prodhojnë edhe ato energji prej ujit (hidro) me mbi 200%, sikundër po duam të prodhojmë vetëm ne?!.

12. Skavica përmbyt 22 monumenta kulture, biomonumente, gjeomonumente, dhjetëra vendbanime parahistorike (Tuma e Zojcës, i Topojanit, Ushtelenxës, i Çetushit) dhjetëra kala, kisha, nekropole, tuma dhe 11 Qytete Peneste antike e para antike sipas Tit Livit, Polibit, ku zanafillon jeta në tokë pas asaj të futjes së njeriut në shpella, që janë objekte kulture për njerëzinë evropiane jo vetëm për atë shqiptare, ndërsa kaskada e njohur e lumit Drin nuk bën dëme të tilla të pakthyeshme.

13. Energjia e përfituar nga Skavica, në fund të fundit sot është prodhim për Bursë, pra përfitim në grup, ndërsa dëmi i pakthyeshëm është personal, ku e pëson vetëm Shqipëria, më saktë e pëson vetëm Dibra e dibrani, që në fakt boll e ka pësuar nga HEC-et e mëparshme.

14. Skavica nuk duhet ndërtuar, sepse s'ka konsultim me publikun, sepse ajo nuk është vepër publike, që individi dhe grupi të sakrifikojë me pronën e vet. Sepse, ajo thjesht si produkt hyn në rrjet ndërkombëtar 400 kV, jo për të shkuar brenda vendit si dikur, por shërben për ekuilibra midis energjive të zeza, kafe dhe jeshile në midis shteteve. Ne si shtet po rritemi në prodhimin e energjisë elektrike, a kemi parë ulje apo rritje të çmimit të saj?! Përkundrazi, njësoj si të tjerët në Evropë, po aq krizë dhe në mos më keq.

15. Skavica mund të kompensohet, duke rehabilituar humbjet në rrjet, kur shkenca dhe praktikat më të mira botërore njohin 5-6% humbje të tilla, ndërsa ne sot kemi ende 35% humbje në rrjet që do të thotë sa vetë Skavica, pra nuk ka nevojë të ndërtohet nëse duam dhe dimë të menaxhojmë humbjet?!

16. Skavica nuk mund të ndërtohet, edhe sepse ajo nuk sjell punësim, ajo nuk sjell drita për zonën, aq sa sjell punësim e drita Fierza për banorët përreth, por këtu shtrohet pyetja se a punëson më shumë turizmi, nëse hidhet 1% e këtij investimi apo HEC-i i Skavicës? Kur dihet se një shtrat turizmi punëson, jo më pak se 4 persona. Shkurt, një bujtinë Agora në Fierzë, direkt dhe indirekt, punëson më shumë se HEC-i Fierzës.

17. Skavica nuk mund të ndërtohet, sepse do jemi përballë faktit që lumi Drin do jetë i vetmi lumë në botë që futet i tëri në kaskadë, duke u kthyer i tëri në një lumë artificial, ç'ka mund të sjellë pasoja të rënda për shirat lokalë, për faunën dhe florën, për lagështinë e për ekosistemin.

18. Skavica nuk mund të ndërtohet, sepse nuk janë shteruar projektet e tjerë me bazë energjie diellore, eolike, gjeotermie dhe biogazi. Po si ka mundësi, kur ende nuk dimë sesa do të jetë raporti i këtyre investimeve alternative, përfshi edhe ato me LNG në Gjirin e Vlorës, kur ende nuk dimë sesa

Skavica nuk është HEC rentabël, sepse 1MW energji ajo nuk e prodhon për 10-12ha tokë të përmbytur, por e prodhon 1MW për 50-60ha tokë të përmbytur, që do të thotë që me këtë pesëfish tokash të përmbytura të prodhimit të saj, prej 9000 ha, energjia mund të blihet me një njësi prodhimi dhe të ngelen katër njësi të tjera;

Skavica shpërngul 20,000 banorë, që arrin të përmbytë deri në 16,000ha, gjë e cila quhet përmbytje e përhershme dhe me dëme të pakthyeshme, ndërkohë që përmbytja në Shkodër, sidoqoftë është përmbytje e përkohshme, disa ditore dhe me dëme të kthyeshme.

do jetë prodhimi total i HEC-ve të mesëm e të vegjël, dhe ndërmerren vepra të tilla të tipit diktatorial?!

19. Nuk është Skavica që ul përmbytjet në Shkodër e nën Shkodër, por baseni ujor i Drinit i lënë në mëshirë të fatit pa pemët e duhura dhe të djegura tashmë, kur dihet se baseni ujëmbledhës i Drinit prej 14,000km2 x 100ha x 1000 pemë/ha x 300 litra ujë/pemë që thithet në rast shiu do të thotë që shiu në Kukës shkon për dy orë në Bushat, nga dy muaj që do i duhej, nëse do thithej e do nxirrej gradualisht nga pema.

20. Kësisoj dhe si përfundim, Skavica është një ëndërr e keqe që flinte në sirtar dhe e kurdisur nga planet serbe për shpopullim të shqiptarëve dhe gjunjëzim të dibranëve, sepse janë këta dibranë që kanë ndalur hovin serbian, sepse janë këta dibranë që kanë shpëtuar Shkodrën e Durrësin anembanë më 1912-1921, se ndryshe serbët do kishin mbërritur me qindra herë në Durrës te 'Stara serbskaja', nëse nuk do ishin dibranët, sikundër grekët po aq herë në Shkumbin po të mos ishin lebërit e kurveleshasit apo burrat e Golemit, të Nivicës a të Progonatit. Ndaj, atë që ata (serbët) nuk e bënë dot me luftë e me pushkë po e bëjnë me anë të rilindjes së sotme me penë e diplomaci. Ndaj dhe nxorën nga sirtari këtë ëndërr të keqe e plot paturpësi. Ndaj dhe ju dibranë çohuni e zgjohuni për betim të gjyshërve dje dhe për hatër të fëmijëve tuaj nesër.

Zgjidhjet:

1. Një grup avokatësh të nivelit të lartë në fushën e jurispudencës, një grup ekspertësh të nivelit të lartë në fushën e gjeologjisë, hidroteknikës, mjedisit të mblidhen sot, se nesër është vonë, për të krijuar argumentet e këtyre fushave - pse HEC-i Skavicës realisht nuk ndërtohet dot për shkaqe madhore natyrore, jo vetëm dhe thjesht për mosdashje të dibranëve, të cilëve iu shkatërrohet jeta, pa thënë atë se popullit shqiptar i humbet zanafilla, ndërsa atij Evropian i humbet gjeneza?!.

2. Me këto argumente të organizohen tryeza shkencore e të kërkohen takime me:

a. Dy komisionet e Kuvendit si atë të Ligjeve dhe atë të Mjedisit.

b. Dhe me vetë kompaninë për t'i treguar risqet natyrore si forcë madhore që nuk mund të ketë bankë bote të harxhojë pare në këto gropa e kaverna me humbje të mëdha uji.

c. Grupe inxhinierësh dhe ekspertësh mjedisorë deri në qytetarë të lirë për t'iu shpjeguar se Skavica nuk është, sikundër e thonë, rregullator i kaskadave të njohura, përkundrazi është tërmet i pandalshëm për to.

Për ata që nuk besojnë në Zot:

1. Zoti ka kurdisur tokën, dhe mbi tokë ka kurdisur ujin, pa të cilin nuk jeton dot as njeriu as edhe ato qenie që i shërbejnë njeriut me anë të ujit, ndaj vetëm ai e di sesi ja jep njeriut këtë ujë si lumë apo si liqen.

2. Ndaj zoti Kryeministër që nuk je Zoti, boll e ktheve Drinin e Zi në liqen;

3. Boll janë 'shporrur' dibranët nga trojet e tyre të paktën 8000 vjeçare, qyshkur doberët - njerëzit e dëborës - zbritën të parët nga shpellat.

** Prof. asoc. Sazan Guri është një ambientalist, gjeolog nafte dhe inxhinier. Është një nga aktivistët e mbrojtjes së Skavicës. Ai i ka dhënë një mbështetje të fortë qytetarëve të Dibrës,veçanërisht në mbrojtjen e ujërave dhe natyrës së Kanionit të Setës.*

KJO FUSHË E BUKUR...



Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Kjo fushë e bukur, më e bukura dhe më pjellorja e Dibrës që ujitet nga uji i malit dhe uji i Drinit të zi, kjo fushë në të cilën TasimKarasani mori në vitet '50 NJËQIND kuintal për hektarë misër të varietetit të njohur "Farë Madh"...

Kjo fushë ku i bashkëngjitet Fusha e Ushtelencës, Cetushit dhe Katundit të Ri duke formuar ekspozitën e madh të prodhimeve bujqësore të Dibrës, të prodhimit të misrit, grurit, fasules, perimeve e në kodrat rreth e qark (Gjaricës nga ku është fiksuar fotoja nga Edmond Hasani), të vreshtave të Dohoshishtit e të pemëtoreve të Luznisë...

KJO FUSHË DO TË MBYTET...

Qeveritë e ditëve të këtyre tre dekadave, të djathta e të majta, kanë harruar aksiomën e jetës se toka është mjet i pazëvendësueshëm në jetën njerëzore, se për të shtuar atë në shërbim të prodhimeve që mbajnë jetën gjallë po synohet (dhe po veprohet) që edhe shkretëtira e Gobit në Azinë Qendrore, edhe Saharaja të ujiten e të vihen nën kulturë, këta qeveri, me Skavicën dhe me betonizimet masive bëjnë krimin më monstruoz historik.

Kjo pamje duhet të mbetet përgjithnjë siç e ka krijuar natyra.

Kjo pamje duhet të sistemohet, kullohet e ujitet, kultivohet me dije e kulturë shkencore.

U takon dibranëve që ta mbrojnë atë.

Është thirrja ime, thirrje e një njeriu që ka 15 vjet që shkruan e bërtet "PO DIBRËS! JO SKAVICËS".

Desha që këtë verë ti bija Luginës së Drinit nga Gjorica në Skavicë.

Nuk u gjet një "kalë", edhe pa "samar" e "shalë", ti fotografoja ato vende e fotografitë me ngjyra ti krahasoja me fotot bardhë e zi të arkivit tim prej dhjetëmijë negativësh 1964-1996.

Nuk iki pa i ngop sytë e shpirtin me ato pamje që nuk kanë shembull të dytë. / *Athinë, 3 tetor 2022*

OPINION

Skavicë do të thotë më shumë mjegull, zymtësi dhe zhdukjen përfundimtare të Dibrës së Poshtme

Nga **MAJLINDA HOXHA ***

Nëse më herët emri Dibër të kujtonte qershitë, jufkat, arrat apo të tjera, tani ky emër të lidh menjëherë me problemin Skavica.

E cilësoj si të tillë, se nëse për qeverinë apo disa të tjerë, ky emër do të thotë përparim, strategji, pavarësi; për Dibrën do të thotë sfidë për ekzistencë.

Dhe meqë u njoftova se atje po bëhen disa takime me banorët në lidhje me këtë problematikë , vendosa të udhëtoj nga Tirana dhe të bëhem pjesë e këtyre bisedave.

Në udhëtimet e mia të panumërta, e kam parë lumin Drin si një pjesë e pandashme e Dibrës dhe kam shijuar çdo reflektim dielli mbi të, apo shijuar çdo panoramë dallgësh që na është shpërfaqur.

Çuditërisht, këtë herë, teksa shihja se si ecte në shtratin e tij natyral, më vinte vetiu një ndjesi e pazakontë keqardhje. Drini si viktima dhe xhelati Skavica mbi "trupin e tij" për të kryer ekzekutimin.

Mund të duket i papërshtatshëm krahasimi, por a ka gjë më të papërshtatshme se shkatërrimi, dëmtimi i elementeve bazë të ekosistemeve që bën të mundur përshtatjen dhe jetesën tonë në to?!

Midis gjithë këtyre mendimeve arrita në fshatin ku mbahej takimi i radhës me banorët.

Këto takime mbaheshin në kuadër të projektit "PO DIBRËS, JO SKAVICËS!", mbështetur "Euronatur", nga një organizatë mjedisore europiane, dhe zbatuar nga "North Green Association", organizatë mjedisore vendase.

Takimi mbahej te lokali në qendër të fshatit dhe kishte një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish.

Pas prezantimit nga organizatorët të disa efekteve negative që sjell direkt projekti i Skavicës dhe referencave shkencore, radhën e kishin banorët të shprehnin opinionin dhe shqetësimet e tyre.

Ajo çfarë vihej re ishte uniteti për një JO të madhe Skavicës. Të gjithë kishin një zemërim të mbledhur ndër vite, duke pasur parasysh që ky projekt del në pah sa herë vjen një qeveri e re në pushtet.

Të gjithë, pa përjashtim, sillnin në vëmendje dëmet e mëdha që do u bëheshin nëse ndërtohej ky hidrocentral. Bënin pyetje për mostransparencën, paqartësinë e krijuar nga projektimi më i fundit dhe ndikimin e financimeve të huaja.

Por nuk mund të mos evidentohej qartë revolta dhe tonaliteti i zërit kur thuhej: "Do ta mbrojmë me ç'të mundim, edhe me jetën tonë". Kuptohej që ishte luajtur shumë me durimin dhe qetësinë e tyre. Sipas disa banorëve, kjo ishte zgjidhja e vetme që kish mbetur, meqë askush nuk i kishte pyetur deri më sot. Mbrojtja e vatanit dhe varreve të të parëve ishte detyrë e tyre tashmë.

Gjithkënd, kudo në botë, do t'a kishte çuditur ky raport qeveri-popull. Ku populli duhet të mbrohet nga qeveria, sikur të ishte duke u mbrojtur nga pushtuesi. Dhe qeveria, jo vetëm nuk pyet për sovranitetin e popullit që e voton, por e bën edhe plaçkë të interesave të të huajve. Ky ishte një tjetër konkluzion i një banori që foli në takim.

Pati edhe nga ata që kërkonin me ngulm që organizata europiane që mbështeste projektin, duhet ta dijë mirë se çfarë dëmi po tentohet t'i bëhet Dibrës dhe dibranëve.

Andej nga fundi e mori fjalën një banor rreth të 50-ave, i cili mbi të gjitha çfarë përmendi tha:

- Na thonë do zhvillohet turizmi. Po turizmin e sjell infrastruktura o vllazën, jo lluca e ujit. E sjell Dibra si është sot me këtë natyre e klimë të mrekullueshme. Prandaj duhet BASHKIM PËR EKZISTENCË.

Në të gjitha pohimet që kisha dëgjuar gjatë takimit, fjalia e fundit ishte KUSHTRIMI që dibranët i bën një dhe ua bashkon vuajtjet, dashurinë për vendin, nevojën për t'i mbijetuar këtij projekti dhe ruajtjen e identitetit dibran.

Të nesërmen e me radhë do vijonin takimet nëpër fshatra të tjerë. Por ajo çfarë nuk ndryshonte (e pohuar edhe nga organizatorët për takimet e mëparshme) ishte revolta e njëjtë te të gjithë banorët e fshatrave që cënohen direkt nga ky projekt, po ashtu edhe nga banorët e fshatrave përqark apo nga qyteti i Peshkopisë.

Të gjithë kishin të njëjtin shqetësim: se si të ndalonin medoemos ndërtimin e hidrocentralit t të Skavicës, i cili personifikon më shumë dritë për shqiptarët, por për dibranët do të thotë më shumë mjegull, zymtësi dhe zhdukjen përfundimtare të Dibrës së Poshtme.

** Aktiviste kundër ndërtimit të Skavicës*

cyan magenta yelloë black

intervistë

“Problemet gjeologjike në rrugën e Arbërit nuk qëndrojnë **politika nuk ka pasur vullnet për ta përfunduar”**

(Vijon nga faqja 3)

prurje të mëdha uji, që kur dilte në grykën e tunelit në Shëngjun, sasia e ujit ishte aq e mjaftueshme sa për të vendosur një turbinë elektrike. Ndërsa në tunelin e Murrizit thuhet vazhdimisht gjeologjia e ka fajin, por faktikisht nuk qëndrojnë këto pretendime për gjeologjinë. Defektet e punës dhe të organizimit të kompanisë i janë vënë gjeologjisë. Formacionet e tunelit të Murrizit nga krahu i Tiranës janë të mesatarisht të qëndrueshme, si tuneli i Krrabës, ndërsa pjesa tjetër është e qëndrueshme. Më e bukura është se këtë e merr përsipër ta thotë ministrja Balluku, që nuk është specialiste e fushës. Por le të dali një specialist, apo grup specialistësh dhe të sqarojnë opinionin se ku qëndron problemi gjeologjik i tunelit, sidomos tani kur nuk ka asnjë problem gjeologjik. Të gjitha janë probleme organizative të mungesës së drejtimit, sa të kompanisë, por edhe të ARRSH, Ministrisë së Infrastrukturës e Qeverisë. .

Pritshmëritë për të ardhmen për ta ndërtuar këtë rrugë?

Nuk e di. Këtyre nuk ju besohet sepse rruga e Arbërit është përdorur prej 20 vitesh vetëm për të marrë vota. Rruga është zhvillim dhe është fatkeqësi që është zgjatur kaq shumë, pasi do të duhej të kishte përfunduar që në vitin 2009. Kur ishte diskutimi me kompaninë Kineze dhe kur këta të fundit erdhën në Shqipëri dhe studjuan terrenin ku do të kalonte gjurma e pjesës që kishte mbetur, thanë se ne për dy vite e përfundojmë. Siguruan edhe fondet, por u prishën. Kjo edhe për faktin sepse fondi që u parashikua nga ata ishte shumë më i ulët se fondi me të cilën po punohet për rrugën e Arbërit sot, mos të them se gjysma e pagesës. Luhet me këtë investim të madh, por Dibra, Bulqiza, Klosi, Mati do të kishin dimension tjetër po të kishin rrugën. Sot jemi thuajse 20 vite që nga projekti dhe rruga nuk ka përfunduar, duke u lënë rrugëve.

Pak para zgjedhjeve të vitit 2021, qeveria e hapi për kalim rrugën e Arbërit, pavarësisht se nuk kishte përfunduar. Por ato segmente që konsiderohen të përfunduara, si ju janë dukur punimet?

Hapja e rrugës ishte sa për të thënë se ja rruga mbaroi. Bajpasi ishte në gjendje skandaloze, sepse pas 6 muajsh u shkatërrua në disa vende dhe u mbush plot gropa. U tha se ky bajpas do të ishte rrugë turistike me standarde, por puna në terren tregonte gjë tjetër. Shyqyr që erdhi kryeministri para ca javësh dhe i mbushën disi gropat. Është skandal kur shikon se si një pjesë e tunelit që u hap në fillim u shemb pasi kishin avancuar afro 400 metra. Por hapja e këtyre metrave na kushtojnë miliona euro sepse nuk mund të përdorësh lëndë eksplozive pa kriter, të krijosh shembje dhe të lesh këtë grykë tuneli ku janë shpenzuar miliona euro dhe të tërhiqesh e të fillosh një grykë tjetër, për mungesë të drejtimit teknik.

Sa transparente ka qenë qeveria në informimin e publikut lidhur me ecurinë e punimeve?

Në tunelin e Murrizit thuhet vazhdimisht gjeologjia e ka fajin, por faktikisht nuk qëndrojnë këto pretendime për gjeologjinë. Formacionet e tunelit të Murrizit nga krahu i Tiranës janë të mesatarisht të qëndrueshme, si tuneli i Krrabës, ndërsa pjesa tjetër është e qëndrueshme. Le të dalë një specialist, apo grup specialistësh dhe të sqarojnë opinionin se ku qëndron problemi gjeologjik i tunelit, sidomos tani kur nuk ka asnjë problem gjeologjik. Të gjitha janë probleme organizative të mungesës së drejtimit, sa të kompanisë, por edhe të ARRSH, Ministrisë së Infrastrukturës e Qeverisë.

Transparencë nuk ka lidhur me ecurinë e punimeve. Për një vepër kaq të rëndësishme si rruga e Arbërit, qytetarët duan të dinë si po shkojnë punimet. Në një takim në Pogradec ministrja Balluku tha se problemet gjeologjike na bëjnë që ta shtyejmë me 17 muaj. Në të dy tunelet kanë ngelur metrat e fundit për t’u kryer. Pjesa që ka ngelur është në shkëmb të fortë, masiv, pa prishje dhe pa asnjë pikë uji. Pra nuk ka asnjë problem gjeologjik, por zvarritja mund të vijë vetëm nga mungesa e drejtimit teknik. Kështu që edhe tani mund të dalin probleme po të përdoret lëndë eksplozive mbi normativat e caktuara duke zgjeruar më shumë hapësirën në dritë të tunelit, duke prishur strukturën e shkëmbit e duke provokuar shembje të blloqeve të lëvizur të cilët po të bien mbi pjesën e betonuar, në rast se janë krijuar hapësira mbi armaturën e betonit dhe ato hapësira nuk janë të mbushura, atëherë mund të rrezikohet edhe prishja e betonit. Por këto nuk do të jenë më probleme të gjeologjisë, por probleme të mungesës së një drejtimi teknik të kualifikuar. Kemi bërë propozime nga shoqatat LID e ND që të ngremë një grup specialistësh dhe të sqarojmë këto probleme gjeologjike, por propozimet kanë rënë në vesh të shurdhër.

Me drejtues teknikë të zotë e specialistë të mirë, të cilët kanë punuar në Ndërmarrjen e Ndërtim Minierave dhe kanë drejtuar e hapur me dhjetëra mijë metra tunele e traverbangje me kushte shumë më të vështira gjeologjike e prirje të mëdha uji, si ato Bulqizë-Batër, Klos-Bulqizë, traverbangjet e Shkallës, Qaf Barit, Gurit të Kuq, etj.të cilët tek ne nuk mungojë, por me mbylljen e kësaj nd/je janë pa punë ose janë larguar jshat shtetit, po të kërkoheshin e të viheshin në drejtim të këtyre punimeve, këto probleme do të zgjidheshin shumë kollaj.

INTERVISTË

Në foto: Bashkim Lleshi dhe Hysen Uka gjatë një ekspedite në terren, gusht 2013

“Rruga aktuale e Arbërit nuk është ajo çfarë kemi konceptuar me bashkëpunëtorët”

(Vijon nga faqja 4)

nuk janë bërë shpenzime për të bërë një studim fizibiliteti dhe një projekt inxhiniero-teknik e zbatimi të detajuar e mbi standardet aktuale europiane të ndërtimtarisë së rrugëve. Këto duke qenë afër qeverive i kanë u kanë kaluar në shpinë këtyre fazave të hartimit të projektit, puna për studimin gjeologjik të tuneleve është bërë me njohje empirike dhe jo me studime shkencore. Lexova një ditë që në Qafë Murrizi janë bërë shpime me sondë deri në 30 ose 40 metër, diçka jo logjike, ku tuneli në qafë e Murrizit fillon në kuotën 840 metër mbi nivelin e detit, ndërsa qafa është afro 1200 metër, pra ti futesh me sondë në thellësinë 30 ose 40 metër për të kuptuar strukturën e tokës edhe për 300 metër poshtë, më duket jo normale. Kjo ka ndodhur edhe për faktin se personat që kanë marrë zbatimin e projektit kanë qenë të pacënueshëm dhe i kanë bërë punët vetëm me vëzhgime sipërfaqësore, jo me punë të detajuar e mbi metoda e kritere shkencore. Personat që u morën me studimin e fizibilitetit, projektin inxhiniero-teknik, projektin e zbatimit edhe supervizimin e zbatimit ishin cikël i mbyllur. Të gjithë mbyllën sytë para një paudhësie me ndërtimin e rrugës nga qafa e Buallit deri në urën e Çerenecit, që shënon fillimin keq për të vazhduar keq e më keq. Në atë segment është bërë thjeshtë një përmirësim i rrugës së vjetër dhe askund në idenë e rrugës së re me parametra e standarde të kohës.

Rruga e Arbërit nuk është një rrugë thjeshtë dhe vetëm për Dibrën, është keqkuptim e gabim i madh të trajtohet si ide e projekt i tillë. Pagëzimi me emrin që ka sot rruga, nuk njihet dhe nuk gjendet në dokumentohet historike. Nuk ka asnjë dokument ku emërtohet rruga e Arbërit. Por ky pagëzim përmban dhe shpreh idenë dhe qëllimin e projektit, të lidhura me terrenin topografik ku konkretizohet ideja. E kemi pagëzuar me këtë emër, për faktin se ajo gjendet në territoret e Arbërisë mesjetare, përshkon mes për mes tokate Arbërore, nga bregdeti në Durrës e deri në kufijtë e Arbërisë mesjetare.

Profesor Bashkimi ka shumë të drejtë, pasi arsyeja e thënë se është gjeologjia çka pengon përfundimin e rrugës është thjeshtë për të fituar kohë në situatë të caktuar social-politike në vend. Një vëzhgues i thjeshtë, i vëmendshëm mbi terrenin, mbi natyrën, mbi rrugët, burimet – në kohën kur pretendojnë se tuneli ka avancuar në mbi 3000 metër në të dyja krahët, shumë mirë mund të shikojë se nga të dyja krahët nuk ka vërshime ujërash, siç pretendohej në fillim. Po ta shikosh në hyrje të tunelit nuk ka vërshime ujërash, siç thonë ata. A thua se po flitej për tunelin e “La Manshit” nën det. Pra nuk është logjike. Strukturat e paqëndrueshme argjilore nuk janë aspak problem me teknologjinë e sotme, për të ndërtuar edhe në struktura të tilla. Por nëse merr njerëz amator, që nuk ndruhen nga llogaridhënia ligjore nuk ka si ndodh ndryshe. Pasi të marrësh përsipër të ndërtosh një tunel është përgjegjësi ligjore, qoftë edhe një vepër më të vogël. Për sa kohë që ata nuk frikësohen se ‘nesër’ do të jenë përballë përgjegjësisë ligjore ata do ta vazhdojnë siç jua merr mendja dhe siç dinë ata. Fut dinamit pa hesap, avancojnë në argjil pa veshur me beton strukturat përkatëse etj, do ti kemi këto probleme.

Ajo që më shqetëson shumë është se ka një heshtje edhe nga mediat e rëndësishme që të verifikojnë në terren atë se çfarë po bëhet në tunelet e qafë Murrizit, pasi kemi një kuti të zezë në të cilën askush nuk e din se çfarë bëhet. Të gjithë flasin në mënyrë hipotetike. Media duhet të insistojë që të futet aty për të parë si punohet. Unë kam ndjekur me shumë interes dy vepra infrastrukturore madhore që përfunduan këtë verë, në Kroaci punimet në urën e Pelejshakut dhe urën e Moraçicës në Mal të Zi. Atje çdo ditë kishte në terren gazetarë, të cilët ndiqnin dhe raportonin se si po avancon zbatimi projekteve, pasi bëhej fjalë për përdorimin e taksat të qytetarëve.

Keni pritshmëri se një ditë rruga do të përfundojë? Mbase në atë kohë edhe figurativisht do të përfundonte edhe roli i lidhjes për ndërtimin e rrugës së Arbërit, për ti ngelur historisë si tregues i një përpjekje për disa dekada?

E ardhmja e këtij projekti është e sigurtë. Koha nuk është e qartë se kur do të realizohet. Ky është një projekt pa kthim. Që ky projekt të realizohet në tërësinë e vet do të ndikojnë edhe zhvillimet e tjera politike dhe shoqërore në rajon. Pasi këtu nuk është vetëm faktori Dibër, por është diçka rajonale që të përfundojë si rrugë. Ajo që unë kërkoj është që ti bashkohen edhe mediat e mëdha. Asnjë nga studiot televizive nuk kanë patur dëshirën që të flasin për këtë temë me njerëz të cilët kanë dijeni për këtë çështje. Për idenë fillestare të rrugës. Rruga e Arbërit nuk është nisëm për diçka lokale, por një rrugë me ndikim rajonal.

(Botohet me shkurtime)

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 193-195

Fushë-Bulqiza është katund me pasuri, ku mbi 300 hektarët e fushës së saj pjellore përbëjnë hambarin e kësaj krahine. Fusha përshkohet mes për mes nga rruga e Arbrit, një arterie që do të gjallërojë ekonominë në të ardhmen, do të shtojë bizneset dhe do të rrisë të ardhurat.

vështrime

Fushë Bulqiza – Katundi i enigmave, vendeve të shenjta, hambari bujqësor mes malesh

Nga **ADRIATIK BALLA***



Fushë-Bulqiza është fshati më i madh në sektorin e sipërm të luginës së Bulqizës, pozicionuar në pjesën lindore të saj. Në perëndim mbyllet tek kthesa e Bobet pranë fshatit Dragu, kurse në lindje përfundon tek Ura e Qytetit, duke u kufizuar me kreshtën e Temlës e më në jug nëpërmjet një përroske lidhet me fshatin Valikardhë. Në veri kufizohet me kodrat e Zhiranës dhe kodrat e Gropës, kurse në jug, territori i këtij fshati ndjek kreshtën e majës së Lopës, afro 2000 m. Brenda këtyre kufinjve, Fushë-Bulqiza ka një sipërfaqe 20 km katrorë, nga të cilat 8.5 km katrorë janë fushë e luginë, nën 900 m lartësi. Pjesa tjetër është mal që i përket krejtësisht malit të Lopës e pjesërisht kurrizit të Kaculit. Vetë katundi Fushë, i përbërë nga disa lagje, shtrihet nga 620 m në lindje e deri në 670 m në veri e perëndim.

PO SI ËSHTË FORMUAR FUSHË-BULQIZA E SOTME NË ASPEKTIN NATYROR?

Ne dimë që lugina e Bulqizës është formuar përgjatë një shkëputje të madhe tektonike tërthore. Formimi i relievit në këtë sektor lidhet me tektonikën bllokore dhe sektori luginor është formuar në strukturën grabenore, tiparet e së cilës shprehen në karakterin e rrafshtë të fushës së Vajkalit dhe të Fushë-Bulqizës, simetria e shpateve etj. Arsyeja se gjerësia e luginës në Fushë-Bulqizë është më e madhe lidhet me konet e depozitimit të përrenjve, që e kanë zgjeruar fushën deri në 3 km. Zgjerimi ka ndodhur kryesisht falë dy përrenjve kryesorë: përroit të Balgjait dhe atij të Dushajt, por pjesërisht ka ndikuar edhe përroi i Thatë që vjen nga mali i Lopës. Pra Fushë-Bulqiza është formuar në një strukturë grabenore dhe është zgjeruar në nivelin e sotëm nga konet e depozitimit të përrenjve, që kanë moshë kuaternare. Më herët, në Pliocen, kjo luginë ka qenë një liqen, madje pranë Lepurakëve janë gjetur edhe depozitime liqenore (Gjeografia Fizike e Shqipërisë, 1991).

Në regjistrimin austriak të vitit 1916, Fusha njihet me emrin Gropë, që përfshin lagjet Fushë, Pertej Zellini (Terzalla) dhe Keca (Kica), me 108 shtëpi e 113 familje, me 717 banorë. Nga këta, banorë 8 regjistrohen me besim ortodoks lindor, kurse pozicionimi i këtyre 8 banorëve si serbo-kroatë duket tërësisht i gabuar, nje lapsus, pasi nuk figuron në tabelën përmbledhëse. Madje dhe numri i ortodoksëve krahasuar me katundet e tjera duket i madh, pasi janë 19 ortodoksë (8 Fusha, 10 Lepuraku, 1 Vajkali) vetëm në Bulqizë, në një kohë që e gjithë nënprefektura e Zerqanit ka të regjistruar 24. Kjo nuk shkon. gjithsesi, në rastin më të mirë kemi të bëjmë me dy ose tri familje të besimit ortodoks.

Në vitin 2007 Fusha kishte 1494 banorë (768 meshkuj e 726 femra), me 399 familje, kurse në vitin 2003 rezultojnë të regjistruar 418 familje. Natyrisht, sot ka më pak banorë, pavarësisht se nga Fusha janë larguar më pak njerëz se fshatrat Dushaj e Koçaj që janë në zona më të thella.

Ky katund përshkohet mes për mes nga Zalli i Bulqizës e deget e tij, ndërsa bimësia është e kultivuar në sektorin verior dhe natyrore në sektorin jugor. Fauna është relativisht e pasur, tokat janë kryesisht aluvionale e pjesërisht të kafenjta.

Fusha e madhe ka një sipërfaqe arë 120 hektarë, kurse fusha e vogël ka sipërfaqe arë afro 50 hektarë. Fshati Fushë-Bulqizë kishte të regjistruar në komunë 276 hektarë tokë, 22 hektarë pemëtore e 12 hektarë vreshtë. Gjithsej ky fshat ka mbi 330 hektarë tokë të punueshme, nga 708 hektarë që ka gjithsej komuna e Fushë-Bulqizës me katër fshatrat e saj.

Të gjitha burimet, apo shtigjet e analizës që na japin këto burime, na çojnë në konkluzionin se Bulqiza e sotme nga qafa e Buallit e në urën e qytetit e kishte emrin Zeza, ndërsa Fushë-Bulqiza e ka pasur emrin Gropa.

Nga regjistrimet e komunave në vitet 2007-2009, në kuadër të planeve të zhvillimit, duke bërë krahasimet, mësojmë se Fushë Bulqiza del fshati i tretë më i madh në Bashkinë Bulqizë, pas Gjoricës së Sipërme dhe Homeshit që kishin respektivisht 2093 dhe 1535 banorë, por ka pak më shumë se Gjorica e Poshtme. Madje Fusha është katund më i madh se tre lagjet e Trebishtit të marrë së bashku, apo se dy Ostrenët të marrë së bashku.

Për të folur për Fushë-Bulqizën e sotme ne së pari duhet të flasim për toponimin Bulqizë, nga vjen, si na shfaqet ai përgjatë historisë? Si emër i plotë na del vetëm në dokumentet osmane pas pushtimit otoman, po më përpara çfarë emri mbante?

Të gjitha burimet, apo shtigjet e analizës që na japin këto burime, na çojnë në konkluzionin se Bulqiza e sotme nga qafa e Buallit e në urën e qytetit e kishte emrin Zeza, ndërsa Fushë-Bulqiza e ka pasur emrin Gropa. Le t'i analizojmë këto dy toponime:

1. ZESSIZA, OSE E ZEZA

Barleti përdor vetëm një emër, Vajkal, ose lugina vajkale, e cila siç dihet botërisht tashmë, është sektori i sipërm i luginës së Bulqizës nga qafa e Buallit në perëndim e deri në ura e qytetit në lindje. Shpjegimin më të besueshëm për Vajkalin, në pikëpamjen time gjithmonë, e jep Eqerem Çabej, duke e zbërthyer nga latinishtja. Dihet qe Valle (Valley në anglisht), emërtohen luginat. Valle-Callis do të thotë rrugëkalim, ose rruga e luginës. Vajkali është i tillë. Edhe sot, në literaturën tonë gjeografike, njihet si luginë e Vajkalit. Më në lindje kemi Valle Carde, që për mendimin tim si vijim i termave latinisht, do të thotë zemra ose qendra e luginës. Por, para se të shkruante Barleti veprën e tij për Skënderbeun, ne kemi një dokument shumë origjinal të 18 majit të vitit 1273, ku Karl i Anzhin, i dhuron Sevastit Pal Gropa disa fshatra në trevën e Dibrës, e konkretisht në Luginën e Bues, pra luginën e Bulqizës. Në aktin e dhurimit shkruhet: "Karli I, i dhuron Sevastit Pal Gropa, për shërbimet e tij, fshatrat Radikë e Madhe dhe Radikë e vogël (Kristo Frashëri i ka cilësuar si Gryka e Madhe dhe Gryka e Vogël), Kovashicën, Gjoricën, Zerqanin, Krajkën dhe Zesizën".

61 **Ura Vashu.**
63 From this point a track continues 3 km. along the valley to **Bazari Matit** (see Div. V, Route 21 for routes northward), while the track to Dibra, turning abruptly r. up the slope, ascends to the—
69 **Chafa Bulchizes** or Balchet, 788 metres, and thence descends to the valley of the **Vito Zeze,** crossing it by a bridge from r. to l. bank at 78 km., and continuing past—
73 **Plathi** (Peladey), and—
81 **Shupentse** (Shvinche), to—
82 **Ura Chütetit,** bridge across the Vito Zeze, and so over a spur to—
85 **Goritsa,** near which Div. V, Route 21 is joined, the Black Drin is crossed, and that route is followed to—
95 **DIBRA.**

Detajet e analizave mbi emrat do t'ua lëmë historianëve, por ne do të nisemi nga radha e përmendjes së fshatrave. Ka një logjikë, ata radhiten në dokument nga lindja në perëndim, e vijnë me radhë ... Gjoricë, Zerqan, Krajkë, Zessiza. Me këtë trend, pas Zerqanit dhe Krajkës në radhë vijnë Peladhia dhe Valikardha, por ato nuk korrespondojnë e nuk afrojnë me toponimin Zesiza. Prandaj Zesiza është padiskutim Bulqiza. Kurse Fushë-Bulqiza është Fushë-Zeza, ose Fusha e Zezës. Këtë e përforcon edhe një tjetër dokument, shumë më i vonë në kohë (servirur nga biblioteka "F.Fusha"), por që mbart domethënie e që shoqëron këtë status, ku një oficer i inteligjencës angleze përmend në gjuhën shqipe emrat e vendeve që kalon kur udhëton nga Tirana drejt Dibrës në vitin 1920 (vijohej të bëhej luftë me serbët në ato vite). Ai shkruan se pasi zbresim nga qafa e Buallit kalojmë nëpër luginën Vito Zezë, e më pas kalojmë në Urën e Qytetit në Peladhi. Pra, Bue-Zessiza = Bue Zeza = Bulqiza sot.

2. GROPA

Rrjedhur nga ajo që cilësuam në variantin 1, Gropajt, kjo familje fisnike arbërore e njëherësh krahu i djathtë i Skënderbeut, kishin në pronësi ndër të tjera edhe Bulqizën. Para se të dalim në konkluzionin përfundimtar është mirë të njihemi me një tjetër vepër madhështore (sipas mendimit tim), që është e karakterit letrar por tregon historinë e Bulqizës. Është "Kënga e Sprasme e Balës", e Gavril Dara i Ri. Që në hyrje mësojmë se këngët janë të plakut Balë dhe janë ruajtur ndër breza. Vepra flet kryesisht për betejën e Vajkalit. Ku përmenden dhe dy emra heronjsh, Nik Peta dhe Pal Golemi.

Emra dhe vende të poemës që lidhen sot me Bulqizën:

-Vajkal, toponim lapidar i historisë tonë. Në Vajkal u shkrua historia e Arbërisë dhe fama e fitoreve të Vajkalit frymëzoi të gjithë Europën.

-Nik Peta (Peti, kullat e Peteve, mbiemër fisi sot në Fushë-Bulqizë).

-E bukura e Lalës (në Bulqizë nuk ka Lalë, por kështu është kënduar në këngët e dasmave).

-Lisi i Helmit (sot qafa e Helmes ose Helmit, pasqyruar në hartën topografike italiane).

-Mali i Gropës (sot Pylli i Gropës, ruajtur si toponim edhe në hartat topografike të

vendlindja

Fushë-Bulqiza është fshati më i madh në sektorin e sipërm të luginës së Bulqizës, pozicionuar në pjesën lindore të saj. Në perëndim mbyllet tek kthesa e Bobet pranë fshatit Dragu, në lindje përfundon tek Ura e Qytetit, në veri kufizohet me kodrat e Zhiranës dhe kodrat e Gropës, kurse në jug, territori i këtij fshati ndjek kreshtën e majës së Lopës, afro 2000 m. Brenda këtyre kufinjve, Fushë-Bulqiza ka një sipërfaqe 20 km katrorë, nga të cilat 8.5 km katrorë janë fushë e luginë, nën 900 m lartësi. Pjesa tjetër është mal që i përket krejtësisht malit të Lopës e pjesërisht kurrizit të Kaculit. Vetë katundi Fushë, i përbërë nga disa lagje, shtrihet nga 620 m në lindje e deri në 670 m në veri e perëndim.

shekullit XX, nga lagjja Kice e deri tek gurët e Skënderbeut në Vajkal).

-Brinja (sot brinja e Dusheve në JL të Terzallës, pyll dushku e dëllinjash, pasqyruar në hartat topografike italiane e shqiptare, pra që para 1940).

-Çardhak (vend që mban të njëjtin emër edhe sot në shpatin perëndimor të Temlës, pra Çardaku pranë Kullës së Skënderbeut).

-Ugarët e Fushës (këtu është fjala për tokë e kthyer ose punuar në Fushë-Bulqizën e sotme).

-Rin, ose Rina (edhe sot ka mbiemër Rina në Dragu).

-Gjergj Mirëshpia (Mira edhe sot ka një fis me këtë mbiemër, kurse në fshatin Dushaj ndodhet një vend që quhet kodra e Mirakut, pra, Mira-Miraku), që ndërtoi i pari bashkë me Ballën katund arbëresh më 1482.

Të tjera: Plaku Balë, maja e Plakthit (Balë), Bala, Balja, Ballë-Balla, ka sot plot në të gjithë Bulqizën.

Siç shihet, në këngët e trashëguara arbëreshe, të mbledhura nga Dara, flitet për emra vendesh dhe njerëzish në Bulqizë, e ndoshta mbriemri Peta = Peti dhe Nika flasin shumë, sepse këta mbiemra dhe toponime janë njësoj sot në zonën e Bulqizës. Janë të paktën 5-6 mbiemra fisesh që i kemi nga mesi i shekullit XV.

Kujtojmë që është gjetur edhe dokumenti që autoritetet në Palacio Adriano në Itali, i japin lejen Zahari Gropës (në origjinal Zaharia Cropa) bashkë me shoqëruesit e tij të nguliten në këtë vend. Dihet që pas vdekjes së Skënderbeut dhe pushtimit turk, ndaj skënderbegasve nisi gjuetia e shtrigave dhe ata që s'pranonin të ktheheshin në fenë muhamedane viheshin përballë vështirësive. Kjo detyroi fisnikërinë dhe ajkën politike, ushtarake e rininë e vendit të emigronte masivisht në More (Peleponez), në ishujt jonianë, në Kroaci etj, e natyrisht me shumicë në Itali. Plaku Balë, veteran i ushtrisë skënderbejane ishte nga kontigjenti që mori me vete Zahari Gropa. Ka dhe një konfirmim tjetër, por që duhet gjurmuar: këta që shkuan atje u vendosën vendeve (maleve, kodrave e brinjave) emrat e vendeve nga ikën. Studimi i këtij aspekti do të ishte me shumë interes.

Historiani Kristo Frashëri thotë se origjina e Gropajve ishte nga rrethinat e Zerqanit, por pa e specifikuar në cilën rrethinë. Kujtojmë që Bulqiza jetë e mot ka pasur lidhje me Zerqanin, dhe është në periferi të Zerqanit. Pra, eshte nje alternative.

Për ta bërë të besueshme që fshati Fushë-Bulqizë quhej Gropa, nuk na mjafton vetëm regjistrimi austriak ku Gropa jepet bashkë me lagjet e saj, në kufinjtë e Fushë-Bulqizës së sotme.

Dihet që në këtë zonë ka një katund të banuar jetë e mot që quhet Gropë, sot lagje e fshatit Dushaj, e me gjasë është vendbanimi më i vjetër në të gjithë Bulqizën, që disponon edhe një kishë. Mendoj se Gropa quhej ndër shekuj fshati që sot quhet Dushe, por kjo ha shumë diskutim. Emri Fushë-Bulqizë si fshat takohet për herë të parë në vitin 1832. Në dokumentin osman për pleqësitë e Dibrës (1836), për Bulqizën jepen Bajram Fera (Karaj) e Fejzë Cupi nga fshati Kocaj, Veli Xhaferi nga lagjja Kome, Ismail akalli nga lagjja ire, Bajram Terziu nga fshati Dushaj, Tuç Ismaili nga Lepurakët dhe Ali Hati nga Draguni. Siç shihet, nga 7 vetë që përbënin pleqësinë e Bulqizës, nuk kishte asnjë nga Fusha. Kjo tregon se Fusha është banuar vonë. Edhe nëse ka pasur shtëpi, ato kanë qenë të pakta, pra nuk ishte formësuar mirë si fshat.

NGA JANË BANORËT E FUSHËS?

Kjo është pyetja që merr përgjigje më të lehtë e madje e ka përshkruar mjaft mirë autori Ymer Keta në librin e tij. Fiset Demiri, Hida, Snalla, Balla, Duva, Llani, Liçi, Laçi, Doga, Daka, Gjura, Pjetri (i shuar), Kuka etj, kanë zbritur nga Gropa; Hupi, Marini, Gjimi, Hoxha, Peti, Llorja, Tahiri etj, kanë zbritur nga Lepurakët; Terziu, Aliu, Xhafa etj, kanë zbritur nga Dushet; Dedja, Dani etj, kanë zbritur nga Kodër Dani. Edhe fiset që janë në Terzallë, në pjesën dërrmuese të tyre kanë zbritur nga Gropa, Koçet, Kodër Dani e Dushet, që janë katunde ngjitur me Fushën. Pra siç shihet, fiset dhe lagjet që shtoheshin në mal zbrisnin në fushë. Nga kjo analizë kuptojmë që shumica e pronave të Fushës së Madhe (gati 2/3) i përkasin fiseve të Gropës, pra Fushë-Bulqiza e sotme ishte pronë e katundit Gropë. Pra Fusha është sinonim i Gropës dhe lidhet me pronësinë e Gropajve në mesjetë. Edhe Pylli i Gropës, është pyll i katundit Gropë. Më vjen keq që po e banalizoj, por një nga pleqtë e fisit tim, Balla, i lindur në kohën e Zogut, pasi erdhi demokracia dhe shkoi prona tek i Zoti, mori mushkën e shkoi për gjeth atje ku janë sot Kicet dhe Bobet. Atje e kishin përzënë duke i thënë c'punë ke ti këtu? "Ka ra toka në t'Zot, or lum miku, kam pyllin e babës e të fisit tim këtu". Pra miq, Gropa ka qenë katund i vendosur ku janë sot lagjet Gropë, Lepurakë e Dushe e që lidhej me emrin e Pal Gropës. Ka qenë katund i madh e jo i vogël, gjë që na e dëshmojnë fiset, e vendosur poshtë kodrave të Gropës. Interesant janë edhe disa emra fisesh që nuk ekzistojnë më aty si Boka, Loka, Tatina, Marku, Nika etj, me domethënie qartësisht të krishterë. Një nga arsyet e vendosjes së vendbaninimit aty ka të bëjë me burimet e ujit, marrjen e më shumë orëve me diell, vend më i ruajtur në raste fatkeqësisht natyrore dhe vend i futur rrëzë maleve për t'u ruajtur nga plaçkitjet dhe nga rruga ku kalonin ushtritë pushtuese, sikurse ndodh me aksin Terzallë-Bobe-Vajkal-qafë Buall, e cila ka qenë rrugëkalimi e pabanuar.

ÇFARË ËSHTË VRAMI?

Vendi ku është sot lagjja Tejzallë i thoshin më parë Vram. Po nga vjen emri Vram? Nga analiza e Barletit kuptojmë se beteja e parë e Skënderbeut me Ballabanin është është bërë pikërisht në këtë vend. Për shkak se e kam të pamundur të kuptoj vendosjen në formacione luftimi për kohën, ngaqë nuk jam specialist i fushës, kam zgjedhur trekëndëshin Fushë Bulqizë-Terzallë-Valikardhë, si vendbetejë e parë me Ballabanin. Vram – rruga e Vramisë – Vorre T'vrame, me siguri që këto toponime kanë lidhje me atë ngjarje. Fillimisht beteja në Terzallë, në Vram (të vramët, të vrarët). Më pas skënderbegasit arritën deri në kampi i Ballabanit pranë Urës së Qytetit, e ranë në pritë në përroin e Kazjakut, ose pranë lagjes Shpellaxhi në Fushë-Bulqizë e deri tek Shkëmbi i Qytetit. Kurse beteja e dytë vajkale mes Skënderbeut dhe Ballabanit, nuk kam aspak dilemë që është aty ku janë sot gurët e Skënderbeut. Kuptohet, historianë e studiues të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme, por në fund të fundit ne shprehim mendimet tona. Emërtimi "Tej Zellini", ose "Tejzalla", është krijuar nga Gropasit për të identifikuar territoret që ishin në krahun tjetër (të djathtë) të Zallit të Bulqizës.

Ndarja e Fushës në dy pjesë, e Madhe dhe e Vogël, lidhet me konceptin e përmasës, ku njëra është më e madhe se tjetra e që ndahen nga zalli i Kokërdhakut, në Shelqatë. Duke u shtuar në numër, vit pas viti, Fushë-Bulqiza arrin të bëhet në vitin 1950 fshati më i madh i Bulqizës dhe në vitin 1990 kishte afërsisht 1500 banorë. Në regjistrimin që ka bërë komuna Fushë-Bulqizë, në vitin 2007, Fushë-Bulqiza del me 1494 banorë. Natyrisht, sot ka diku tek 1 mijë banorë, e ndoshta më pak, pasi emigracioni i këtyre viteve ka qenë mjaft i lartë.

Liqeni i Luleve

Fusha, sikurse të gjithë fshatrat e Bulqizës, ka qenë baza e punëtorisë se minierës së kromit Bulqizë. Nga ky fshat kanë lënë jetën në aksidentet e ndryshme minerare afro 10 vetë. Fusha ishte gjithashtu fshati që u godit më rëndë nga tërmeti i 30 nëntorit të vitit 1967 (6.7 ballë Rihter), ku u dëmtuan shumë shtëpi, e në Terzallë humbën jetë dy vetë. Në dhjetor të po atij viti, në shenjë ngushëllimi e solidariteti, këtë fshat e vizitoi Enver Hoxha.

Fushë-Bulqiza është katund me pasuri, ku mbi 300 hektarët e fushës së saj pjellore përbëjnë hambarin e kësaj krahine. Fusha përshkohet mes për mes nga rruga e Arbrit, një arterie që do të gjallërojë ekonominë në të ardhmen, do të shtojë bizneset dhe do të rrisë të ardhurat. Në lindje është Kulla e Skënderbeut, një destinacion interesant që në të ardhmen do të sjellë shumë vizitorë dhe është krenari e kësaj zone. Infrastruktura rrugore është përmirësuar, po ashtu dhe e ujësjellësit. Në krahun jugor, ku lartësohet mali i Lopës (sipas hartes italiane 2024 m), Fusha ka kullota mjaft të pasura, si dhe pyje të mrekullueshëm, por që vitet e fundit janë dëmtuar së tepërmi, madje mund të pranojmë se është bërë një masakër në mjedis.

Pranë majës së Lopës kanë qenë deri në vitin 1900 të paktën 6 liqene akullnajore. Më 5 korrik të vitit 2021, unë personalisht gjeta me ujë vetëm dy prej tyre, shumë të vegjël, njërin prej të cilëve në Fushë të Ndërmjetshme po e paraqesim me një foto këtu. Ai quhet liqeni i Luleve, (i mbushur me zambakë të bardhë të ujit). Një tjetër liqen i vogël me ujë ndodhet rrëzë kreshtës më të lartë të Lopës, i formuar nga shkrirja e borës, por që mban ujë thuajse gjatë gjithë vitit. Por të gjithë liqenet e vegjël të majës së Lopës po shkojnë drejt zhdukjes përfundimtare.

Fusha ka njerëz punëtorë, të arsimuar e të udhëtuar, nga ku kanë dalë mësues, inxhinierë, ushtarakë, mjekë të zotë, zejtarë të ndryshëm.

Ndoshta mund të përmendnim shumë emra të spikatur të këtij fshati, por do veçoja vëllezërit Jashar dhe Agim Demiri, për kontributin e tyre, Agimi me atë vepër të madhe si "Fjalor nga e folmja e Bulqizës", kurse Jashari, Profesor Doktor në Psikologji e që ka punuar edhe në detyra të rëndësishme shtetërore.

Fusha ka pasur 3 mullinj uji, njëri prej të cilëve funksionon ende.

Ndër pasuritë kulturore përfshihen disa objekte kulti (teqetë), që janë të njohura edhe jashtë zonës për vlerat e tyre. Vlen të përmendet Teqja e Dervish Caushit, fare pranë rrugës nacionale, një vend i mirë, me fuqi mistike.

Fushë-Bulqiza ka sot shkollë fillore, shkollë 9-vjeçare e duke qenë njëherësh qendër komune e bashkim fshatrash ka edhe shkollë të mesme. Shkolla mban emrin e dëshmorit "Asllan Keta".

E ardhmja e këtij fshati duket e begatë.

** Adriatik BALLA është Doktor i Shkencave Gjeografike. Marrë nga profili i tij në FB*

Rruga e Arbërit nr. 193-195

profil

Kontributet e Ibrahim Kolarit, këtij njeriu me zemër të madhe, shtohen dhe në Dibër. Sporti, kultura, arti dhe njerëzit në nevojë, janë gjithmonë pikat e dobëta, kur ai nuk mund t'i thotë jo kërkesës që vjen në emër të tij.

Ibrahim Kolari, *një jetë mes sfidash të fituara*

Nga **OSMAN XHILI**

Ibrahim Kolari u lind në Dibër të Madhe, një qytet i shquar për punë, dije, kulturë dhe veprimtari atdhetare. Është një nga gjashtë fëmijët e familjes së Kolari. Xhaxhai i tij, me të njëjtin emër, u vra në Luftën e Dytë Botërore, në përpjekjet me pushtuesit gjermanë, në fushën e Stremit në Serbi. Emri i tij iu vendos njërës prej rrugëve të qytetit të Dibrës, duke mbetur i gjallë në mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Shaban Kolari, vëllai i Ibrahimit të rënë dëshmor, e ruajti emrin e vëllait te njëri prej fëmijëve, si për të treguar se puna dhe vepra e vëllait, trim e zemërluan, vazhdon akoma.

Koha tregoi se Shabani kishte pasur të drejtë. Ibrahimi i ri u rrit në një familje të madhe, të pasur me tokë dhe e blektori, të pasur në shpirt e bujarë. Sa herë që dikush kishte nevojë për një këshillë apo mendim të qëlluar, i drejtoheshin Shaban Kolarit, babait të Ibrahimit. Sa herë që ata kishin nevojë për ndonjë hua në para apo prodhime bujqësore, i drejtoheshin pa ndrojë babait të tij, të sigurtë se ai nuk i kthente kurrë bosh. Kjo pasuri dhe kjo bujari e ndoqi Ibrahim Kolarin gjatë gjithë jetës, duke shërbyer si motiv, se në pasurinë e njeriut paskan hise dhe njerëzit në nevojë.

Ibrahim Kolari i ri kishte gjithë energji e ëndrra për jetën. Zoti i kishte falur një trup të gjatë e të bukur, si për tu bërë njësh me shpirtin e tij fisnik. Një herë tentoi të bëhej pjesë e trupës policore, më pas ndryshoi mendje, pasi kishte prirje për mekanikë dhe ndërkohë erdhi koha për të shkuar ushtar. Disa mundoheshin t'i shmangeshin, sa të ishte e mundur këtij detyrimi, kurse Ibrahimi jo. Në mendjen e tij thurrej nje një plan afatgjatë. Ai donte ta mbaronte sa më shpejt shërbimin ushtarak, të pajisej me pasaportë dhe të gjente rrugët e mundësitë për të shkuar në Amerikën, aq shumë të ëndërruar. Shpesh, kur vinin emigrantë nga kontinenti i largët, ai i shihte me admirim të veçantë. Shihte makinat e tyre, shumë luksoze për kohën, dhe dëshironte që një ditë dhe ai të bëhej njëri prej tyre.

Detyrimi ushtarak në Jugosllavinë e dikurshme ishte 15 muaj. Ibrahimi si një shofer i talentuar, i mjeteve të lehta e të rënda, punoi në një sektor të vështirë, në transportin e mjeteve luftarake. Kësisoj, ai fitoi simpatinë e eprorëve, por dhe shkurtim të shërbimit ushtarak në 10 muaj. Mori në duar pasaportën, shikonte foton e tij. Ishte rritur, ishte burrëruar, ishte bërë me krahë për të fluturuar në dhera të tjera.

NJË JETË TË RE NË AMERIKË

Një ditë u nis për në Austri. Nuk donte të qëndronte atje, por e shihte si një hap më pranë ëndrrës së madhe amerikane. Qëndroi një vit në kamp. Kurseu pak dollarë, që mund t'i duheshin ndonjë ditë. Por sërish, në krye të vitit, pjesën më të madhe ia dërgonte familjes, si për t'u treguar se tashmë ai ishte bërë i zoti i vetes. Dhe një ditë fluturoi për në Amerikë, në tokën e bekuar, në tokën e ëndërruar.

Shumë shpejt gëzimi i këtij suksesi u fashit. Kush ishte ai në këtë komunitet gjigand? Kë njihte? Kush do ta ndihmonte për të bërë hapat e parë, ashtu si fëmija i vogël që provon ecjen e fillimit? Po gjuhën që nuk e njihte dhe dukej si memec para të tjerëve? Treqind dollarët e tij, sado me kursim që i përdorte po mbaronin. Ju kujtua Arkimedi, i cili më jepni një pikëmbështetje, dhe unë do ta ngrej botën. Kaq donte dhe Ibrahim Kolari. Një shtytje të vogël, një strehë sa për të kaluar natën dhe një punë dosido. Ishte në gjendje të bënte çdo lloj pune, sado e vështirë të ishte ajo. Sapo i kishte kaluar të njëzetat.

Në foto: Duke diskutuar në një veprimtari të shoqatës atdhetare "Dibra", në New York.

Dy tre javë do të mbeten të paharruara për djaloshin e ri që endej rrugëve të Neë Yorkut, gati me shpresa të këputura. Shumë netë, shpesh edhe i pangrënë, e fjeti në makina të djegura e të braktisura. Ndonjëherë pati edhe dyshime nëse vendimi për të shkuar në Amerikë kishte qenë i duhuri. Ëndërra e madhe që e kishte thurur për vite me radhë, shpesh i dukej se po i shkërmoqej parasysh.

Por shpresa vdes e fundit. Disa miq të largët, vëllezërit Sela, po nga qyteti i tij, që kishin një kompani ndërtimi, i siguruan punë dhe bashkë me të gjeti dhe një strehë normale. Pas një viti punësohet në një tjetër kompani ndërtimi, "Benjamin Roofing", të Turhan Rusit. Kështu kaluan dy vite, punë dhe përpjekje. Ndërkohë, ai mësonte gjuhën, teknologjinë, shihte se si funksiononin gjërat.

Vetëm kaq ju desh Ibrahim Kolarit për të ngjitur shkallët e suksesit. Teksa punonte në kompanitë që përmendëm, ai projektonte të ngrinte kompaninë e tij dhe një ditë e bëri realitet. Ishte vetëm 23 vjeç, shumë i ri për të hedhur këtë hap të madh, në një vend të huaj, ku konkurrenca ishte mjaft e lartë, por dhe shanset ishin shumë të mëdha.

Krahas shumë të tjerëve, në kompaninë e re të Ibrahimit punësoheshin dhe tre-katër studentë nga Egjipti për pushimet verore. Njëri prej tyre, ishte shumë i ditur dhe afroi shumë njerëz te xhamia e vjetër në Stejt Neiland. Ibrahim Kolari, tashmë me eksperiencë në ndërtimtari, e shihte xhaminë në një gjendje gati të mjerueshme. Ishin rreth 60 besimtarë që sapo kishin falur të xhumanë.

– Burra, - u thotë Ibrahimi të pranishmëve. – Një ditë tavani i kësaj xhamie mund të na bjerë sipër e të bëhemi gazi i botës. Unë them të grumbullojmë fonde e të ndërtojmë një të re dhe shumë më të madhe se kjo.

Ndoshta të gjithë ata njerëz kishin pritur vetëm një sinjal si ky dhe nuk e bënë më të gjatë. Nxorrën secili nga një shumë dollarësh, që kur u numëruan ishin mbi njëqind mijë. U ngarkua automatikisht Ibrahimi, si i fushës, që ishte të gjente vendin ku do të ndërtohej, të negocionte për çmimin dhe të kujdesej për punimet.

Ata zgjodhën vendin më të bukur, që normalisht, kushtonte dhe më shtrenjtë. Falë negociatave të Ibrahimit, ai truall u ble për gati gjysmën e parave të ofertës fillestare. Shumë shpejt u hartua projekti dhe u bë grumbullimi i fondeve, që deri në përfundim të xhamisë shuma shkoi në shtatë milion dollarë. Çdo ditë vinin me dhjetra çeqe, ku secili kishte disa mijëra dollarë. Më e bukura ishte se shumë prej tyre vinin nga njerëz të feve dhe besimeve të tjera. Ajo ndërtesë, nuk ishte thjeshtë një vend falje dhe predikimi, por ishte një kompleks multifunksional. Aty kishte bibliotekë dhe salla leximi, kafe, parking, sallë mbledhjesh e konferencash etj.

Në nisjen e ndërtimit, krahas shumë personaliteteve, u ftua dhe mori pjesë kryetari i bashkisë të asaj kohe, Gay Mollinary. Ai e mori fjalën dhe përshëndeti të gjithë ata që kishin kontribuar në mënyra të ndryshme, që të jetësohej ky kompleks. Mes të tjerash, ai tha se ndërtime të kësaj natyre, kanë rëndësi jo vetëm për ju, besimtarët, por dhe për ne, autoritetet e qytetit. Atje ku ndërtohet një xhami, mbyllet një burg.

Më tej u kalua në zgjedhjen e njerëzve, që do të drejtonin jetën dhe veprimtaritë e këtij kompleksi gjigand. Në krye të emrave kandidatë, pjesëmarrësit vendosën dhe emrin e Ibrahim Kolarit, njeriut, që më së shumti kishte kontribuar të realizohej një projekt i tillë madhështor. Por Ibrahimi e kundërshtoi me modesti, duke paraqitur arsye të shumta. Ai kishte ngarkesa të shumëfishta dhe ishte gjithnjë në lëvizje. Punë dhe projekte, po kaq të mëdha e prisnin përpara. Atij i mjaftonte posti i nënkryetarit dhe kështu ranë dakort të gjithë.

Emri i Ibrahim Kolarit tashmë nuk ishte më i panjohur në komunitetin e madh të shqiptarëve, që jetonin e punonin në Amerikë. Ai kishte arritur deri tek kryesia e Federatës Panshqiptare "Vatra" me seli në Boston, e themeluar nga Noli dhe Konica në vitin 1912. Kryetari i saj, në atë kohë ishte i ndjeri Agim Karagjozi. Ai e fton Ibrahimin të takohen, të pijnë një kafe sëbashku dhe të diskutojnë për projektet e reja të kësaj shoqate. Shumë shpejt Ibrahimi, jo vetëm që u bë një aktivist i zellshëm, por zgjidhet dhe në kryesinë e Vatrës, mes shumë emrave të tjerë shumë të nderuar e të respektuar.

Të shumta ishin aktivitetet e kësaj shoqate në dobi të çështjes shqiptare. Dita e pavarësisë kombëtare kthehej në një festë të madhe e solemne. Vinin shqiptarë nga gjithë Amerika e largët, duke u solidarizuar, si në një parlament të Diasporës. Kontributet ishin të prekshme e të shumëllojshme. Sjellja e eshtrave të shkrimtarit, filozofit dhe atdhetarit, Faik Konica në atdhe ishte meritë dhe kontribut i shoqatës. Ishte ky një amanet i atij njeriu të nderuar të kombit, që kishte mbetur i parealizuar deri në vitin 1995, kur eshtrat e tij u prehën pranë vëllezërve Frashëri në Tiranë. Ndihma dhe kontributi i Ibrahim Kolarit në këtë veprimtari ishte shumë e madhe, ashtu si zakonisht.

Ndërsa jetonte e punonte në Amerikë, Ibrahim Kolari nuk mund të harronte vendlindjen, atje ku u lind e u burrërua, atje ku u thurrën ëndërrat dhe projektet e para. Ai vinte herë pas here në Dibër, takohej me miq e shokë, ndanin të rejat e fundit nga të dy anët. Por ai e kuptonte që kjo nuk ishte e mjaft. Dibra priste më shumë prej tij dhe shumë bijve të tjerë që emigruan në Amerikë.

Shumë të mëdha kanë qenë vlerat dhe meritat e shoqatës për luftën e Kosovës dhe dy vite më vonë për luftën e shqiptarëve në Maqedoni. Nuk kishte nevojë për thirrje e ndërgjegjësim. Ata njerëz dërguan miliona dollarë, rroba, ushqime e armatime për tu përdorur në frontin e luftës. Madje shumë shqiptarë ju bashkuan dhe fizikisht kësaj lufte të madhe dhe pati prej tyre, që ranë në fushën e betejës.

Ibrahim Kolarit duhet ti bëjmë shumë pyetje, për t'i larguar modestinë, për të zbuluar sadopak nga ai kontribut i tij personal në Kosovë dhe Maqedoni. Dhjetra familje mernin të ardhura mujore direkt prej familjes së tij. Tre vjet më vonë, një nga familjet kosovare i thotë Ibrahimit, se nuk ishte më nevoja tu sillte dollarë në muajt në vazhdim, pasi një djalë i tyre kishte filluar punë në Gjermani. Familja kosovare e falenderonte pa masë atë, njeriun që u ishte gjendur në ato kohë shumë të vështira dhe lusnin Zotin t'ia shtonte pasurinë dhe bujarinë këtij njeriu altruist.

Disa muaj pas lufte, në vitin 1999, një delegacion shqiptarësh nga Amerika vizitojnë Kosovën. Liria e këtij shteti të ri përzihej me erën e tymit dhe barutit, që nuk ishte larguar akoma. Ndërtesa e dyqane të djegura e të shkatërruara, por që shumë shpejt do të bëheshin të reja nga fillimi.

Disa vite më vonë një delegacion tjetër shqiptarësh nga Amerika erdhën sërish në Kosovë. Sigurisht, që në mes tyre nuk mund të mungonte Ibrahim Kolari, i kudogjendur sa herë që e thërriste gjaku i shqiptarit. Tashmë Kosova e kishte kaluar emergjencën dhe kishin nevojë të ndërtonin një katedrale të madhe në Prishtinë. Dom Pjetri e pret delegacionin shqiptar, që jo vetëm solidarizohej me ndërtimin e këtij objekti, por kishin lobuar, duke sjellë rreth një milionë dollarë si kontribut. Dom Pjetri kërkon të njohë me emra anëtarët fisnikë të këtij delegacioni. Dom Pjetri surprizohet pa masë. Përveç Ibrahimit, edhe gati 15 anëtarë të tjerë kishin emra muslimanësh. - Si ka mundësi? – pyet Dom Pjetri, muslimanët e Amerikës të kontribojnë kaq shumë për katedralen në Prishtinë.

-Dom Pjetri! – përgjigjet Ibrahimi, para shumë kohësh ne ndërtuam një xhami të madhe e të bukur në qytetin ku jetojmë në Amerikë. Krahas shumë muslimanëve që kontribuan, nuk mund të harrojmë dhe vëllezërit shqiptarë të feve të tjera nga Bronksi dhe shumë qytete të tjera, pa ndihmën e të cilëve ai ndërtim do të ishte shumë më i vështirë. Ndaj dhe ne gjetëm një mundësi si kjo, të shlyejmë sadopak atë detyrim moral, që kishim ndaj tyre. Dom Pjetri e përqafoi Ibrahimin dhe që asaj kohe ata mbetën miq të ngushtë. Për këto dhe shumë kontribute të tjera, Ibrahim Kolari ka marrë mirënjohje të veçantë nga Papa Gjon Pali i Dytë.

cyan magenta yelloë black

Foto në zyrat e shoqatës VATRA.

RIKTHIMI NË DIBËR

Ndërsa jetonte e punonte në Amerikë, Ibrahim Kolari nuk mund të harronte vendlindjen, atje ku u lind e u burrërua, atje ku u thurrën ëndërrat dhe projektet e para. Ai vinte herë pas here në Dibër, takohej me miq e shokë, ndanin të rejat e fundit nga të dy anët. Por ai e kuptonte që kjo nuk ishte e mjaftë. Dibra priste më shumë prej tij dhe shumë bijve të tjerë, që emigruan në Amerikë. Kërkonte ndonjë mundësi se si ta realizonte e ta vinte në jetë.

Ishte viti 2003. Një nga ndërmarrjet e ndërtimit në Dibër, me emrin "Korabi", ishte në rrugën e privatizimit. Ibrahimi njoftohet dhe merr pjesë në tenderin e organizuar. Nuk donte të fitonte nga Dibra, donte që Dibra të përfitojë prej tij. Ai u shpall fitues dhe sot, krahas shumë kompanive që operojnë në këtë qytet, një prej tyre, është edhe "Korabi", duke prodhuar betone të një cilësie mjaft të lartë. Një ekspert i kësaj fushe është shprehur se "cilësia e lartë e betonit që prodhon kompania e Ibrahim Kolari në Dibër, mund të gjendet vetëm në Austri".

Kur sapo kishte bërë investimet e para në Dibër, besimtarët e fshatit Kosovrast po ndërtonin një xhami të re. Objekti i kultit kishte mbetur pa minare dhe Ibrahimi ua bëri dhuratë minaren e re, 43 metra të lartë.

Kaluan edhe dhjetë vite të tjerë. Kontributet e Ibrahimit, këtij njeriu me zemër të madhe, shtohen dhe në Dibër. Sporti, kultura, arti dhe njerëzit në nevojë, janë gjithmonë pikat e dobëta, kur ai nuk mund t'i thotë jo kërkesës që vjen në emër të tij.

Ibrahimi nuk ishte marrë me politikë në Amerikë dhe pse i kishte të gjitha mundësitë. Nuk do ta bënte as në Dibër një hap të tillë, po të mos ishte dashuria për vendin e tij të lindjes dhe dëshira për të ndryshuar shumë gjëra, që mendonte në projektet e tija. Në vitin 2013, kur në Maqedoninë e atëhershme zhvilloheshin zgjedhjet lokale, Ibrahim Kolari kandidon si kandidat i pavarur për kryetar i Komunës së Dibrës. Shumë njerëz e donin në krye të Komunës. Shumë njerëz prisnin ndryshime prej tij. Në koncertin përfundimtar të fushatës u mblodhën mbi tre mijë dibranë në shesh. Kishin ardhur në mbështetje të tij dhe shumë miq nga Shqipëria, Kosova dhe nga Amerika. Por ndodhën shumë gjëra asaj nate... Megjithatë, Ibrahimi arriti të renditet i dyti nga kandidatët, duke qenë moralisht fitues dhe i kësaj sfide...

Ibrahim Kolari ka një familje të mrekullueshme, që jeton e punon në Amerikë. Djali i madh drejton me kompetencë e profesionalizëm kompaninë që krijoi i jati në rininë e tij. Djali më i vogël është i talentuar për informatikë, kurse vajza ka mbaruar studimet e larta për biznes në Amerikë dhe drejton biznesin e familjes së tyre në Dibër të Madhe. Ibrahim Kolari e ndan kohën e punës dhe të jetës mes Dibrës e Amerikës, duke u bërë kështu një ambasador i shquar i i Dibrës së Madhe dhe dibranëve në Amerikën e largët.

natyrë

Liqeni i dashurisë...

Në malësinë e Martaneshit ka disa grupe liqene akullnajore, por ato të Dhoksit krijojnë një ansambël unik natyror, me rëndësi në disa drejtime.

Nga **ADRIATIK BALLA**

Liqenet akullnajore janë ndër objektet më të mrekullueshme të natyrës shqiptare. Të gjendur në lartësitë e maleve shqiptare, këta trupa ujorë kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve vendas e të huaj, madje për to ka thurje në të githa gjinitë letrare dhe histori nga më të pabesueshmet.

Në territoret shqiptare, ndoshta edhe më gjerë, njihet kulti i zanave. Zanat janë një fenomen mitologjik, që simbolizojnë bukurinë dhe pastërtinë hyjnore, përmbledhur në trupin e një femre të jashtëzakonshme për nga bukuria, e cila bën jetë ujore e shpesh edhe tokësore. Pra kemi të bëjmë me një nimfë, por në vende të ndryshme e intepretuar në forma të ndryshme e që njihet në më të shumtën e rasteve si "cuca e liqenit", "e bukura e dheut" etj. Duke hyjnizuar Zanën, shqiptarët kanë lartësuar dhe shenjtruar mjedisin e tyre fiziko-gjeografik. Në Lurë, ka plot histori me zanat, por jo të pakta janë edhe ato të Dhoksit në Bulqizë. Sot po rrëfejmë një të tillë.

Në malësinë e Martaneshit ka disa grupe liqene akullnajore, por ato të Dhoksit krijojnë një ansambël unik natyror, me rëndësi në disa drejtime.

Në grupin e liqeneve të Dhoksit, spikat edhe liqeni i Thatë, ose ndryshe liqeni i Duriçeve. Ndryshe nga liqenet e tjerë që janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të përroit të Sharrës, liqeni i Thatë është pjesë e pellgut të përroit të Duriçeve, por që të dy bashkohen pranë lagjes me të njëjtin emër në fshatin Vajkal dhe derdhen në zallin e Bulqizës.

Besohet se ai ka qenë një liqen shumë më i madh në sipërfaqe e vëllim ujor nga sot, nisur dhe nga forma e pozicioni i gropës, por me kohën është reduktuar. Në periferinë jugore e perëndimore ka kullota, kurse në lindje e në veri ka pyje ahu e pishe. I parë nga lart, ai ka formën e zemrës. Tani le të kalojmë në temë. Pse e quajmë liqen i dashurisë?

Gojëdhëna thotë:

Në liqenin e Thatë, që ishte më i madhi në Dhoks, jetonte në ujërat e tij një Zanë. Në ditët me kohë të mirë Zana dilte nga liqeni dhe ulej në breg, krihej e ngrohej.

Një bari, që bënte përditë rrugën nga Fusha e Ndërmjetshme pranë majës së Lopës (afro 2000 m) e deri në kurriz të Kaçilit (Maja e Kaculit 1999 m), e kishte pikasur Zanën, por sa afrohej ajo zhdukej krejt papritur. Kaluan ditë e javë të tëra dhe bariu s'po mundte që ta takonte. Ai ishte i dashuruar me të, por s'po mundte t'ia shprehte ndjenjën e tij. Madje kishte vrapuar për ta kapur por ajo zhytej me shpejtësi në liqen.

Në foto: Një imazh satelitor i liqenit të Thatë, një foto të tij shkrepur nga krahu jugor, një foto e ujëvarës së Duriçit dhe një foto e luginës së Vajkalit e parë pikërisht nga lartësitë pranë liqenit.

Një ditë prej ditësh, ai vendosi të fshihej pranë liqenit dhe nuk u gabua. Zana doli nga uji dhe u ul në breg. Ishte pambarimisht e bukur dhe me flokë të gjatë që krijonin një gërshet marramendës ngjyrë ari. Më në fund, bariu gjeti momentin e përshtatshëm që ta rrëmbente Zanën dhe doli nga vendi ku ishte fshehur dhe tentoi ta kapte atë. Por Zana rrëshqiti me shpejtësi në ujë drejt pjesës më të thellë, në fund të liqenit, duke lëshuar disa tinguj të çuditshëm. Bariu po përpiqej të kuptonte ku do të dilte dhe vrapoi poshtë drejt zbrazjes së ujërave të liqenit, duke ndjekur tingujt. Pasi kishte ecur disa minuta bariu gjeti gërshetin e Zanës, që krijon shkallare, ndërsa zëri i Zanës tani nuk dëgjohej më në ujë por në lartësi. Vendi ku u gjet gërsheti është sot Ujëvara e Duriçit, kurse vendi ku zëri rri në ajër quhet qoshi i Zavarit (Za varur, ose Zë i varur, pra zëri rri varur. Kuptohet, kemi të bëjmë me jehonën që shkakton në shpatet shumë të pjerrtë të malit të Duriçit ujëvara me të njëjtin emër, një monument natyre, e cila, e parë nga larg të jep një ndjesi të cuditshme).

Bariu, i pikëlluar që s'ia doli dot, nisi të mallkojë liqenin që ia fshihte Zanën. "U thafsh o l'qe, siç më thave mua pa Zanën". Dhe liqenin e zuri mallkimi i bariut. Tani ai mban ujë dimrit por është i cekët dhe në fund të gushtit thuajse thahet tërësisht. E megjithatë, ai është një prej më të bukurve në malin e Dhoksit. Është i bukur, sepse aty ka jetuar Zana...

Përtej mitologjisë, Gatelli i Bulqizës, ku ndodhen edhe liqenet e Dhoksit, është një mrekulli e natyrës shqiptare. Në këtë vend, ka pyje ahu e halorësh të dendur, liqene ekzotike, kreshta të zhveshura magmatike poshtë të cilave ndodhet baseni më i madh krommbajtës i Shqipërisë. Gatelli është një ambient ku ka mjaft kafshë të rralla si dhia e egër dhe sorkadhja, e ku vetë fjala Dhoks do të thotë lavdi (madheshti, triumf), besuar se ka mbetur si toponim nga kohët e arta skënderbejane. Në këtë vend ndodhet edhe liqeni "Skanderbeg", ujëvara, shpatet e rrëpirtë magmatike, përrenj me ujë të përhershëm dhe në lartësitë e mëdha bora që qëndron deri në mesin e verës.

Rruga e Arbërit nr. 193-195

profil

Hajri Shehu, *filolog, përkthyes dhe leksikograf e leksikolog i vyer*

Nga **Akad. GJOVALIN SHKURTAJ**



Më 12 korrik 2022, Akademia e Studimeve Albanologjike, në bashkëpunim me Universitetin e Korçës "Fan S. Noli", organizuan konferencën shkencore "Studime semantike në fushën e leksikut dhe të fjalëformimit në gjuhën shqipe", duke vënë në pah kontributet e personaliteteve shkencore prof. Androkli Kostallari, prof. Enver Hysa dhe prof. Hajri Shehu.
Në këtë konferencë shkencore, mbi punën shkencore të profesor Enver Hysa mbajtën kumtesa personalitete shkencore të fushës si Seit Mansaku, Dhimiter Bello, Ali Jashari, Tomorr Plangarica, Hysnie Haxhillari, Albina Pajo, Rezarta Yzo etj; ndërsa për punën shkencore të profesor Hajri Shehut folën profesorët Gjovalin Shkurtaj, Eshref Ymeraj, Abdulla Ballhysa, Kujtim Kapllani, etj.
Gazeta do të përpiqet që disa nga këto kumtesa të bëhen të njohura për lexuesit, dhe këtë numër kemi zgjedhur të botojmë fjalën e akademik Gjovalin Shkurtaj për kontributin e Hajri Shehut si filolog, përkthyes, leksikograf e leksikolog.

Do ta nis përshëndetjen time për t'i uruar 80-vjetorin e ditëlindjes prof.dr. Hajri Shehut, duke sjellë në mendje "monë e shkuom", vitet kur kemi qenë të rinj në moshë e të rinj si punonjës shkencorë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë dhe, përditë, shihnim profesorët e moshuar që ecnin para nesh kur shkonim në bufenë më të afërt për të pirë kafen, zakonisht përballë Kishës në Rrugën e Kavajës, te pallatet afër Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", që ishte ca më larg, por që e pëlqenim më shumë sepse aty edhe takoheshim me "grigjën" e përkthyesve dhe të redaktorëve e, derisa na vinte radha për kafen tonë, flisnim me disa prej atyre që i njihnim. Ishin vitet kur përkthetheshin shumë libra nga gjuhë të huaja dhe aty shihnim Jusuf Vrionin, Zef Simonin, Petro Zhejin, Edmond Tupjen dhe të tjerë më të rinj e, natyrisht, shuanim edhe kureshtjen se çfarë librash të rinj po përkthetheshin e do të botoheshin së afërmi. Hajriu që dinte mirë anglishten dhe disa gjuhë të tjera të huaja, kishte edhe njohje me disa prej përkthyesve dhe natyrisht shkëmbente "kumtet" me ta, sepse ishte edhe vetë përkthyes. Natyrisht, edhe ua kishim lakmi sepse përkthyesit e Shtëpisë Botuese i kullotnin sytë në libra të rinj e mbanin gjallë edhe gjuhët e huaja që i kishin nxënë me mundim në fakultet ose, disa syresh edhe me qëndrime të gjata jashtë. Në atë log pune mund të kishte qenë edhe Hajriu, sepse kishte studiuar për filologji e gjuhë angleze, dhe, para se të vinte në sektorin e leksikologjisë të Institutit tonë, kishte përkthyer disa libra e kishte hartuar edhe disa tekste mësimore për të nxënë anglishten. Ne të Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, natyrisht, duke pasur si profil kryesisht disiplinat gjuhësore, leksikun dialektor e letrar, strukturën gramatikore e fjalëformuese të shqipes, termat apo kulturën e gjuhës etj., merreshim kryesisht me disa procese pune që, aq sa janë të domosdoshme për njohjen e studimet sipas sektorëve përkatës, po aq janë edhe të mundimshme e, madje, të mërzitshme, si vjelja e fjalëve, skedimi, klasifikimi e shkencorizimi, që përbëjnë bazën kryesore të pasurimit të kartotekave sipas sektorëve përkatës. Ajo është një punë e mbyllur, një punë e imët, që kërkon ta rrudhësh ballin për orë të tëra mbi librat letrarë apo diturorë e shkencorë, si dhe në gazetat e revistat e ndryshme, të hershme e të sotme, për të nënvizuar fjalët e kuptimet e reja (në mos tjetër, të përdorura me ndonjë vlerë të shtuar kuptimore), të cilat, pastaj, sipas një planifikimi të caktuar, duheshin hedhur në skeda - secila fjalë e përfshirë në një periudhë a frazë, që futej në kllapa katrore. Pastaj vetë vjelësi ose ndonjë prej forcave ndihmëse (që më vonë do të quheshin "filologe") i shkruanin në skeda të veçanta, duke i prerë më gërshërë e duke i ngjitur me zamkë, ose duke i kopjuar me dorë, kur libri ose gazeta e revista nuk mund të pritej. E përmenda këtë rrethanë, që lidhet me punën e prof. Hajriut dhe të gjithë neve ish-punonjësve të IGJL-së, për të kuptuar më mirë edhe disa prej cilësimeve që i janë dhënë atij (si dhe shumë të tjerëve), si *njerëz të punës në heshtje,* apo *pa zhurmë* e *pa bujë*. Mbase duhet theksuar që prof. dr. Hajri Shehu ka vjelë fjalë të gjuhës shqipe **nga rreth 100 mijë faqe librash** për pasurimin e fondit leksikor të gjuhës shqipe pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Ai ka drejtuar edhe dhjetëra ekspedita gjuhësore në shumë qendra banimi të vendit tonë për vjeljen e fjalëve të panjohura nga thesari i gjuhës së popullit. Prandaj, po e them me bindje të plotë, të punoje në një nga sektorët shkencorë të IGJL-së në kohën tonë, kishte një paradoks: Quhej punë zyre, sepse vërtet bënim punë ndenjëtare, kishim nga një tryezë pune e nga një karrige të thjeshtë dhe zbatonim orarin zyrtar; porse aty, mjediset e pajisjet ishin mjerisht aq të pamira, pa sistem ngrohjeje qendrore në dimër e natyrisht, pa sistem freskimi me ajër të kushtëzuar për mot të nxehtë, pa makina shkrimi vetjake (për kompjuterët nuk e dinim se ekzistonin). Kishte vetëm një zyrë kopisterie me tri daktilografiste dhe sigurisht, për çdo artikull a studim, që të daktilografohej, duhej pritur radha, sepse ato kishin edhe një normë të caktuar, një sasi faqesh që mund ta bënin brenda një dite. Ehu, po t'i kishim pasur kushtet e sotme, kur secili ka kompjuterin e vet dhe, pa u munduar fare, mund ta dërgosh artikullin ose studimin për botim, jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, me siguri, nuk do të kishim qenë as aq "të heshtur", as aq "të ngadalshëm" në botimet tona. Kur, sa për të qeshur, aq për të qarë, në vitin 1983, në një nga vajtjet me shërbim në Itali, pata arritur të blija një makinë shkrimi "Oliveti" të përdorur, më është dukur vetja "shumë i pasur", sepse, më në fund, do të lirohesha nga "zinxhirët" e pritjes në radhën e daktilografimit të shkrimeve të ndryshme.

Hajriu ka ardhur në Institut disa vjet më vonë se unë, në vitin 1971, në sektorin e leksikologjisë dhe të leksikografisë. Ai ishte sektori me më shumë punonjës shkencorë dhe forca ndihmëse, sepse edhe lënda që duhej vjelë, skeduar, klasifikuar e shkencorizuar para hartimit të fjalësit përkatës të Fjalorit ishte e gjerë dhe gjithmonë në shtim. Në këtë Institut ai punoi vite të tëra (1971-1993, 1997-2010), derisa doli në pension. Hajriu ishte në zyrën e madhe (apo si të themi, në zyrën "amë" të leksikologjisë), ku, së paku, deri në vitin 1990, kur unë jam larguar nga Instituti, aty kanë pasur tryezat Anton Krajni, Pashko Geci, Palok Daka, Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Pavli Haxhillazi, Miço Samara, Josif Kole, Kornelia Sima, Beatriçe Keta, Thanas Feka, Agim Hidi, Sofokli Gjermeni, Ina Arapi, Ardian Vehbiu, Dhori Qiriazi. Sot, disa nga ata nuk janë më midis së gjallësh; disa të tjerë janë larguar nga Instituti, kryesisht për shkak të daljes në pension ose kanë shkuar jashtë shtetit. Por janë shtuar leksikologë të tjerë, si Valter Memisha, drejtues për vite me radhë i Institutit të Gjuhësisë dhe bashkëdrejtues i FJMGJSH-së, Artur Lama, Tomorr Plangarica, Enkeleda Kapia, Rafaela Marteta, Juliana Kume etj.

Për studiuesit e sotëm të IGJL-së do të duket e çuditshme kjo që do të them. Përveç orës së kafes dhe rasteve të mbledhjeve të mëdha në bazë instituti, që zakonisht i bënim ose në sallën e bibliotekës në katin e parë, ose (më shpesh) në zyrën e madhe të sektorit të gramatikës e të dialektologjisë, që quhej "zyra e Spiros", pastaj e Menellës, rasti i përditshëm i takimit ka qenë gjimnastika e mëngjesit, që e bënim në oborrin e institutit para se të fillonte puna (pra, duhej të vinim disa minuta para fillimit të orarit zyrtar), si dhe gjatë dimrit, në depon e druve, ku mbushnim arkat me dru për të ndezur sobat. Pas gjimnastikës së mëngjesit, secili ulej në tryezën e vet dhe zbatohej parimi i njohur "secili për vete", për të realizuar planin, natyrisht, duke hartuar edhe relacionin përkatës për çdo tremujor, gjashtëmujor, nëntëmujor dhe për krejt vitin. Natyrisht, shqetësimi kryesor ishte realizimi i planit të punës dhe, ndonëse kemi qenë në sektorë të ndryshëm, por të ngjashëm, ua kam qarë hallin gjithmonë kolegëve të leksikologjisë, sepse atyre nuk u mbetej kohë për t'u marrë me tema studimore ngaqë kohën kryesore ua merrte Fjalori. Jam marrë edhe unë me fjalorin dialektor, prandaj kam thënë e shkruar shpesh se hartimi i fjalorëve dhe i gramatikave gjithmonë është konsideruar nga punët më të rënda mendore. Me një metaforë bukolike, mund të thuhet se është si puna me parmendë e me kosë në bujqësi. Në këtë fushë, sa të vështirë e të rëndësishme për leksikologjinë shqipe, prof.dr. Hajri Shehu ka punuar si duhet, pa u ankuar asnjëherë, gjithmonë me qetësi e përvujtëni asketike dhe, si fryt i asaj pune, po deshët edhe ta quajmë sizifiane, ka përgatitur si autor dhe si bashkautor, veprat e mëposhtme:

- "Fjalor shumëvëllimësh i gjuhës shqipe", vëllimet II, III (vepër në dorëshkrim) (bashkautor);
- "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1980 (nderuar me çmimin e Republikës) (bashkautor / shkronjat D (pjesërisht), E, Ë, F, P / pjepër / prridhje, V / 270 f.);
- "Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë, 1984 (bashkautor / 165 f.);
- "Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë, 1984 (sistemim e përpunim i frazeologjisë së gjithë Fjalorit / mbi 4000 njësi);
- "Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë, 2002 (bashkautor / 216 f.);
- "Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe", Tiranë, 2004 (bashkautor / 314 f.);
- "Fjalor i gjuhës shqipe", Tiranë,

studime

Prof. dr. Hajri Shehu ka veprimtari të pasur shkencore, si filolog, si përkthyes e si hartues tekstesh mësimore për gjuhën angleze. Ai është bashkautor dhe autor i 22 fjalorëve të gjuhës shqipe dhe të fjalorëve anglisht-shqip, shumica të botuar dhe ca në dorëshkrim, por që po përgatiten për në shtyp. Është autor i disa monografive dhe i më shumë se 80 artikujve shkencorë, kushtuar problemeve të gjuhës së sotme letrare shqipe, të leksikologjisë, të leksikografisë dhe të fjalëformimit

2006 (bashkautor / 179 f.);

• "Fjalor i gjuhës shqipe" (për shkollën), Tiranë, 2020 (bashkautor);

• "Fjalor i gjuhës shqipe" (për shkollarë të vegjël) (vepër për shtyp) (bashkautor);

• "Fjalor i termave të artilerisë (shqip-anglisht-rusisht)", Tiranë, 1987 (bashkautor dhe bashkëredaktor);

• "Fjalor i termave të prapavijës (shqip-anglisht-rusisht)", Tiranë, 1987 (bashkautor dhe bashkëredaktor);

• "Fjalor themelor i termave të bujqësisë", Tiranë, 2006 (bashkëredaktor);

• "Fjalor frazeologjik sinonimik anglisht-shqip" (vepër në dorëshkrim) (autor);

• "Fjalor anglisht-shqip" me rreth 400 emërtime bimësh (vepër në dorëshkrim) (autor);

• "Fjalor arabisht-shqip", Tiranë, 2009 (bashkëredaktor);

• "Fjalor anglisht-shqip", Tiranë, 2010 (autor / 834 f.);

• "Fjalor persisht-shqip", Tiranë, 2010 (bashkëredaktor);

• "Studime për leksikun dhe për leksikografinë e sotme shqipe", Tiranë, 2015, që përfshin mbi pesëdhjetë artikuj, pothuajse të gjithë të botuar në revistat shkencore "Studime filologjike", "Gjuha jonë", "Gjuha shqipe" etj.;

• "Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës", Tiranë, 2016, 436 faqe;

• "Fjalor tematik bashkëbisedimor anglisht-shqip (vepër në dorëshkrim);

• "Fjalor anglisht-shqip i thënieve dhe i njësive frazeologjike" (bashkautor me të birin, Bledarin; vepër për shtyp);

• "Fjalor xhepi anglisht-shqip dhe shqip-anglisht" (bashkautor me të birin, Bledarin; vepër për shtyp).

Qyshkur e kam njohur për herë të parë, pastaj edhe në të gjitha rastet, kur e kam dëgjuar si fliste e si shkruante prof. Hajriu, kam formuar bindjen se natyra e tij e heshtur vinte nga modestia shembullore, nga ngrohtësia e shpirtit, ndërsa, sikundër e kanë vlerësuar edhe kolegë të tjerë, që e kanë njohur edhe më nga afër se unë, dijet e tij në lëmin e gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze janë me të vërtetë për t'u adhuruar e vlerësuar. Hera e mbarë e ka sjellë që me Hajriun të kemi qenë së bashku edhe në ndonjë ekspeditë gjuhësore në Kosovë, në vitin 1978 (në mos u gabofsha) dhe kemi disa fotografi të përbashkëta me studiuesit kosovarë, asohere ende të rinj e të reja, si Shefkije Islamaj, Ibrahim Goci, Skënder Gashi, Ragip Mulaku etj.

Prof.dr. Hajri Shehu është marrë intensivisht edhe me përkthime nga anglishtja në shqip dhe me redaktime përkthimesh nga arabishtja në shqip në Organizatën Ndërkombëtare Islamike të Ndihmave (International Islamic Relief Organization), me qendër në Arabinë Saudite, zyra e Shqipërisë. Këtë lloj aktiviteti e ka ushtruar në vitet 1993-1995. Si një specialist i shkëlqyer i gjuhës angleze, prof.dr. Hajri Shehu pati tërhequr edhe vëmendjen e katedrës së gjuhës angleze të Universitetit të Tiranës, e cila e ftoi në detyrën e pedagogut të anglishtes në vitet 1995-1997.

Gjatë viteve të punës në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, prof. dr. Hajri Shehu vendosi lidhje me Shtëpinë Botuese të Oksfordit (Oxford University Press). Ai është anëtar i Euraleksit (Shoqata Europiane e Leksikografëve), si edhe i "Alex Nash Fellowship of Albanian Studies" pranë Universitetit të Londrës.

Prof. dr. Hajri Shehu ka veprimtari të pasur shkencore, si filolog, si përkthyes e si hartues tekstesh mësimore për gjuhën angleze. Ai është bashkautor dhe autor i 22 fjalorëve të gjuhës shqipe dhe të fjalorëve anglisht-shqip, shumica të botuar dhe ca në dorëshkrim, por që po përgatiten për në shtyp. Është autor i disa monografive dhe i më shumë se 80 artikujve shkencorë, kushtuar problemeve të gjuhës së sotme letrare shqipe, të leksikologjisë, të leksikografisë dhe të fjalëformimit, të botuar në revista të tilla shkencore, si "Studime filologjike", "Studia Albanica", "Gjuha jonë", "Gjuha shqipe", "Lexicography" (Oxford).

Prof.dr. Hajri Shehu është autor i disa zërave për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, si edhe i më shumë se 30 recensave dhe oponencave shkencore në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në Katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës dhe në Sektorin shkencor të Akademisë Ushtarake. Ai është autor i disa kumtesave shkencore, të cilat i ka mbajtur në konferenca e kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare që janë zhvilluar në Tiranë, në Prishtinë, në Ohër, në Oksford, në Teheran etj.

Gjatë viteve të punës si leksikolog dhe leksikograf në IGJL, krahas ngarkesave të tjera, prof. Hajriu ,ashtu si kolegët e tjerë, ka drejtuar dhjetëra ekspedita gjuhësore në shumë fshatra të vendit tonë për vjeljen e fjalëve të panjohura nga thesari i gjuhës së popullit.Ai ka përkthyer dhe redaktuar 10 mijë faqe libri nga letërsia islame. Ka botuar "Treguesin e Kur'anit", artikuj studimorë dhe parathënie për librat që i kushtohen Kur'anit. Ai, po ashtu, është autor i shumë artikujve shkencorë - popullarizues në disa organe të shtypit.

***

Të bëhesh 80 vjeç, siç thoshte Dritëroi i Madh, është njëfarë trimërie, sepse jo gjithkush e mbërrin këtë "kuotë" të jetës. Natyrisht, në mendësinë e intelektualëve shqiptarë, besoj edhe më gjerë, kur ngjitesh në këtë lartësi, si vetë jubilari për veten e vet (ashtu edhe të tjerët për të) shtrojnë pyetjen: **Çfarë bëra (unë)?** Dhe, unë, si koleg e mik i Hajri Shehut mund (po sot, besoj edhe më takon) të them se ai ka pasur një jetë të mbushur me punë e me kontribute si mësues e hartues tekstesh shkollore, si leksikolog e leksikograf, me përkthime librash e studimesh të dobishme, me studime e shqyrtime të rëndësishme për anglicizmat në shqipe etj. Ai asnjëherë nuk e ka harruar kujdesin për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe.

Në kufijtë nevojisht të rrudhur të kumtesës sime, për të mos pasur edhe përsëritje të vlerësimeve të kolegëve për veprat e tjera të tij, po ndalem kryesisht në një prej botimeve më të rëndësishme të prof. Hajri Shehut - "Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës", Tiranë, 2016,436 faqe. Në fakt, kur ma pati dhuruar Fjalorin, i pata premtuar autorit se do të shkruaja një recension vlerësues për të, sepse gjeta aty shumëçka të vyer për t'u njohur e për t'u vlerësuar e këshilluar për ta shtënë në përdorim: fjalë krahinore shqipe e të bukura, frazeologjizma të pikuara me urtësinë e krahinës së Ujemujës, që shkojnë në hullinë e mirënjohur të urtësisë dibrane, si dhe trajta dialektore interesante që, mua, si dialektolog, natyrisht më vinin në të mirë të njohjes sa më të thelluar të të folmeve anësore të shqipes, si ajo e Ujemujës së Dibrës.

"Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës", Tiranë, 2016, 436 faqe, siç e ka theksuar edhe akademik Jani Thomai, është shkruar nga "një leksikolog e leksikograf i njohur, me përvojë të pasur si bashkautor në hartimin e fjalorëve kombëtarë (vepra madhore të leksikologjisë shqipe, si "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe" 1980,"Fjalor i shqipes së sotme "1984 e 2002, "Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe" 2004, "Fjalor i gjuhës shqipe" 2006, "Fjalor elektronik i gjuhës shqipe" 2014 etj.), ose autor, bashkautor a bashkëredaktor në hartimin e disa fjalorëve gjuhë e huaj-shqip e shqip-gjuhë e huaj (Fjalor anglisht-shqip 2010, "Fjalor i termave të prapavijës/ shqip-anglisht-rusisht" 1987, "Fjalor themelor i termave të bujqësisë/shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht 2006 etj.), me formim të plotë edhe në teorinë leksikografike dhe me seriozitetin shkencor të nevojshëm për një gjuhëtar të mirëfilltë". (Shih: *Parathënie*, shkruar nga akad. prof.dr. Jani Thomai, f.11).

Qyshkur e kam shfletuar e lexuar për herë të parë këtë Fjalor, pastaj edhe duke e lexuar me kujdes e duke nënvizuar shumëçka që më interesonte edhe për punën time si dialektolog e sociolinguist, kam formuar bindjen se vlerësimi i parë i rëndësishëm për këtë vepër është lënda e tij e pasur, po edhe që vjen nga një krahinë e vogël, që ndodhet në anët e Dibrës dhe që ka emrin tërheqës Ujemujë ngaqë rrethohet nga ujëra në tri anë: Veleshica (në veri),Drini (në perëndim), Përroi i Gramës (në jug). Jo vetëm me etimologji popullore,po edhe si emërtim real, toponimi del si emër i përbërë nga përngjitja e një togfjaleshi: *ujë-e-më-ujë*. *Ujemuja* ka simotra në krahina të tjera, p.sh. **Përtejuja** e anëve të Matit, **Shpella e Delujit** në Malësinë e Mbishkodrës, **Ujëmira** e **Ujëbardha** etj., që i ndeshim anekënd trojeve shqiptare.

Dhe, për të shkuar sa më për shkurt te thelbi i asaj që më pëlqen ta vlerësoj për këtë Fjalor, shtrojmë pyetjen: Çfarë gjeta unë në "Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës"? Përgjigjja ime është: Kjo vepër e prof. dr. Hajri Shehut, përtej (e krahas) vlerësimeve të përgjithshme, që i kam bërë edhe më lart, mund dhe duhet të shihet si prurje me vlera të shumta, jo vetëm mirëfilli leksikore e frazeologjike, por edhe si lëndë e begatë, e parashtruar dhe e shembullsuar me kujdes, që mund të shërbejë edhe për shqyrtime etnogjuhësore.

Kam nënvizuar e nxjerrë në skeda shumë të dhëna nga Fjalori,të cilat, sigurisht, do të më vlejnë për plotësimet e përpajnimet e hulumtimeve të mia në fushën e onomastikës, të etnolinguistikës e të sociolinguistikës, si dhe, ndoshta mbi të gjitha, shumëçka që vjen në një fjalor leksikor, por që ka edhe vlerë dialektologjike.

Paçim jetë e shëndet për të mos i lënë me kaq vlerësimet e shqyrtimet përmbi këtë *Fjalor* - pak të thuash të pasur, të vyer e të rëndësishëm të prof.dr. Hajri Shehut.

I urojmë kolegut e mikut tonë jetë të gjatë, shëndet e ndezëlli për punë të tjera të vetat dhe, mbi të gjitha, punë të përbashkëta e botime me të birin, Bledarin, ish-studentin tim të mirë, duke shkuar sipas urimit të anëve tona për atë që këndon bukur: **Ia laç djalit**!

Tiranë, 7 qershor, 2022

Gjegjëza

Nga **HAJRI SHEHU**

I **am(b)ël**, i am(b)ël sa s'peshohet. *(gjumi)*

Në fund **arap**, n'medis dukat, në krie kapak. *(buka nën saç e në çerep)*

Arë e bardhë, farë e bardhë, parmenda e hekurt. *(këmisha kur qepet)*

I **ati** leckanjar, i biri shitet në pazar. *(rrushi)*

Barki me ujë e goja me flakë. *(llamba)*

Rreh i **biri** t'atin. *(mëtini, tundësi)*

Në nji vend asht e gjithë **botën e** kërkon. *(mendja)*

Rreth e rreth **bre** (bre = bredh), në mes liqé. *(syri)*

Në fund, **bunar**; n'medis çikrik; në krie oxhak. *(llamba)*

Bum këtu e bum në Shkodër, me **dajre** (e) me lodër. *(rrufeja)*

Asht nji **dash** me shtatë lëkura. *(qepa)*

Janë katër **dervishë** lidhun me nji brez. *(arra)*

Gjithë **ditën** ha mish, gjithë natën numëron illzit. *(thupra e qeve, hosteni)*

E **drujtë,** e kashtë, e leshtë, e mishtë. *(djepi me fëmijë)**

Asht nji **farishte,** fund e krie pare kishte. *(peshku)*

Asht nji **fturk** me pesë skepa. *(dora)*

Kryet në **grazhd** e bishtin jashtë. *(qepa)*

Bie n'**gur** e s'vritet, bie n'ujë e qullet. *(letra)*

Asht nji **gja** si (= që) shitet menjherë. *(mendja)*

Asht nji **gja**, ma e shpejta n'botë. *(mendja)*

Rrumbullak-rrumbullak, po ta prekish t'ban me **gjak.** *(dredhëza)*

Asht nji **gja** si, te bie, e ban rrafsh. *(kosa)*

Ha e ha e të frime (= të fryrë) s'ka. *(mulliri)*

Hidhet e përhidhet, për nji druni mblidhet. *(furka me boshtin)*

Iriç dallamëkuq e këmishëbardhë. *(boça e gështenjës)*

Asht një **kalë** i bardhë, shkon përmes filxhanave e nuk i then. *(hëna me yjet)*

Hingëllon nji **kalë** mbi nji kodër. *(brisku mbi fytyrë)*

Rraketak bajte, vet'e gjall s'ishte, katër **kambët** i kishte. *(vegja)*

Mbrenda - **koc** e jashta - tul. *(kumbulla)*

Rrumbullak-rrumbullak, treqind **koka** ka në bark. *(kungulli)*

Asht nji **kupë** plot kocij. *(goja)*

Jashtë **kuq** e mbrenda bardhë. *(kalliri i misrit)*

Përmbrenda **kuq** e përjashta zi. *(soba)*

Dy **leshna**, tetë kambë e dy bishta. *(dy qetë e mbrehur)*

(Marrë nga libri "Këngë dhe fjalë të urta popullore)

Rruga e Arbërit nr. 193-195

debat

Identiteti ilir-arbëror i kalabardhasve nuk është plaçkë tregu

Nga **KADRI DAUTI**

Në kuadrin e reformës së re administrative territoriale që po ndërmerret, muajt e fundit, disa shoqata kanë shprehur kërkesat për të shpallur bashki krahinën e Kalabardhë (ish-Golloborda). Pretendimet ndahen në tre grupe lidhur me etninë. Shoqata Atdhetare «Hazis Lila» kërkon shpalljen e bashkisë mbi identitetin faktik kombëtar shqiptar të popullsisë së kësaj krahine. Shoqata «Golloborda» me pretendime okulte, antikombëtare para deputetëve të komisionit të reformës hodhi një gurë për krijimin e një bashkie minoritare bullgare. Pa u prononcuar drejtpërdrejtë, edhe përfaqësuesi i Shoqatës për Zhvillimin e Steblevës ishte në të njëjtën linjë. Edhe kryetari i minoritetit maqedonas në Shqipëri, Vasil Sterjovski, ka adresuar kërkesën për krijimin e dy bashkive minoritare maqedonase në zonën e Gorës në qarkun e Kukësit dhe në zonën e Gollobordës në qarkun e Dibrës, ndërkohë që deklaron se: "Minoritet bullgar nuk ka në Shqipëri."

Kërkesa për krijimin e bashkisë në Kalabardhë është nevojë jetike për rivitalizimin e kësaj krahine atdhetare dhe të lavdishme. Por vetëm kërkesa për bashki shqiptare është legjitime, e drejtë. Kërkesat për krijimin e bashkisë minoritare janë fallco, janë haptazi antikombëtare, antikushtetuese, diskreminuese për popullsisë kalabardhasve dhe për këtë krahinë kreshnike shqiptare. Sepse kërkesat e linjës maqedonase dhe asaj bullgare janë pa asnjë bazë etnike, se nuk ka asnjë kokë njeriu maqedonas apo bullgar në Kalabardhë. Se ata janë vetëm spekulime të pastra gjeopolitike, nacionaliste. Sepse kalabardhasit janë 100% shqiptarë autoktonë. Kjo është e vërteta historike e padiskutueshme dhe nuk ka tjetër.

Përfaqësuesit e linjës për bashki minoritare bullgare bëjnë haptazi pazare me identitetin e kalabardhasve dhe të shqiptarëve, vetëm për të zhvatur ca para nga Bullgaria. Ata bëhen sejmen të politikës zyrtare dhe qarqeve nacionaliste bullgare, kur as vetë nuk deklarohen se janë bullgarë, sepse dihet mirë nga gjithë kalabardhasit se identiteti i tyre i vërtetë shqiptar. Në Kalabardhë nuk ka qenë zakon tradhtia, por ja që edhe në këtë trevë atdhetare shqiptare, kanë mbirë edhe tradhtarë të identitetit dhe të gjakut të tyre. Dhe kjo vetëm nga disa rasputinë, disa injorantë, që shesin edhe babain, gjyshin, stërgjyshin për para. Unë nuk mund ta kuptojë kurrë, si mundet që krahina jonë kaq atdhetare, kaq fisnike, me kaq shpirt e me vlera të larta kombëtare shqiptare të ketë tradhtarë të tillë që guxojnë të shesin identitetin e tyre dhe të kalabardhasve te maqedonët dhe bullgarët?! Ky është një turp për ta!

Deklaratat, sikurse ata para komisionit parlamentar të reformës administrative territoriale, se kalabardhasit janë bullgarë, përbën një gënjeshtër të së vërtetës së identitetit shqiptar të kalabardhasve, përbën një deklarim të rem para një komisioni ligjvënës me qëllim manipulimi. Dhe kjo është e dënueshme jo vetëm moralisht, por edhe penalisht. Kjo përbën një tradhti kombëtare, më e keqe se shitja e Shën Naumit, se shitja e Detit. Një shitje që është në vazhdën e strategjisë së vjetër gllabëruese të trojeve shqiptare nga Bullgaria, si mundësi e fundit për t'i zhvatur ca popullsi Shqipërisë para se ajo të futet në BE, që ta shfrytëzojë këtë si kalë troje për të ndërhyrë në politikën e brendshme të saj.

Por siç duket tre janë faktorët që e nxisin këtë tradhti: së pari, paguhen mirë për këtë; së dyti, kanë marrë zemër nga ligji antikombëtar i minoriteteve i vitit 2017, miratuar nga parlamenti shqiptar!; së treti, anarkia morale, sociale, ekonomike e patriotike që ka kapluar vendin e shoqërinë tonë, sikur thoshte Fan Nolit se «këtu, ..., është më mirë të jetë njeriu tradhëtor e të shikojë interesin e tij e të jetë i sigurt që të nesërmen do të proklamohet patriot i madh».

Rasputinët maqedonas, me në krye ministrin e Jashtëm Bujar Osmani, thonë se nuk ka bullgarë në Kalabardhë - dhe këtu kanë të drejtë - por ka minoritet maqedonas dhe

Kërkesa për krijimin e bashkisë në Kalabardhë është nevojë jetike për rivitalizimin e kësaj krahine atdhetare dhe të lavdishme. Por vetëm kërkesa për bashki shqiptare është legjitime, e drejtë. Kërkesat për krijimin e bashkisë minoritare janë fallco, janë haptazi antikombëtare, antikushtetuese, diskreminuese për popullsisë kalabardhasve dhe për këtë krahinë kreshnike shqiptare. Sepse kërkesat e linjës maqedonase dhe asaj bullgare janë pa asnjë bazë etnike, se nuk ka asnjë kokë njeriu maqedonas apo bullgar në Kalabardhë. Se ata janë vetëm spekulime të pastra gjeopolitike, nacionaliste. Sepse kalabardhasit janë 100% shqiptarë autoktonë

kërkojnë që kjo bashki të krijohet mbi këtë bazë. Rasputinët bullgarë thonë se nuk ka minoritet maqedonas në Kalabardhë - dhe këtu kanë të drejtë - por ka minoritet bullgar, dhe bashkia duhet krijuar mbi këtë bazë. Dhe kjo duket vërtetë qesharake dhe që janë deklarata gjeopolitike në interes të strategjive të tyre të vjetra nacionaliste ndaj trojeve shqiptare. Ne që jemi autoktonë në Kalabardhë, nën nderin dhe përgjegjshmërinë tonë morale, deklarojmë të vërtetën se në Kalabardhë nuk ka as minoritet maqedonas dhe as minoritet bullgar. Këtë të vërtetë absolute e vërtetojnë të gjithë faktorët gjenetikë, etnikë, historik, kulturorë, tradicionalë, arkivor, dokumentar, siç e tregojnë edhe harta e tabela bashkëlidhur e censusit 2011. Po, në Kalabardhë ka kalabardhas, sikurse shqiptarë të tjerë nga Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Berati, Vlora etj. që kanë nevojë për një pasaportë bullgare për të ikur në Gjermani, Angli, Francë për të punuar, por asnjë në Bullgari.

Fatkeqësi është se një pjesë e opinionit, ndonjë politikan si dhe disa media shqiptare, duke mos njohur apo injoruar pavetëdije të vërtetën historike, amplifikojnë poshtërsisht dhe padrejtësisht sajesat nacionaliste të bullgarëve për krahinën e Kalabardhës. Edhe Televizioni Kombëtar Shqiptar, me financim të Ambasadës Bullgare, përgatiti një film dokumentar në tre pjesë plotë fallsitete për «pakicën bullgare».

Si dilenxhinj që janë e nuk kanë faqe që tu skuqet e ndërgjegje që t´i vrasë, matrapazët hedhin një gur dhe fshehin dorën dhe si fabula që njëqind të mençur nuk e nxjerrin dot gurin që hedh budallai. Këta edepsëz, - siç thotë populli nga anët tona - vazhdojnë të hedhin më shumë gurë dhe fërkojnë duart tek shohin të zgjuarit duke u munduar të kthjellojnë ujin e të nxjerrin gurët. Megjithëse Rumi mendon se "Me një fakt mund të mundësh 40 profesorë, një idioti nuk ia del dot as me 40 fakte", kalabardhasit ia kanë dalë e do ia dalin, se janë me të vërtetën historike, fakt përmbi çdo falsifikim absurd. Këta edepsëz, të varfër në shpirt e të dobët në karakter, që mbi nderin e dinjitetin venë paranë, vetëm sajojnë fakte dhe gënjejnë në mes të ditës. Gënjejnë si derri se kalabardhasit janë maqedonë, janë bullgarë. Edhe një herë ua themi të vërtetën në mes të ditës: kalabardhasit kanë qenë, janë e do të mbeten me gjak të pastër shqiptar.

Dhe për çudi autoritetet e zbatimit të ligjit në Shqipëri heshtin, megjithëse faktet i kanë tashmë në dosjet e tyre. Hesht edhe SPAK-u, kur vetë Bullgaria ka arrestuar para disa vitesh shitësit e 1900 pasaportave fallco për shqiptarët. Policia shqiptare ka ndaluar vetëm dy mashtrues në Tiranë, që u kanë marrë 25 shtetasve shqiptarë 40.000 €, kur "Ëeh-

rmacht"-ët shqiptarë pinë limonadë në "Hotel Dajti" me paratë ryshfet për pasaporta bullgare.

***

Ndërhyrja e nëndheshme nacionaliste e diplomacisë maqedonase dhe bullgare në etnicitetin e kalabardhasve rrezikon identitetin e tyre kombëtar dhe interesat kombëtare të Shqipërisë. Ndërkohë që jetojmë në sistemin demokratik, në perspektivën e Bashkimit Evropian, parimi bazë mbi të cilin është ngritur ky projekt politik është mosndërhyrja as në identitetin kulturor, jo më në atë identitetin etnik. Këtë besojmë se e dinë edhe ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, që megjithëse është shqiptar, vjen si kaçak në Trebisht të Kalabardhës, më 28 gusht 2022, dhe u tregon arrat trebishtasve. U thotë që ju jeni maqedonas, dhe duhet të kërkoni krijimin e bashkisë së Kalabardhës mbi bazë minoritare maqedone. E kujt ia thotë?! Këtyre burrave e grave shqiptare, atdhetarë e trima të zotë e të nderuar, që kanë luftuar brez pas brezi kundër armiqve të tyre sllavë, që i kanë luftuar për lirinë e vendit të tyre të shqiponjave, që kanë ndërtuar Shqipërinë. A thua se ata nuk i njohin të parët e tyre, rrënjët e tyre, gjakun e vetë dhe duhet të vij një «ministër» e tu tregoj përralla. Këtë mund ta bëj vetëm një antishqiptar. Sepse z. Osmani është ministër se është shqiptar, e jo maqedonas.

Heshtja dhe kthimi i shpinës nga trebishtasit e urtë e të mençur ka qenë përgjigja më e duhur që ka marrë: nuk ka pakicë kombëtare maqedonase në Kalabardhë. Këtë duhet ta kishte ditur mirë ministri Osmani dhe të mos vinte fare në Kalabardhë për të ndjellë përçarje mes kalabardhasve. Po kështu atje ka vajtur edhe ambasadori bullgar para disa muajsh, i cili ka marrë të njëjtën përgjigje nga kalabardhasit patriotë: nuk ka pakicë kombëtare bullgare në Kalabardhë.

Nga hulumtimet e plota historike e dokumentare, por edhe trashëgimia gojore e të parëve tanë vërtetohet katërçipërisht origjina iliro-arbërore, shqiptare e kalabardhasve. Të 324 fiset që banojnë në 37 fshatrat e krahinës së Kalabardhës, që janë brenda kufirit shtetëror, figurojnë autoktonë. Asnjë fis nuk figuron i ardhur. Nëse bullgarët dhe maqedonasit pretendojnë se ka minoritet në Kalabardhë, le të dokumentojnë të paktën një fis se nuk janë autokton! Le të nxjerrin statistikat zyrtare dhe listat e minoritarëve. Dhe ne do u argumentojmë me ADN, me trashëgimi historike, me traditën etnokulturore dhe plotë fakte të tjera se asnjëri prej atyre që pretendoni ju, nuk janë sllavë. E vërteta e padiskutueshme është se: kalabardhasit janë autoktonë në trojet e veta, janë me rrënjë e gjak të pastër shqiptar.

Kështu, diplomacia bullgare e maqedone mos t´i fryjnë më politikës së vjetër të tyre nacionaliste, shoviniste. Historia e ka provuar që kalabardhasit nuk shesin gjakun e tyre. Për këtë mjafton t´i hedhin një sy përgjigjes që kanë marrë nga kalabardhasit kur sllavët kanë ardhur si pushtues në këto treva në vitet e Luftës së Parë e të Dytë Botërore.

***

Kalabardhasve nuk ua nxinë dot faqen askush, se ata kanë qenë e mbeten burra fisnikë e patriotë, Zot në trojet e tyre kombëtare shqiptare! Sapo shqiptarët të mos kenë më nevojë për pasaportën bullgare do marrë fund edhe maskarada

histori

Ethnic and cultural affiliation	Resident population	Percentage of resident population
Albanian	2,312,356	82,58%
Greek	24,243	0,87%
Macedonian	5,512	0,20%
Montenegrin	366	0,01%
Aromanian	8,266	0,30%
Roma	8,301	0,30%
Egyptian	3,368	0,12%
Other	2,644	0,09%
Prefer not to answer	390,938	13,96%
Not revelant/not stated	44,144	1,58%
Total	**2.800.138**	**100%**

Source: Institute of Statistic (Nurja 2012, 71, Table 1.1.13).

e këtyre idiotëve, edepsëzëve. Dhe historia do i kujtojë si tradhtarë.

Ju, rasputinë, mund të deklaroni çfarë të doni sot, në këtë anarki që sundon në Shqipëri, por gjakun që rrjedh në damarët e tyre nuk ua ndërroni dot kalabardhasve, ADNI-në nuk ua ndërroni dot. Shpirtin kombëtar dhe krenarinë, respektin për të parët e tyre kreshnik nuk ua shkulni dot. Se kalabardhasit janë me karakter burrëror, janë patriotë, janë fisnikë dhe e kanë treguar veten gjithmonë përballë hasmit sllav. Sikurse dhe gjyshërit e stërgjyshërit tuaj, që ju sot ju hidhni baltë mbi ta, përdhosni identitetin e tyre për ca kacidhe. Kalabardhasit kanë qenë gjithnjë dhe do jenë faqebardhë.

Përfaqësuesi i Shoqatës «Golloborda» gënjeu për gjuhën e kalabardhasve, kur deklaroi se 90% e popullsisë flasin gjuhën bullgare. Sepse: së pari, në terma teknik, zhargoni sllavë përdoret vetëm në 14 nga 37 fshatrat e Kalabardhës që janë brenda kufirit shtetëror ose në 143 nga 324 fise, pra në vetëm 35% të kalabardhasve, ose flitet vetëm në 14 nga 25 fshatrat e bashkinë Kalabardhë që pretendohet, pra në e 143 nga 194 fise; së dyti, në substrat etnik, zhargoni nuk është gjuhë amtare, por një mbivendosje gjuhësore, që e ka imponuar Perandoria Bullgare në kohën e pushtimit të kësaj zone në shekujt 9-11-të, kur cari Bullgar urdhëroi shpërnguljen e popullsisë së disa fshatrave të Kalabardhës, për në malet e Pindit, në Bullgari, për 80 vjet që "kjo zonë të mbetet e zbrazët". Shkurt e folura është mishmash fjalësh shqip, sllavisht dhe rumanisht, që e kanë diktuar rrethanat historike që nga koha e pushtimit dhe e sundimit bullgar të kësaj treve.

Të parët tanë kanë pohuar gjithnjë të vërtetën e origjinës shqiptare. Këtë të vërtetë e ka pohuar edhe i ndjeri Budin Budini, nga Klenja e Kalabardhës, i cili vdiq në moshën 100 vjeçare në vitet 70 të shekullit të kaluar, kur tha: «Biro, kam biseduar me të ndjerin pop Angjele Rajkun, nga fshati Steblevë, që vdiq në vitin 1902, në një moshë rreth 100 vjeçare dhe ai më tha, atëherë: «Ne, ortodoksit e Gollobordës, jemi shqiptarë të pastërt, të ardhur nga Macukulli i Matit dhe nga zona të tjera të atij rrethi».

Gjuha e nënës e kalabardhasve është gjuha e bukur shqipe, gjuha e bekuar e Perëndisë. Përfaqësuesi i Shoqatës «Golloborda» e di mirë si këndojnë kalabardhasit në zhargonin sllavë përreth flamurit tonë kombëtar shqiptar:

"Rosa rosit, v'Arbanoshka zemja
shto na rosi cervenion bajrak
rosa rosit, v'Arbanoshka zemja
shto na rosi kiteni svatovi ...

Shi i imët bie në tokën arbërore
që na e lagu flamurin e kuq
shi i imët bie në tokën arbërore
që na i lagu krushqit e stolisur.

Kjo është gjuha e kreshnikëve kalabardhas, me të cilën u kanë folur pushtuesve sllavë atdhetarët martirë Hazis Lila, Hasan Muglica, Elez Koçi, Fetah Cami, Ahmet Cami dhe mijëra të tjerë. Në kohën e caktimit të kufijve (1913), gratë e Trebishtit dhe të fshatrave të tjerë janë përgjigjur shqip përpara anëtarëve të Komisionit Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve dhe më vonë atij të Ratifikimit. Kujtojmë se ushtria bullgare, në 1916, ia preu kokën preu kokën komandantit të "Çetës Kaçake", Mehmet Zenel Hoxhës, se kërkoi «harfe shqipe»!

Natyra e shqiptarëve por edhe e gollobordasve, në zemër të Arbërisë, ka qenë e tillë që në lashtësi, siç historiani i lashtësisë, Straboni, thotë se "Fiset pellazge ishin bilingë ...", sepse flitnin latinisht dhe shqip. Shqip kanë folur edhe filozofë e historianë të lashtë grekë, dhe ne do mund t'i quajmë shqiptarë? Dihet se dygjuhësia nuk është fenomen vetëm i krahinës së Kalabardhës, por ajo ndeshet edhe në të folmen

Nëse kalabardhasit qenkan bullgarë, përse Bullgaria nuk ka bërë asnjë investim në Kalabardhë për 30 vjet?! As rrugë, as shkollë, as spitale, asgjë! Veçse ka dhënë ca kacidhe për një kishë në fshatin Steblevë. Po, mos tia hamë hakun, ka dhënë edhe gjashtë kompjuterë për shkollën e mesme "Elez Koçi" të Ostrenit të Madh, atdhetarit që e futi në dhe të gjallë në 1916. Nëse kalabardhasit do ishin bullgarë, përse Bullgaria i ka vrarë e ka prerë historikisht, në 1915-1916, në 1941-1944?!

e popujve të tjerë të Ballkanit, të Evropës e të kontinenteve të tjerë të Botës. Vetë Bullgaria e di mirë ndikimin e madh të helenizmit te pjesa më e madhe e bullgarëve, në shekullin e 18-të, "saqë shumica e popullatës e quanin veten grekë me arsyen se gjuha greke është gjuha e fesë së tyre". Mirë që doli prifti Paissi dhe i thirri popullit bullgar, "njiheni historinë dhe gjuhën bullgare!"

Përfaqësuesi i Shoqatës «Golloborda» gënjeu për traditat e zakonet e kalabardhasve dhe veshjet tradicionale, që janë vetëm shqiptare, dibrane: kuq e zi. Burrat kalabardhas mbajnë kësulën e bardhë mbi krye në shenjë krenarie për origjinën e tyre arbërore dhe hidhnin vallet e bukura të shqiponjave, në dallim nga vallet këmbëplasëse të sllavëve. Karakteristikat e veshjes së grave të Trebishtit e të fshatrave të tjerë të Kalabardhës janë shqiptare, janë unikale në zonë dhe nuk gjenden as në Bullgari e as në Maqedoninë fqinje. Kjo është e vërteta etnokulturore.

Kalabardha e ka sprovuar atdhetarinë e saj me vepra, siç më shkruan një intelektual i nderuar dibran, me peticione "drejtuar Lidhjes së Kombeve duke kundërshtuar veçimin e krahinës nga trungu i saj kombëtar", Shqipërinë. Krahina jonë është e lavdishme, si shumë krahina të tjera shqiptare.

Bullgaria i ka vrarë e prerë kalabardhasit, e ka djegur Kalabardhën sepse ishin shqiptarë. Ushtria pushtuese bullgare vrau e i futi të gjallë në varr Eles Koçin dhe Qazim Dukën në Ostrenit të Madh, më 4 mars 1916, se ngritën flamurin kombëtar shqiptar në fshatin e tij Ostren! Vrau Iljaz Kanxhën, Tahir Zenelin, Jashar Lilën, Murat Cenaj dhe Jusuf Çelën në Trebisht; Jonuz Shirën dhe Rustem Shabanin në Tërbaç etj. Ushtria bullgare internoi në Negotinë gjithë banorët myslimanë të Sebishtit. Edhe në vitin 1916, bullgarët ngritën në Trebisht, në Klenjë dhe në Ostren të Vogël krahinari, por morën përgjigjen nga kalabardhasit.

Nëse kalabardhasit qenkan bullgarë, përse Bullgaria nuk ka bërë asnjë investim në Kalabardhë për 30 vjet?! As rrugë, as shkollë, as spitale, asgjë! Veçse ka dhënë ca kacidhe për një kishë në fshatin Steblevë. Po, mos tia hamë hakun, ka dhënë edhe gjashtë kompjuterë për shkollën e mesme "Elez Koçi" të Ostrenit të Madh, atdhetarit që e futi në dhe të gjallë në 1916. Nëse kalabardhasit do ishin bullgarë, përse Bullgaria i ka vrarë e ka prerë historikisht, në 1915-1916, në 1941-1944?! Përse internoi sebishtasit?! Përse ngriti burgun në Sebisht? Përse ngriti garnizonin ushtarak në lagjen Guri të Ostrenit të Madh?! Përse ua grabiti e ua dogji gjithë shtëpitë?!

Po, Bullgaria ka dhënë mijëra pasaporta falco për t'i larguar kalabardhasit nga shtëpitë e vendlindja! Kujtojmë aksionin e 2018-2019 që shkatërroi grupin e "falsifikatorëve të pasaportave", mes tyre edhe Petar Haralampiev, drejtor i Agjencisë për Bullgarët Jashtë Vendit dhe Krasimir Tomov, sekretar i përgjithshëm i kësaj Agjencie, persona "përgjegjës" për bërjen shtetas bullgarë të 1900 shqiptarëve.

***

Kalabardhasit kanë besim të plotë se parlamentarët tanë do tregohen kombëtar, nuk do bien pre e mashtrimeve gjeopolitike dhe nacionalizmave të sëmurë bullgar apo maqedonas, sikurse parlamentarët e vitit 2017, kur miratuan ligjin antikombëtar të pakicave, diskriminues për kalabardhasit atdhetarë. Do vlerësojnë të vërtetën historike, autoktoninë dhe rrënjët iliro-arbërore të kalabardhasve, do vlerësojnë atdhetarizmin, nderin, krenarinë e dinjitetin kombëtar shqiptar të tyre.

Kalabardhasit deri dje kanë luftuar dhe derdhur gjakun për mbrojtjen e lirisë e trojeve të veta stërgjyshore dhe sot protestojnë për këtë me flamurin e tyre kombëtar kuq e zi!

Kalabardha ka qenë e do jetë kështjellë e Arbërisë, e shqiptarizmit.

Identiteti ilir-arbëror i kalabardhasve nuk është plaçkë tregu.

Tiranë, më 11.09.2022

Degradon pedonalja e "Rilindjes Urbane"

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Bashkia e Bulqizës ishte një ndër përfituesit më të vegjël të projektit të qeverisë të pagëzuar si "Rilindja Urbane" dhe mori vetëm 1,9 milion euro ose 0.7 për qind të 365 milion eurove të shpenzuara si pjesë e këtij programi në rikonstruksion të qendrave urbane, rrugëve e shkolla.

Gati gjysma e këtyre parave, rreth 820 mijë euro, shkuan për ndërtimin e asaj që u pagëzua si pedonalja e qytetit. Projekt u prezantua nga qeveria si zhvillim i rëndësishëm.

"Projekti që shndërron një rrugë pa standarde sot, në një pedonale shplodhëse dhe i ndryshon konceptin por edhe cilësinë Bulqizës në shërbim të qytetarëve të saj", thuhet në njoftimin e qeverisë në qershor 2015.

Por 6 vjet pasi u inaugurua rrugica është kthyer sërish në një kantier ndërtimi, pasi pllakat prej guri që u përdorën në ndërtimin e saj u thyen dhe u shkulën.

Aktivistët e shoqërisë civile ankohen së investimi tashmë ka shkuar dëm.

"Kjo gjysmë pedonale ka degraduar totalisht, ka nisur shkallmimi i plakave edhe në gjysmën tjetër", thotë Danjel Bica, kryetar i Fondacionit Ekspertët e Rinj Mjedisor.

Ndryshe, drejtuesit vendor e shohin situatën më rozë. Në përgjigje të pyetjeve nga BIRN, bashkia e Bulqizës i minimizoi dëmet.

"Ka pësuar disa dëmtime të vogla", tha ajo.

Megjithatë, pushteti vendor do të investojë këtë vit 24 milionë lekë për të rehabilituar pjesë të pedonales në sheshin kryesor sëbashku me muzeun e qytetit. Pjesë të tjera po rikonstruktohen në funksion të rehabilitimit të kanalizimeve.

Ky nuk është projekti i vetëm i "Rilindjes Urbane" i dëmtuan në më pak se një dekadë nga ndërtimi. Në Berat, me justifikimin e punimeve të dobëta sheshi kryesor i qytetit i bërë si pjesë e "Rilindjes Urbane" iu nënshtruar një rikonstruksioni të ri, në të cilin u shtua edhe një parkim". Në Kukës për shkak të një defekti në kanalizime, një pedonale e ngjashme u kthye në shqetësim për qytetarët për shkak të erës së rëndë të ujërave të zeza.

Pllakat u thyen nga ngrica

Projekti i pedonales në Bulqizë u financua në fazën e parë nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe përfshiu edhe ndërtimi i Unazës së Poshtëme të qytetit, të njohur sot si rruga Dilaver Sinani, si dhe rikonstruksioni i fasadave, në lagjen Gjeologu.

Vlera e këtij investimi, realizuar ndërmjet viteve 2015-2016, ishte 101 milion lekë.

Kryeministri Edi Rama e mburri atë si projektin e parë që sillte ndryshime cilësore në Bulqizë "pas njëzet e kusur vitesh rrënim e braktisje në balte dhe në pluhur".

Por ndërsa fillimisht shëtitorja, ngjalli shpresë ndryshimi te banorët, ajo u kthye në pak kohë në një problem për qytetin.

Rrasat e gurit me të cilat ajo është shtruar, kanë dalë pjesërisht nga vendi në të gjithë gjatësinë e saj. Pjesë të tyre janë thërrmuar.

"Është një investim i dështuar", thotë Ferat Kurti, qytetar i Bulqizës. Kurti thotë se vetë ndërhyrjet e bashkisë për të rikonstruktuar pjesë të saj, tregon problemet që pati projekti.

"Këtë e konfirmojnë edhe ndërhyrjet që po bën bashkia, në qendër të qytetit dhe tek policia, për meremetimin e defekteve të bllokimit të kanaleve të rrjedhjes së ujrave të zeza", thotë Kurti.

Në fakt vetë bashkia pranon në përgjigje të saj se projekti nuk ka marrë parasysh kushtet e qytetit dhe as temperaturat e tij.

Shëtitorja është realizuar me pllaka guri nga mali i Tomorrit, por këto shkërmoqen në temperatura të ulëta dhe ngrica që në Bulqizë janë të zakonshme.

Nga ana e saj bashkia pranon se dëmtimet "kanë ardhur më së shumti, si pasojë e ngricave gjatë periudhës së dimrave të kaluar", por thotë se shëtitorja nuk e ka humbur funksionin kryesor të saj.

Në përgjigje të pyetjeve bashkia i tha BIRN se do i riparonte dëmtimet. "Bashkia do të marrë të gjitha masat e nevojshme, që këto dëmtime të riparohen dhe të bëhet kthimi në normalitet i pedonales", thuhet në përgjigje.

Por Danjel Bica, kryetar i shoqatës "Ekspertët e Rinj Mjedisor", ka dyshime që rruga e kryen këtë funksion. Ai thotë se vecc shtrimit me pllaka guri që ka rezultuar problematik, pedonales i mungonte rikualifikimi urban, ndërsa në të nuk ishte parashikuar as gjelbërim dhe as sheshe për pushim të banorëve.

"Ajo që mua si ekspert mjedisor më dhëmb shumë, është mungesa totale e gjelbërimit dhe shesheve të pushimit, në të gjithë shtrirjen e kësaj pedonaleje", tha ai.

Shkrimi origjinal: https://www.reporter.al/2022/10/10/degradon-pedonalja-e-rilindjes-urbane-ne-bulqize/

Rruga e Arbërit nr. 193-195

28 Nëntori - Dita e Flamurit Kombëtar Shqiptar

refleksione

Në pritje të "28 Nëntorit të Tretë" – ditës së bashkimit etnik të shqiptarëve

Nga nëntori i Skënderbeut te Nëntori i Ismail Qemalit, një historik i shkurtër i ngritjes së flamurit dhe rritjes së ndërgjegjës kombëtare, për të ardhur të nëntori i tretë i shumëpritur: bashkimi i shqiptarëve nën një shtet.

Nga **Dr. ENVER HALILI, Australi**

28 Nëntori - Dita e Flamurit Kombëtar Shqiptar - është dita më e rëndësishme e kombit tonë, por është edhe një ndër ditët më të lavdishme të popujve liridashës të Europës dhe më gjerë. Historia e lashtë dhe shumë e lavdishme e flamurit tonë kombëtar bëri që 28 Nëntori t'i lëshojë rrënjët thellë në dijen dhe ndërdijen e popullit shqiptar.

"28 Nëntori" i parë në Krujën e Kastriotëve vuri themelet e kombit shqiptar; "28 Nëntori" i dytë në Vlorën heroike të Ismail Qemalit krijoi Shqipërinë Politike; ndërsa "28 Nëntori" i tretë, presim që ta kurorëzojë Shqipërine Etnike! "28 Nëntori" i Gjergj Kastriotit është një mishërim natyral me Flamurin Kuq e Zi dhe Shqiponjën dy krenare, e cila ka një histori të moçme dhe shumë të lavdishme që nga parahistoria. Shkabën dy krenare e patën simbol pellazgët e lashtë dhe vetë Zeusi kishte një respekt të veçantë për të. Mandej, Pirroja i Epirit, Konstandini dhe Justiniani i Madh shqiponjën dykrerëshe e kishin simbol të perandorive të tyre. Edhe Konstandini i Fundit (nga Hasi i Prizrenit) me këtë flamur ra në fushëbeteje në mbrojtjen e Konstandinapojës me 1453.

Me të drejtë mund të pohohet se "28 Nëntori" i ka lëshuar rrënjët thellë në historinë tonë të lavdishme dhe u brumos me shqiponjën dykrenare. "28 Nëntori" dhe shqiponja dykrerëshe u përjetësuan qysh atëherë kur heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti, me 300 trima shqiptarë ngriti Flamurit Kuq e Zi në kalanë e Krujës në vitin 1443. Rëndësinë e "28 Nëntorit" të Krujës kreshnike më së miri e përshkruan rilindësi ynë i madh Naim Frashëri në vargjet e tij të mrekullueshme: "Krujë o qytet i bekuar,/ prite, prite Skënderbenë,/ po vjen si pëllumb i shkruar,/ të shpëtojë mëmëdhenë." Valimi i lirë i flamurit kuq e zi në kështjellën e Krujës solli shpresë në popull dhe i dha një shtytje të fortë papara luftës për çlirimin e atdheut.

Gjergj Kastrioti kishte vizion, ishte largpamës, ishte i vetëdijshëm se për të realizuar dëshirën e popullit, duhet të bashkohen të gjithë princat arbëror dhe të veprojnë me një program të koordinuar nga një qendër. Kështu që, më 2 Mars të vitit 1444, Skënderbeu arriti t'i bashkoje shumicën e princave arbëror në Kuvendin e Lezhës me "besë-besë" me qëllim që të punojnë e luftojnë për çlirimin e vendit, ndërtimin e shtetit dhe mbrojtjen e etnisë arbërore.

"Shqiptarët sypatrembur nuk mundën ta konceptonin përuljen e nënshtrimin nga pushtuesi, ata donin admirim dhe jo mëshirë e nënshtrim nga pushtuesi", nënvizonte Aristidh Kola (1983). Prandaj, Princat arbëror u bashkuan në një front të vetëm për çlirimin e vendit dhe për të ndërtuar një jetë të dinjitetshme.

Mendja racionale e princërve arbërorë arriti që interesat e tyre personale e krahinore t'i venë në shërbim të interesit të lartë të atdheut. Në Kuvendin e Lezhës, për herë të parë në historinë tonë, u krijua shteti kombëtar. Në Kuvendin e lavdishëm të Lezhës u arrit kalimi nga praktika e modelit të trashëguar të principatës rajonale, si formë e shtetit, në atë të "shtetit-komb" me një qendër të vetme, kësaj radhe në qendrën e Kastriotëve në Krujë. Kruja u bë qendra e parë kombëtare, e cila arriti ta përfaqësojë interesin e përgjithshëm të arbërve nën Mbretërinë Kombëtare. Kuvendi i Lezhës vuri bazën mbi të cilin do të krijohet, kultivohet dhe ngrihet ndërgjegjja shtetërore e kombëtare shqiptare.

Mbretëria e Arbërore nuk arriti të jetojë gjatë, por idetë, parimet dhe vizionet e Kastriotit u përjetësuan në mendjen dhe krenarinë shqiptare. "28 Nëntori" i Gjergj Kastriotit do të bëhet një frymëzim për të gjitha gjeneratat, të cilat pavarësisht kushteve të rënda, çdo herë gjetën frymëzim dhe u motivuan që të rezistojnë dhe luftojnë për çlirimin e atdheut.

"28 Nëntori" u shndërrua në një faktor motivues për çlirim kombëtar në të gjitha periudhat e mëvonshme kohore dhe për të gjitha gjeneratat duke përfshirë Gjon e Gjergj Kastriotin e Ri, Pjetër Bogdanin, Ali Pashë Tepelenën e Balshajt e Shkodrës, Sulejman Vokshin e Micë Sokolin, Marko Boçarin e Oso Kukën, Bajo e Çerçiz Topullin, Dedë Gjo Lulin, Isa Boletinin dhe Idriz Seferi, Shote e Azem Galicën, Shaban Polluzhën, Hysen Terpezën e Xhemë Gostivarin, e deri te Adem e Hamzë Jashari.

Rilindësit tanë mendje ndritur, të udhëhequr nga Abdyl Frashëri, nën Flamurin e Kastriotit, u mblodhën në Prizren në qershor të vitit 1878, ku i treguan fuqive të mëdha se shqiptarët do të luftojnë deri sa të çlirohet vendi, qoftë të mos mbetet edhe një njeri i vetem (S. Frasher 1878). Në Kuvendin e Prizrenit shqiptarët arritën të bashkohen rreth një qëllimi, sepse ishin të prirur nga porosia e Kastriotit "të jeni gjithmonë të bashkuar" në luftë për çlirimin e vendit. "28 Nëntori" i Gjergj Kastrioti u shndërrua në simbol të bashkimit, pavarësisht besimeve të ndryshme fetare (Repishti 2004).

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), ishte krijuar sipas Doktrinës së Gjergj Kastriotit dhe ishte frymëzuar nga "28 Nëntori" i Krujës kreshnike. Ajo është lëvizja e parë me përmasa gjithëkombëtare e organizuar me tërë kompleksitetin e vetë shtetformues si arsimor, kulturor, politik, ushtarak, administrativ dhe social. Qëllimet e lëvizjes ishin të parashtruara nga Programi i Rilindjes Kombëtare me syninimin bashkimin e popullit në një front të përbashkët për të çliruar atdheun. Rilindësit luftonin për të çliruar e bashkuar tokat shqiptare dhe për të krijuar një shtet autonom kombëtar (S. Frashëri 1878; A. Ermenji 1973). Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), edhe pse nuk arriti ta çlirojë vendin, arriti me sukses të mbjellë, kultivojë dhe zhvillojë ndjenjën e lirisë. Siç theksonte lideri i Lidhjes, Abdyl Frashëri "fara u mbuall" dhe frytet do të korren shumë shpejt.

Luftërat e përgjakshme shekullore të popullit tonë arritën ta kurorëzojnë porosinë e Gjergj Kastriotit dhe idenë e Programit të Rilindjes Kombëtare për çlirimin e atdheut me 28 Nëntor 1912, kur Ismail Qemali me patriotët shqiptar ngriti Flamurin e lirisë në Vlorën heroike. Sikurse dikur Gjergj Kastrioti, edhe Isa Boletini me 300 kalorës kosovarë arriti në Vlorë, ku me respekt të veçantë u përul dhe puthi flamurin e Kastriotit. Garda e Parë Kombëtare me plisa të bardhë nën komandën e Isa Boletinit me pushkë në dorë mbrojti flamurin kombëtar dhe u çimentos në themelet e shtetit shqiptar, më 28 Nëntor 1912.

Ngritja e flamurit të Kastriotit në Vlorë më 1912, përfaqësonte fitoren kombëtare e të gjitha trevave shqiptare, prej Tivarit në perëndim, e Sjenicës në veri, deri në Artë e Prevezë në jug, prej brigjeve të Adriatikut e Jonit në perëndim, deri në Manastir, Shkup, Kumanovë, Luginën Moravës në lindje e deri në Vranje, e Nish në verilindje. Patriotët e të gjitha regjioneve shqiptare dhanë një ndihmë kolosale për çlirimin kombëtar dhe ngritjen e Flamurit Kuq e Zi në Vlorë.

Ashtu si vepruan dikur princat arbërore në krye me Gjergj Kastriotin, ashtu edhe patriotët e Pavarësisë si L. Gurakuqi H. Prishtina, I. Boletini, Çerçiz e Bajo Topulli, M. Grameno, D. Gj. Luli, I. Seferi, e shumë të tjerë me I. Qemalin në krye, shkrinë tërë pasurinë e tyre dhe u flijuan në altarin e lirisë. Por "Nëntori i Dytë" arriti të çlirojë vetëm një pjesë të vogël atdheut, dhe fatkeqësisht, shumica e vendit dhe popullit tonë mbeti jashtë kufijve të shtetit të ri dhe u pushtuan nga forcat greke dhe sllave të ndihmuar nga Rusia cariste.

Pavarësisht rrethanave shumë të vështira të shekullit njëzet, lavdia e "28 Nëntorit" të Kastriotit arriti të futet thellë në mendjen dhe shpirtin e popullit tonë. "Dita e Flamurit - 28 Nëntori" u shndërrua në një festë të dhembjes krenare për shqiptarët. Nga viti 1912, populli shqiptar jashtë kufijve të Shqipërisë politike, "28 Nëntorin" e festonin me demonstrime e kryengritje të përgjakshme në shenjë kujtimi të kaluarës sonë të lavdishme dhe duke shfaqur hapur aspiratat e tyre për liri. Kremtimi i Ditës së Flamurit u shndërrua në një faktor inspirues si për Tiranën, Prishtinë, Shkupin, Manastirin e qendrat tjera që të punohej për të arritur amanetin e Kastriotit dhe realizuar idenë e Programit të Rilindjes Kombëtare: çlirimin përfundimtar të atdheut dhe bashkimin e të gjitha trojeve në një shtet të vetëm kombëtar.

Festa e "28 Nëntorit - Dita e Flamurit" është faktori kryesor i krenarisë kombëtare, e cila u mundësoi, jo

Shqiptarët sot janë në pozitë shumë më të volitshme gjeopolitike. Ne e kemi përkrahjen e vendeve demokratike në tërë botën, sidomos të SHBA-së, Britanisë, Gjermanisë, Japonisë, e vende tjera. Shqiptarët duhet ta shfrytëzojnë këtë moment historik, t'i lënë mënjanë interesat e ngushta dhe dallimet politike, të këndellen e të bëhen unike në veprimet e tyre. Sot, si asnjëherë më parë kumbon thirrja e rilindësit tonë të shquar Pashko Vasa "zgjohuni shqiptarë nga gjumi zgjohuni, rreth Flamurit Kombëtar me një besë bashkohuni". Sot po vjen ora jonë dhe Shqipëria duhet të bëhet njëherë e përgjithmonë.

vetëm shqiptarëve, të cilët jetojnë në viset e pushtuara, por edhe emigrantëve shqiptarë që t'u rezistojnë dallgëve të asimilimit në kohëra dhe vende të ndryshme. "Dita e Flamurit" ishte forca shpirtërore për shqiptaret jashtë mëmëdheut, të cilët i mbijetuan asimilimit dhe krenohen me gjakun e tyre shqiptar. Shembuj të mbijetesës kombëtare kemi ane e kënd globit, siç janë arbëreshët në Itali, çamët dhe arvanitasit në Greqi, shqiptarët e emigruar në Turqi, Rumani, Bullgari, Ukrainë, në vendet perëndimore si në: Itali, Zvicër, Gjermani, Angli, SHBA, Australi e vendet tjera. Festa e "28 Nëntorit" mot për mot bashkon shqiptarët rreth Flamurit Kombëtar, për të kremtur me krenari këtë ditë të madhe kombëtare. Emigrantet shqiptar, kudo që ata punojnë dhe jetojnë, e festojne "28 Nëntorin" me dashuri e dinjitet, në shenjë respekti dhe krenarie për gjakun e derdhur dhe sakrificat mbinjerëzore të popullit tonë ndër shekuj.

Mund të pohohet lirisht se vështirë është të gjendet në ndonjë vend apo popull tjetër një festë aq e lavdishme siç është "28 Nëntori" i Gjergj Kastriotit dhe "28 Nëntori" i Ismail Qemalit. Në këtë ditë, të gjithë pjesëtarët e kombit tonë, anë e kënd botës, me flamuj me shkabën dykrenare në duar bashkohen për të kremtuar një festë, sa të lashtë, aq edhe madhështore, për të shprehur respektin për të gjithë ata që u sakrifikuan për atdhe. Kjo feste është materializuar me sukses gjatë historisë sonë.

Sukseset e "28 Nëntorit" të Krujës kreshnike dhe "28 Nëntorit" të Vlorës heroike kanë vënë vulë të pashlyeshme në ndërgjegjen e popullit tonë në tërë hapësirën e Gadishullit Ilirik dhe gjithkund ku jetojnë e veprojnë shqiptarët. Andaj mund të thuhet lirish se "28 Nëntori" është bënë "ikonë e lirisë së popullit shqiptar!

Festa e "28 Nëntorit - Dita e Flamurit" sot dhe gjithmonë do të jetë faktor kryesor shtytës për të gjithë shqiptarët veçanërisht për politikëbërësit e shtetndërtuesit në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Preshevë, Ulqin, e udhëheqësit komuniteteve në diasporë. Shtetndërtuesit e sotëm, udhëheqësit e diasporës duhet ta ndjekin shembullin e Gjergj Kastriotit dhe Ismail Qemalit, patriotëve të Rilindjes Kombëtare dhe dëshmorëve të të gjitha luftërave çlirimtare dhe të mblidhen me "besa-besë" në Kosovë dhe të shkojnë për festuar me dinjitet "28 Nëntorin" në Mitrovicën e Isa Boletinit.

Politikëbërësit e shtetndërtuesit shqiptarë, kudo që veprojnë, e kanë obligim që ta materializojnë gjakun e derdhur në të mirë të popullit dhe tokës sonë të lashtë. Ata kanë obligim ndaj gjakut të derdhur nga shumë familje shqiptare si familja Jasharaj, Deliaj, Mehaj, Berisha, Bogu-

histori

“28 nëntori”, grafikë marrë nga “Albanian Post”

jevci etj; kanë obligim ndaj gjakut të derdhur në masakrat e shumta në këta dy-tre shekujt sidomos ndaj masakrave të fundit si ajo Prekazit, Reçakut, Rezallës, Rugovës, Poklekut, Dubravës, Studimes, Krushës, Kleçkës, Izbicës, etj; kanë obligim ndaj motrave dhe nënave të dhunuara e të masakruara; kanë obligim ndaj mbi 1,500 personave të pagjetur ende; kanë obligim ndaj qindra mijëra shqiptarëve të vrarë, torturuar dhe shpërngulur me dhunë nga vatrat e tyre në këta dy shekuj fundit nga kriminelet serbe. Politike-bërësit e shtet-ndërtuesit shqiptar e kanë obligim që sot ta ndërtojnë një shtet funksional për popullin, i cili dha aq shumë për çlirimin e vendit.

Liderët dhe politikanët e sotëm duhet të motivohen nga “28 Nëntori” i Krujës dhe Vlorës dhe t’i vënë interesat e tyre personale në shërbim të kombit dhe ta mbrojnë çdo pëllëmbë të tokës shqiptare. Nuk duhet lejuar që sot në Mitrovicën tonë të lashtë të lodrojnë kriminelet e Vuçiçit sikurse dikur vendoseshin e harliseshin çetniket e Pashiqit, Rankoviqi e Millosheviqit. Mitrovica dhe tërë Kosova-Dardania e lashtë ka qenë, është dhe do të jetë çdo herë e jona. Dardania (Kosova) është e bekuar nga Zoti. Vetë Zeusi e ka emëruar Dardaninë me emrin e të birit të tij të preferuar-Dardanit (Homeri, Iliada). Dardania ka forcë hyjnore dhe u ka rezistuar rrebeshëve të kohës gjatë të gjithë katrahurave historike që kur njerëzimi u krijua në rruzullin tokësor. Dardania (Kosova) siç do të thoshte Ismail Qemali “ka qenë dhe do të jetë shqiptare” (A. Ermenji 1973). Prandaj është obligim i çdo shqiptari (sidomos i lidershipit të tij) ta mbrojë këtë tokë të shenjtë dhe të ndërtojnë një të ardhme të lumtur për kombin tonë në këtë hapësirë të globit.

Shtetndërtuesit e sotëm duhet të ndjekin shembullin e Kastriotit, ta realizojnë Programin e Rilindjes Kombëtare, ta vazhdojnë rrugën e patriotëve dhe dëshmorëve të luftërave tona çlirimtare dhe amanetin e Adem Jasharit, të cilët jo vetëm sakrifikuan të gjithë pasuritë materiale, por derdhën gjakun dhe flijuan famlijet e tyre me qëllim që të çlirohet atdheu. Shtetndërtuesit dhe politikanët e sotëm e kanë obligim kombëtar që të japin kontributin maksimal për krijimin e një shteti funksional e demokratik, me qëllim që popullit t’i sigurohet një e ardhme më e mirë dhe të jetojë e punojë i lumtur në tokën tonë të shenjtë.

Mëmëdheu ynë i bekuar, sot me një vijë bregdetare prej mbi 450 km gjatësi, me fusha pjellore, me male të begatshme, me lumenj e liqene të kristaltë, me gryka e kanione mahnitëse, me minerale të pasura, me një forcë punëtore dhe intelektuale shumë vitale, i ka të gjitha kushtet për ta ndërtuar një ekonomi i fortë dhe të bëhet një vend i zhvilluar. Vendit tonë me gjithë këto begati natyrore dhe fuqinë njerëzore sot i duhet vetëm një qeverisje efektive e cila “...t’u hapte udhën e,... të vështrohet mirë, ..., mund të vejë shumë mbarë e t’ushqejë katër herë më tepër njerëz se sa ushqen sot”, sugjeronte eruditi Sami Frashëri (1878). Një e ekonomi e fortë dhe stabile mundëson që populli ynë të shëndrrohet në një faktor të rëndësishëm, jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Faktori shqiptar duhet ta konsolidojë gjithë forcat e veta dhe të marrë detyra të rëndësishme, të luajë rolin e duhur përkrah aleateve tanë në aksione të ndryshme.

Është detyrë parësore e liderëve tanë të angazhohen dhe vënë në funksion të zhvillimit të vendit të gjithë potencialin material e njerëzore, sidomos atyre nga diaspora, me qëllim që populli ynë ta ndërtojë një jetesë të lumtur në trojet e veta. Fatkeqësisht, ende “Arbëria matanë detit na kujton, se ne të huaj jemi në këtë dhe” (Serembe 1860). Por një gjë dihet mirëfilli, se diaspora shqiptare fizikisht jeton jashtë vendit, por shpirtërisht gjithmonë ka qenë e lidhur me mëmëdheun dhe vazhdimisht ishte dhe do të jetë në qendër të të gjitha veprimtarive kombëtare. Diaspora shqiptare sot disponon me kapital vital financiar, profesional dhe intelektual, të cilët janë faktorët parësor të zhvillimit ekonomik dhe kulturor të vendit. Andaj, është një detyrë akute sot që shtetndërtuesit dhe politikanët tanë të bashkërendojnë veprimet me intelektualët dhe forcat profesionale e krijuese brenda dhe në diasporë dhe të fillojnë përgatititjen e projekteve për nxjerrjen e vendit nga kjo varfëri ekonomike. Për shembull, papërgjegjësia e politikebërëseve kosovarë në dy dekada e fundit solli që sot Kosova të përballet me problemin e rrymës elektrike (pa drite dhe pa ngrohje në dimër) edhe pse kosovarët flenë në mbi 15 miliardë ton thëngjill.

Një zhvillimi i harmonizuar ekonomik mundëson ndërtimin e një sistemi kualitativ arsimor, shëndetësor, kulturor dhe administrativ. Krijimi i mundësive për investimet e kapitalit nga jashtë, dhe sidomos të kapitalit të diasporës sonë, do sendërton një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Një ekonomi e fortë do ta ngrejë nivelin e mirëqenies individuale dhe shoqërore dhe mundëson që njerëzit të jetojnë dhe festojnë të lumtur dhe me dinjitet “28 Nëntorin”. Një shtet funksional e demokratik u hap rrugë investimeve efektive dhe mundëson të krijohet dhe zhvillohet një ekonomi me një strukturë të qëndrueshme afatgjate. Një ekonomi stabile do të jetë në gjendje ta bartë barrën e zhvillimit të gjithë superstrukturës kombëtare. Vetëm atëherë kur shqiptarët janë të punësuar dhe ndërtojnë vendin e vet ata mund ta festojnë “28 Nëntorin” të lumtur e me dinjitet.

Shtetndërtuesit dhe liderët shqiptarë brenda vendit dhe në diasporë duhet të kthjellohen sot kur bota gjendet para një riorganizimi të madh gjeopolitik. Ata sot duhet të veprojnë të unifikuar mes vete, të koordinuar me aleatët tanë dhe të ecin në hap me kohën për të realizuar qëllimet kombëtare. Ne nuk kemi kohë për të humbur. Tani është momenti kur liderët shqiptarë duhet të veprojnë me një program të koordinuar nga një qendër, sikurse vepruan shqiptarët në kohën e Gjergj Kastriotit, Abdyl Frashërit e Ismail Qemalit. Mënjanimi i mosmarrëveshjeve mistrece u mbyll shtegun e ndërhyrjeve të huaja dhe eliminon pengesat drejt realizimit të qëllimeve të larta kombëtare (A. Ermenji 1973). Udhëheqësit shqiptarë duhet të operojnë si një trup i vetëm, sidomos sot kur armiku ynë historik - Rusia e Putinit, - po përballet me zjarrin e luftës së dështuar pranë derës së shtëpisë së vet. ...

Politikanët shqiptar kudo që janë në mëmëdhe apo diasporë sot, duhet të udhëhiqen nga Doktrina e Skënderbeut, Programi i Rilindjes Kombëtare dhe të frymëzohen nga veprat e patriotëve që u sakrifikuan ndër shekuj për çlirimin e mëmëdheut. Këto janë udhërrefyesit më të mirë për lidershipin politik shqiptar për të marshuar drejt fitores. Drita e “28 Nëntorit” dhe Flamuri Kuq e Zi janë forca shpirtërore, e cila mbajti gjallë kombin shqiptar ndër shekuj, është një fanar i pashuar i cili shndritë rrugën tona drejt çlirimit të tokave të pushtuare dhe na mëson për të krijuar e ndërtuar Shtetin Etnik Kombëtar, i cili do të kurorëzohet në “28 Nëntorin e Tretë!”

Liderët shqiptarë të Tiranës, Prishtinës e Shkupit, duhet të kërkojnë të paktën paritet për shqiptarët e Kosovës Lindore me serbët në Kosovë. Ne nuk duhet të lejojmë që sot banorët serbë të Kosovës të shpërblehen dhe shqiptarët në Kosovën Lindore të shtypen, përdhunohen dhe detyrohen të shpërnulen nga trojet e veta të lashta. Parimet e drejtësisë, lirisë e barazisë mbi të cilat ngrihet Europa demokratike duhet të veprojnë njësoj kudo dhe për secilin popull e grup etnik. Çdo krim duhet të zbulohet dhe aktorët duhet të identifikohen e të dalin para drejtësisë ndërsa viktimat duhet të kompensohen për dhunën dhe vuajtjet e përjetuara.

Liderët shqiptarë e kanë obligim të punojnë për t’u mundësuar shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë e Kosovës politike ta festojnë “28 Nëntorin” me dinjitet. Udhëheqësit shqiptar duhet ta mbrojnë hapur këtë të vërtetë dhe mos të hezitojnë të ngrejnë zërin kudo në zyrat e Evropës. “Nuk është faj me lyp të drejtën tënde” (A. Pipa 1959) dhe se “Kosova - do të thoshte prof. Abas Ermenji (1973), - nuk është një vend i huaj që shqiptarët duan ta pushtojnë, por është gjysma e kombit dhe ne duhet ta mbrojmë”. E drejta është në anën e lirisë dhe demokracisë, pra është në anën e shqiptarëve dhe liderët shqiptarë duhet ta mbrojnë atë.

Shqiptarët sot janë në pozitë shumë më të volitshme gjeopolitike. Ne e kemi përkrahjen e vendeve demokratike në tërë botën, sidomos të SHBA-së, Britanisë, Gjermanisë, Japonisë, e vende tjera. Shqiptarët duhet ta shfrytëzojnë këtë moment historik, t’i lënë mënjanë interesat e ngushta dhe dallimet politike, të këndellen e të bëhen unike në veprimet e tyre. Sot, si asnjëherë më parë kumbon thirrja e rilindësit tonë të shquar Pashko Vasa “zgjohuni shqiptarë nga gjumi zgjohuni, rreth Flamurit Kombëtar me një besë bashkohuni”. Sot po vjen ora jonë, dhe Shqipëria duhet të bëhet njëherë e përgjithmonë. Shqipëria do të bëhet sepse, “gjërat që kërkon kombi shqiptar, janë gjera legjitime, përbëhen nga e drejta e natyrshme dhe ligjore si e çdo kombi” (S. Frashëri 1878). Andaj, në këto momente Pavarësia e Kosovës dhe sovraniteti i saj territorial janë një kompromis, siç pohonte Dr. I. Rugova. Por nëqoftëse vjen deri te ristrukturimi i kufijve të Ballkanit, atëherë duhet të shpaloset opsioni i tretë i Dr. I. Rugovës, bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare me shtetin amë-Shqipërinë, si zgjedhja e drejtë dhe e natyrshme e kombit tonë.

Politikanët shqiptar kudo që janë në mëmëdhe apo diasporë sot, duhet të udhëhiqen nga Doktrina e Skënderbeut, Programi i Rilindjes Kombëtare dhe të frymëzohen nga veprat e patriotëve që u sakrifikuan ndër shekuj për çlirimin e mëmëdheut. Këto janë udhërrefyesit më të mirë për lidershipin politik shqiptar për të marshuar drejt fitores. Drita e “28 Nëntorit” dhe Flamuri Kuq e Zi janë forca shpirtërore, e cila mbajti gjallë kombin shqiptar ndër shekuj, është një fanar i pashuar i cili shndritë rrugën tona drejt çlirimit të tokave të pushtuare dhe na mëson për të krijuar e ndërtuar Shtetin Etnik Kombëtar, i cili do të kurorëzohet në “28 Nëntorin e Tretë!”

Botohet me shkurtime. Shkrimin e plotë e gjeni në:
http://rrugaearberit.com/2022/11/25/ne-pritje-te-28-nentorit-te-trete-dites-se-bashkimit-etnik-te-shqiptareve/

Rruga e Arbërit nr. 193-195

kujtesë

Në Qesarakë, Lagje 12 e kryeqytetit, përurohet shkolla 9-vjeçare që do mbajë emrin e tij. Gazeta "Rruga e Arbërit" e paralajmëroi që para një viti

Klodian Tanushi, përjetësimi i heroit të paqes në shkollën 9-vjeçare Qesarak

Nga **Halil RAMA**

Një vit më parë, Gazeta "Rruga e Arbërit" Nr. 12 (184) Dhjetor 2021, që në faqe të parë njoftonte titullin"Një shkollë me emrin e heroit të paqes, Klodian Tanushi"."Ishte kjo një kërkesë e babait të Heroit, ish-ushtarakut shembullor Basri Tanushi, mbështetur edhe me propozimet konkrete të dy organizatave të veteranëve: Org. së Veteranëve të LANÇ dhe Org. Bashkuar e Veteranëve të LANÇ (OBVL).

Në këtë kërkesë legjitime ato u motivuan nga libri monografik "Klodian Tanushi, Heroi i Paqes", botim mjaftë cilësor i "M&B", që si rast unikal ka për autor pikërisht babain e tij. Pikërisht vlerat e kësaj vepre monumentale qenë motivi i propozimeve të dy organizatave të veteranëve, të cilat pasi morën miratimin e Këshillit Bashkiak të kryeqytetit, më 2 Tetor 2022 u finalizuan me përurimin e shkollës me emrin e heroit "Klodian Tanushi" në Qesarakë.

FAMILJA TANUSHI, E ANGAZHUAR PËR MBARËVAJTJEN E SHKOLLËS QË MBAN EMRIN E KLODIANIT

Padyshim që babai, bashkëshortja, dy djemtë dhe vajza e tij e vogël qenë më të lumturit e kësaj dite, duke e konsideruar këtë akt si ringjallje të Klodianit. Babai i tij, Basriu, pasi falënderoi përzemërsisht anëtarët e Këshillit Bashkiak, Kryeministrin Rama, kryebashkiakun Veliaj dhe deputetin Xhemal Qefalia për mbështetjen që i dhanë kësaj nisme, shprehu kënaqësi dhe krenari të veçantë. "Është kënaqësi, por dhe krenari për mua, që të them dy fjalë zemre sot në këtë ditë të veçantë, e cila për mua dhe gjithë familjen Tanushi, shënon një epokë të re, atë të Rilindjes të djalit tonë Klodianit, me rastin e përjetësimit të emrit të tij në këtë shkollë kaq të bukur", u shpreh ndër të tjera Basriu.

Ai e konsideroi përjetësimin e emrit të të birit në një nga shkollat me arkitekturë moderne të kryeqytetit, si vlerësim për Klodianin, nderim për familjen, por edhe si obligim për fëmijët e Klodianit, të cilët e prisnin me pa durim këtë ditë.Ndërkohë, Ai i shprehu një falënderim të veçantë Kryeministrit Rama, që sipas tij në çdo çast i është gjendur pranë Familjes së heroit të Paqes Klodian Tanushi, për zgjidhjen e të gjitha problemeve që kanë pasur.Kjo shkollë, ashtu si shumë të tjera, nga dje do të mbajë emrin e një dëshmori të kombit, i cili, me dëshirën, guximin dhe vendosmërinë për të shpëtuar jetë të tjera, sakrifikoi jetën e tij në ditët më të bukura.

Me aktin e tij heroik, Ai nderoi jo vetëm familjen, por gjithë Shqipërinë, duke i treguar botës se ç'është shqiptaria. Pikërisht për këtë, duhet konsideruar si e drejtë legjitime kërkesa e babait të tij, bërë publike në këtë event mbresëlënës, që trupa pedagogjike e kësaj shkolle të angazhohet maksimalisht në procesin edukativ, mësimor e shkencor, për të bërë të mundur që kjo shkollë të renditet ndër shkollat më të mira të kryeqytetit. Dhe për këtë ky prind shembullor shprehu angazhimin dhe premtimin e Familjes së tij për të qenë gjithnjë pranë tyre, duke i takuar e biseduar dhe duke kontribuar sipas mundësive për mbarëvajtjen e shkollës.

SAKRIFIKOI JETËN PËR ATDHEUN

Më 2 tetor 2022, në përurimin e një prej shkollave të reja që është hapur këtë vit në Tiranë, së cilës i është vendosur emri "Klodian Tanushi, në nder të 'Dëshmorit të Atdheut', majorit që humbi jetën në krye të detyrës në Letoni", Kryeministri Rama që ishte i pranishëm në përurimin e saj në Qesarakë, me kushte dhe hapësira moderne, ndër të tjera vlerësoi aktin e heroit të paqes që sakrifikoi jetën për atdheun, duke mbetur shembull frymëzimi për të rinjtë.

Në fjalën e tij, kryeministri Rama tha se ky gjest tregon se sakrifica e majorit do të mbetet në kujtesën kombëtare, ndërsa vlerësoi punën e tij në shërbim të atdheut. Rama u shpreh se shembujt të tillë duhet t'u prezantohen fëmijëve e të rinjve në shkolla si frymëzim për përkushtimin që kanë dhënë ndaj atdheut.

"Më vjen mirë që jam këtu sot, sëbashku me familjen e të ndjerit dëshmorit Klodian Tanushi, me të atin, me zonjën, me fëmijët të cilëve asgjë nuk ua kthen dot njeriun e tyre të zemrës dhe asgjë nuk ua mbush dot boshllëkun e madh të mungesës së pranisë së tij, por së paku me këtë gjest ne u themi se sakrifica sublime e djalit, e bashkëshortit, e babait i përket tanimë kujtesës sonë kombëtare dhe i përket edhe vazhdimësisë së mesazhit të një jete të humbur në shërbim te atdheut, për të gjithë këta vogëlushë të cilët duhet t'i njohim me Klodianin, me faktin që ishte fëmija i një familje shumë të thjeshtë, i prindërve të zakonshëm dhe që e beri diferencën pikërisht duke qenë në lartësinë e detyrës ndaj atdheut.

Ndërsa kryebashkiaku Erion Veliaj, duke kujtuar figurën e Major Klodian Tanushit, Veliaj tha se heronjtë e sotëm janë ata që nderojnë kombin edhe pas vdekjes."Sot është një ditë e trishtë sepse kujtojmë shokun tonë, djalin tuaj që nuk është më, por një gjë është e sigurt: ky emër, kjo shkollë do të jetë këtu në jetë të jetëve. Para disa ditësh, Klodiani do të kishte mbushur 42 vjeç, fiks sa mosha ime sot, por na la një reputacion të jashtëzakonshëm, prandaj duhet të jeni krenarë. Sot kemi nevojë më shumë se kurdo për frymëzim..Sot kujtojmë një dëshmor, dje kujtuam një profesor. Kujtojmë njerëz që kanë dhënë kontribute, të cilët nuk thonë çfarë do të bëjë Shqipëria për mua, por unë çfarë do të bëj për Tiranën dhe Shqipërinë.", tha veliaj.

Jeta dhe vepra heroike e Klodian Tanushit u vlerësuan gjithashtu edhe nga ministrja e Arsimit, Evis Kushi, dhe nga deputeti i zonës, Xhemal Qefalia.Shkolla 'Klodian Tanushi' është një prej 12 shkollave të reja që është hapur ketë vit të ri shkollor në Tiranë, ndërsa ka një kapacitet për 600 nxënës.

KLODIAN TANUSHI NË PANTEONIN E VLERAVE TË KOMBIT

Nëse në kampin e NATO-s në Letoni është vendosur një memorial për Klodian Tanushin dhe Zarife Hasanajn, të cilët humbën jetën pas shpërthimit në bazën e NATOs në Letoni, vendosja e emrit të Klodianit shkollës së re moderne në Qesarakë që u përua dje në një atmosferë mjaftë festive, në zonën ku jeton familja e tij, duhet konsideruar e vlerësuar si një vendim historik i Këshillit Bashkiak të kryeqytetit.

Kjo, edhe për faktin se në librin e babait të tij gjen mesazhe vlerësuese të personaliteteve ndërkombëtare e vendase që e vendosin Klodianin në panteonin e vlerave të kombit. Mjafton të perifrazojmë qoftë dhe ministrin e Mbrojtjes të Letonisë, Artis Pabriks, se "Letonia është shumë mirënjohëse për aleatët tanë nga Shqipëria, për kontributin e tyre në praninë e zgjeruar të NATO-s në grupin e betejës". Nëse në Ditën Kombëtare të Dëshmorëve në Letoni përkujtohen dëshmorët më të rinj të Shqipërisë, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj, s'ka dyshim që në vendlindjen e tyre ata duhen përkujtuar më me madhështi. Ndaj dhe emërtimi i kësaj shkolle me emrin e Klodianit ishte vendimi i mirëpritur nga komuniteti.

Jeta e Klodianit, Zarifes dhe shumë të tjerëve që shërbyen dhe ranë heroikisht në misionet paqeruajtëse, flet për dinjitetin e gjakut që nuk bëhet ujë, për shembullin e krijuar që nga marrja e qumështit dhe këshillave të para të nënës e babait në djep, deri në përfshirjen në këtë familje të madhe të Forcave të Armatosura, e cila është e përkushtuar për të mbrojtur bashkësinë e madhe të njerëzve të këtij vendi dhe të Aleancës. Ata na tregojnë se paqja ka një çmim. Dhe siç shkruan Kamber Faruku në parathënien e këtij libri: "Lapidari përkujtimor i djalit flokëverdhë dibran, majorit të NATO-s, Klodian Tanushi, atje në Letoninë e largët, është një simbol i miqësisë mes popujve, që bën krenar jo vetëm familjen e Klodianit, nënë Lumen dhe babë Basriun, por çdo shqiptar.

Ai lapidar i heroit të NATO-s është në sintoni me trimërinë dhe humanizmin shekullor të popullit shqiptar, i cili është ndezur si qiri edhe për lirinë e të tjerëve. Mijëra njerëz, në shekuj, do të qëndrojnë të heshtur dhe kuriozë para asaj pllake përkujtimore, si në një vend të shenjtë. Do lexojnë aty, do pyesin, do mësojnë dhe do nderojnë këtë luftëtar të përjetshëm të paqes". Madje, sipas redaktorit Faruku, ky është filli i kuq, i cili përshkon këtë libër, të shkruar me ndjenjë prindërore nga i nderuari dhe i papërkuluri me një karakter burrëror, Basri Tanushi.

Major Klodian Tanushi humbi jetën më 10 maj 2019, pasi nuk mundi që t'i mbijetonte plagëve të marra si pasojë e shpërthimit të një mine gjatë misionit në Letoni.Major Tanushi u largua duke lënë pas gruan dhe tre fëmijët, më të voglin vetëm një vjeç.Në letoni humbi jetën edhe nëntetar Zarife Hasanaj.

Të dy ishin pjesë e kontingjentit shqiptar në kuadër të misionit të NATO "Wnhanced-ForwardPresence" në Letoni, për asgjësimin e municioneve eksplozive në Letoni. Zarife Hasanaj, humbi jetën menjëherë në vendngjarje me datë 6 maj 2019, ndërsa Klodian Tanushi u nda nga jeta disa ditë më vonë në spital, pa u rezistuar dot plagëve të marra nga shpërthimi i eksplozivit.

Major Klodian Tanushi, pas rënies heroike në krye të detyrës, me vendimin nr.786, datë 13.5.2019, të Komisionit të Posaçëm Qendror të Statusit "Dëshmor i Atdheut", u shpall "Dëshmor i Atdheut".Me urdhrin nr.706, datë 31.5.2019, të ministrit të Mbrojtjes, i jepet "Medalja e Nderit", ndërsa me urdhrin nr.554, datë 11.5.2019 të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i jepet medalja "Luftëtari". Më 10 maj 2021, Presidenti i Republikës, zoti Ilir Meta, me një ceremoni të posaçme solemne, dekoroi me "Dekorata e Artë e Shqiponjës" dëshmorin major Klodian Tanushi (pas vdekjes). Gjatë karrierës së tij ushtarake qe vlerësuar: Me Medaljen e "Karrierës" nga Komandanti i Forcës; Medaljen e "Shërbimit" nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm; – Medalje "Shërbimi në Mision jashtë vendi"; -Medaljen "Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare" nga Ministri i Mbrojtjes; – Medaljen e "Mbështetjes" nga Komandanti i Komandës Mbështetëse. Me vendimin nr.09, datë 23.12.2019, të Këshillit të Qarkut Dibër, Klodian Tanushi është shpallur "Qytetar Nderi i Qarkut Dibër".

Këtyre vlerësimeve të rëndësishme iu shtohet dhe një vlerësim tjetër me shumë vlerë. Para dy vitesh, një vlerësim e nderim të lartë i bëri djaloshit trim dibran, major Klodian Tanushit, edhe Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Dibrës, me kryetar z. Sokol Sava. Ky këshill, me vota unanime, me vendimin nr. 60, datë 10.4.2020, vendosi që rruga nga kryqëzimi i fundit i bulevardit me rrugën e Pollozhanit, deri tek ish-Shkolla Bujqësore (Karburanti) të emërtohet rruga "Klodian Tanushi". Kësisoj, major Klodian Tanushi, "Dëshmor i Atdheut", do të jetë përditë e për çdo kohë në mesin e banorëve të këtij qyteti, në kujtesën dhe shpirtin e tyre.

cyan magenta yelloë black

botime

Dhjetra personalitete të letrave dhe publicistikës në promovimin e librit të gazetarit shqiptaro-amerikan

Beqir Sina në "Një biografi për dy kohë"

Ngjarjet dhe faktet që Beqir Sina përshkruan në këtë libër dëshmojnë se komunizmi në Shqipëri ishte një diktaturë e rreptë, e paimagjinueshme dhe ne i dimë vuajtjet e të gjithëve, ndërkohë përcolli mesazhin se shumë pak njihen krimet e komunizmit, vuajtjet e shqiptarëve

Nga **Halil RAMA**

Njëzet e dy vjet më parë, gjatë vizitës sime në Nju Jork, i ftuar nga Federata Panshqiptare "Vatra", me bashkautor gazetarin dhe veprimtarin të saj shembullor Beqir Sina, do të shkruanim dhe botonim në të përditshmen më të madhe të diasporës shqiptare të asaj kohe "Bota Sot", editorialin "Sot flet historia, Geroge W.Bush apo Al Gore?!". Ishin zgjedhjet presidenciale amerikane të 7 nëntorit 2000, kur ne, pasi kishim vëzhguar fushatën e dy kandidatëve potencialë për kreun e Shtëpisë së Bardhë, edituam këtë ngjarje madhore historike në gazetën e përditshme që botohej njëherësh në Nju Jork dhe Zyrih, në mbi 80 mijë kopje.

Në të vërtetë, Beqir Sina kishte vite që bashkëpunonte me këtë gazetë, si dhe me Radio "Kontakt" e "RD", në Tiranë, ndërkohë që unë mbuloja politikën në këtë të fundit.

E solla në memorien time këtë ngjarje, pikërisht të enjten e 8 shtatorit 2022 kur Beqir Sina promovoi në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë librin e tij të parë "ROB – Një biografi për dy kohë", në praninë e dhjetëra personaliteve të publicistikës, historisë dhe letërsisë, nga Tirana dhe diaspora shqiptare.

Nëse para 22 vitesh pata fatin të konstatoja, jo vetëm praninë, por dhe kontributin e tij në selinë e Federatës "Vatra" që asokohe drejtohej nga personaliteti i shquar Agim Karagjozi (e cila për B.Sinën ishte si shtëpi e dytë), tashmë ai i dhuroi lexuesit një libër, të cilin Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi, e cilësoi si një kaleidoskop të kohës, duke theksuar se në të nuk gjejmë vetëm biografinë apo jetëshkrimin e autorit, por edhe një udhëtim që na përket të gjithëve. Kjo edhe për faktin se ky libër është biografia e njeriut që jetoi 33 vjet në ferrin e Savrës si i internuar politik i regjimit të diktaturës komuniste, dhe po aq në lirinë e Amerikës. Ndaj dhe që në hyrje të librit Beqir Sina shkruan: "Gjysma e parë e jetës sime iku baltërave dhe moçaleve. Kur erdhi dita që vuajtjet e mia mbaruan, unë kisha moshën e Jezusit.Natyrisht, nuk isha i rëndësishëm si Krishti, por ashtu si ai, kërkova dinjitet, drejtësi dhe liri për veten e familjen, ndërkohë që barabajtë e diktaturës dhe profetët e rremë bënin kërdinë në Shqipëri".Ky është pothuajse lajtmotivi i këtij libri të kompozuar mjeshtërisht në dy kapituj me nga përkatësisht gjashtë dhe shtatë pjesë.

Në pjesën e parë të kapitullit të parë "Familja ime e parë", vetë titujt e artikujve janë sintezë e biografisë së një familjeje nacionaliste me traditë të lashtë dhe me kontribut madhor patriotik në ngjarje e fakte dominante të historisë sonë kombëtare, por njëherazi edhe e genocidit të pashembullt komunist ndaj burrave e grave të saj. Mjaftojnë për këtë qoftë edhe titujt: "Komunistët vrasin gjyshin", "Kulla jonë në flakë", "Internimi i parë", "Arratisja e dy vëllezërve", "Pas shtatë internimeve" etj. Ndërsa në pjesët 2, 3 dhe 4 autori rrëfen me gjuhë të pasur ngjarje dhe fakte interesante që konsistojnë



në qenien e tij si bir i Dibrës dhe i Savrës' Savra – një histori dhe familja e tij e dytë. Në këto rrëfime brilante është gjyshi i tij nga babai Beqir Sina (i vjetër) me autoritet në krahinë, që pasi kishte kryer Akademinë e Rendit në Itali, gjatë kohës së Mbretit Zog I kreu detyra të rëndësishme si ishprefekt i Delvinës, prefekt i Lushnjës, komandant i Regjimentit të Fierit dhe në fund i Dibrës së Madhe. Por pikërisht si pasardhëse e tij, e gjithë familja në vitet e mëvonshme do të provonte barrën e rëndë të gjenocidit komunist. Ndaj dhe do të arratiseshin, fillimisht për në ish-Jugosllavi dy djemtë Feriti e Rushiti (të cilët atje i kapën dhe i pushkatuan) dhe më 1957 tre vëllezërit e tyre, Rasimi, Hashimi e Besimi që fatmirësisht mbërritën në SHBA ku ndërtuan jetën në vendin e demokracisë dhe lirisë së vërtetë. (Rasimi për dy dekada u bë zëri i diasporës shqiptare në SHBA si drejtues i një radioje për bashkatdhetarët, rrugëtim të cilin e përshkoi suksesshëm edhe i biri, Beqiri, autor i këtij libri).

Kalvari i djemve të kësaj familje përshkruhet me mjeshtri të rrallë në këtë libër nga autori Beqir Sina, në dhjetëra episode që pasi t'i kesh lexuar të mbeten në mendje, për të mos u shqitur nga memoria, ashtu si edhe veprimtaria dhe publicistika mjaft produktive e cilësore e tij në tri dekadat e fundit të jetës në SHBA. Pikërisht për këtë produkt, autori i parathënies së librit, gazetari dhe studiuesi i mirënjohur Ilir Ikonomi e vlerëson atë si një autobiografi të pazakontë. Kjo, sipas tij, për faktin se: "Me seriozitetin dhe analizën e një gazetari vëzhgues, Beqir Sina tregon për jetën e tij në internim në Shqipëri dhe për lirinë e gjetur në Amerikë. Këto dy pjesë të librit përbëjnë një kontrast të thellë, që ai na e sjell me dinjitet dhe me rrëfime interesante". Ikonomi vlerëson gjithashtu këtë tablo kontrasti midis robërisë dhe lirisë, e cila mban

Dr.Dorian Koçi – drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, përveçse cilësimit të këtij libri si kaleidoskop të kohës, vlerësoi kontributin e autorit si një veprimtar i "Vatrës" dhe bashkëpunëtor i gazetës "Dielli", por mbi të gjitha edhe për mbështetjen që u jep bashkëkombësve të tij. Librin e Beqir Sinës e vlerësun gjithashtu: Dr.Albert Rakipi- Drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare, gazetari dhe studiuesi i mirënjohur Ilir Ikonomi, aktivisti dhe biznesmeni Ekrem Bardha, etj

"Ky libër ashtë nji ngjarje me randësi për bashkësinë shqiptaro-amerikane dhe kontribut të çmueshëm për lexuesit shqiptarë kudo që jetojnë. Për lexuesit e huej, dedikimi pa kushte i shqiptarëve dhe veçanërisht i Diasporës në Amerikë mund të jetë nji revelacion.Libri pa dyshim ashtë nji konfirmim i dokumentuem i këtij dedikimi, nji dhuratë për breznitë e ardhme".

mesazhin se sa rëndësi ka që ne të luftojmë fort për ta ruajtur lirinë, edhe atëherë kur duket se ajo është e garantuar.

Nga ky libër mësojmë se si Beqir Sina që kishte lindur në internim në Savër të Lushnjës (nëna e tij Hanja, një grua me inteligjencë natyrore e fisnikëri të rrallë u internua pas arritjes së bashkëshortit, Rasimit më 1957 kur ishte shtatzënë me Beqirin barrë në bark) do ta njihte babain e tij për herë të parë në vitin 1991 kur ishte 33 vjeç. Mësojmë për kalvarin e tij gjatë 33 vjetëve të internimit, por edhe faktin se si gazetar, Beqiri ka takuar dhe fotografuar të gjithë presidentët amerikanë që nga viti 1992, ka fotografuar nga afër tre Papë, madje me njërin ka shtrënguar duart, ka takuar kongresmenë e senatorë, e ka treguar historinë e tij të vuajtjeve përpara shumë audiencave... Dhe nëse këto fakte i rendit në parathënie, gjatë promovimit të librit Z.Ikonomi kujtoi me emocion ngjarje të ndryshme që përcillen në libër, si dhe episode të ndryshme me autorin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.Ikonomi gjithashtu vlerësoi edhe veprimtarinë e gjerë të Beqir Sinës në Amerikë, miqësinë dhe bashkëpunimin e tij me personalitete të politikës amerikane.

Ndërsa moderatori i veprimtarisë promovuese, Dr.Dorian Koçi – drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, përveçse cilësimit të këtij libri si kaleidoskop të kohës, u ndal edhe në kontributin e autorit si një veprimtar i "Vatrës" dhe bashkëpunëtor i gazetës "Dielli", por mbi të gjitha edhe për mbështetjen që u jep bashkëkombësve të tij.

Si një nga më të mirët sa i përket përshkrimit të së kaluarës komuniste e vlerësoi librin e Beqir Sinës "ROB – Një biografi për dy kohë" (Botim i "Tirana Times"), edhe studiuesi Albert Rakipi – Drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare në Tiranë, duke e konsideruar njëkohësisht atë edhe si një homazh për të gjithë ata që u persekutuan gjatë diktaturës.

Vlerësim maksimal për këtë vepër dinjitoze, Beqir Sina mori edhe nga ambasadori Mal Berisha.Në fjalën e tij shprehu admirim për punën e shkëlqyer të Beqirit në këtë monografi, si dhe solli detaje nga njohja e tyre në SHBA.Berisha tha se edhe kjo monografi e shkruar artistikisht me detaje jetësore nga një njeri i letrave si Beqir Sina, e pasuron letërsinë tonë dokumentare dhe posaçërisht letërsinë e burgjeve.

Libri i Beqir Sinës u vlerësua edhe nga aktivisti dhe biznesmeni Ekrem Bardha, ish-i arratisur nga Shqipëria gjatë diktaturës komuniste. Ai tha se ngjarjet dhe faktet që Beqir Sina përshkruan në këtë libër dëshmojnë se komunizmi në Shqipëri ishte një diktaturë e rreptë, e paimagjinueshme dhe ne i dimë vuajtjet e të gjithëve, ndërkohë përcolli mesazhin se shumë pak njihen krimet e komunizmit, vuajtjet e shqiptarëve.. Ekrem Bardha, solli kujtimet e tij me babain e Beqirit, Rasim Sinën, para se të arratiseshin nga Shqipëria, si dhe jetën në SHBA si veprimtar shoqëror, si dhe persekutimin komunist të familjeve të tyre në Shqipëri.

Po në këtë linjë e vlerësoi librin e B.Sinës edhe bashkëvuajtësi i tij në vitet e internimit, Simon Miraka. Po ashtu, Ramazan Ndreu, bashkëvuajtës në kampin e Savrit, foli për familjen fisnike Sina, për jetën në persekutimin komunist dhe ma vonë në SHBA.

Si përfundim, për të konkluduar në vlerat shumëdimensionale të librit të Beqir Sinës "ROB – Një biografi për dy kohë", do të mjaftonin qoftë dhe perifrazimet e disa personaliteteve të shquara, të vendosura jo pa qëllim nga redaktori Ilirjan Agolli, në kopertinën e fundit të tij.

Kështu, nëse Eliot Engel, ish-anëtar i Kongresit amerikan që e ka takuar autorin Beqir Sina në shumë prej aktiviteteve të tij si kongresist, në Uashington dhe në Nju Jork, e vlerëson si një gazetar të palodhur për të thënë të vërtetën dhe shpreh bindjen që rrëfimi i tij në këtë libër do të pritet me shumë interesim dhe se historia e jetës së tij do t'i shërbejë edukimit të brezave të ardhshëm, Leka II, Princi i Kurorës e konsideron librin "Një rrugëtim pasionant, rrëfyer mjeshtërisht nga i talentuari Beqir Sina, nga internimi në Shqipëri deri në zbulimin e lirisë së shumëpritur në SHBA. Një çelës për të përjetuar të kaluarën dhe për të kuptuar të tashmen!".

Ndërsa Harry Bajraktari, aktivist dhe biznesmen, shprehet se është një libër që tregon të vërtetën, me fakte dhe hollësi interesante."Gazetari Sina vuajti në internim dhe Amerika i hapi një të ardhme të bukur, atij dhe familjes së tij.Është një libër që frymëzon.E falënderoj gazetarin Beqir Sina për sakrificën e tij dhe të familjes të tij.Me punën që ka bërë në vite si gazetar e ka pasuruar jetën e komunitetit shqiptar në SHBA", shkruan Harry Bajraktari.

Për studiuesin Sami Repishti, "Ky libër ashtë nji ngjarje me randësi për bashkësinë shqiptaro-amerikane dhe kontribut të çmueshëm për lexuesit shqiptarë kudo që jetojnë. Për lexuesit e huej, dedikimi pa kushte i shqiptarëve dhe veçanërisht i Diasporës në Amerikë mund të jetë nji revelacion.Libri pa dyshim ashtë nji konfirmim i dokumentuem i këtij dedikimi, nji dhuratë për breznitë e ardhme".

Rruga e Arbërit nr. 193-195

Autori i 10 librave nderohet me Çertifikata Mirënjohje nga Bashkia e Bulqizës dhe nga Shoqatat "Bulqiza" e "Jehona Shqiptare"

promovim

Nderi i Kombit Margarita Xhepa në promovimin e poezisë së Demir Rusit

Kryebashkiaku i Bulqizës, Lefter Alla, që falë drejtimit të saj me kompetencë, profesionalizëm e përkushtim qyetar, ka bërë dhe po bën aq shumë punë të mira në dobi të komunitetit, s'kishte se si të mos vlerësonte në këtë ditë të shënuar ikonën e teatrit dhe kinematografisë, "Nderin e Kombit" Margarita Xhepa, duke i dhuruar asaj simbolin e qytetit minator të Bulqizës

Nga **Halil RAMA**

Bulqiza, e njohur si qyteti i minatorëve për nëntokën e saj të pasur me mineralin e çmuar të kromit, ka dhe një pasuri tjetër mjaftë të çmuar: elitën e saj krijuese. Përfaqësuesit më në zë të kësaj elite u mblodhën të dielën e 2 tetorit 2022 në një nga resortet turistike vetëm disa kilometra poshtë qytetit, te "Pishat", në promovimin e dhjetë librave të Demir Rusit: një në prozë dhe nëntë me poezi. Risi e këtij eventi qe ardhja për herë të parë në Bulqizë e ikonës së teatrit dhe kinematografisë shqiptare Margarita Xhepa – Nderi i Kombit. E dashuruar me poezinë e poetit Demir Rusi, kjo margaritare e pashoqe do të shprehej e ngazëllyer me mikpritjen bulqizake, me natyrën e mrekullueshme joshëse në këtë ditë vjeshte me diell dhe mbi të gjitha me organizimin e përsosur të kësaj veprimtarie promovuese. Kësisoj, Demir Rusi erdhi si maja e kurorës së elitës krijuese bulqizake, pjesë e së cilës janë shkrimtari i mirënjohur Lutfi Hanku-autor i dhjetra romaneve e monografive, studiuesi e historiani Moisi Murra që la si testament "Historinë e Dibrës", Dr.Hajri Mandri –poet, studiues e dramaturg, poeti e studiuesi i mirënjohur Sakip Cami - autor i disa librave me poezi, monografi letrare e studime historike, Barie Çupi që vjen si prurja më cilësore në poezinë e sotme shqipe me një stil e produkt letrar të veçantë, Ymer Keta-poet e studiues, poeti Arben Alliu, studiuesi Bashkim Lami, Destan Rama e disa të tjerë.

Por, ai që i dha madhështinë e duhur kësaj feste të bukur poetike, padyshim qe mjeshtri i moderimit dhe i dokumentarit televiziv Defrim Methasani. Pesha e fjalës së tij artistike u evidentua, jo vetëm nga artistja e madhe e skenës dhe filmit Margarita Xhepa, por edhe nga disa poete e shkrimtarë e artiste të njohur, që kishin ardhur nga metropoli shqiptar për të nderuar mikun e tyre Demir Rusi.

LIBRAT E BOTUAR NGA DEMIR RUSI:

1. **Djali që bleu vdekjen;**
2. **Ura e fjalës;**
3. **Anja;**
4. **Mos ik të lutem;**
5. **Mos perëndo o dielli im;**
6. **Suzi;**
7. **Mikja;**
8. **Ditëlindje e përlotur;**
9. **Një grua po vuan;**
10. **Borxhi që s'ka të paguar.**

MIRËNJOHJE TË MERITUARA PËR POETIN

Qindra pjesëmarrësit që kishin mbushur sallën me arkitekturë moderne të këtij resorti provuan emocione të forta, jo vetëm nga interpretimi mjeshtëror i disa poezive të D.Rusit nga diva e skenës M.Xhepa, por edhe nga intepretimet me ndjenjë të poezive të këtij autori dhe fjalët e ngrohta përshëndetëse nga Kozeta Zavalani, Bujana Malaj, Nadire Karadaku, Dr.Dritan Korumi, Zamira Korançe, Barie Çupi, Artemida Arbri Nako, Perikli Shuli, Mjeshtri i Madh Muharrem Gjoka – President i Ansamblit Artistik "Hazis Ndreu"- Nderi i Kombit, Meri Mezini, Mimoza Shehu, Miranda Troci, Anila Kodra, Donika Gjura, Emrie Krosi, Zef Shtjefni etj.

Ndërsa kryebashkiaku i Bulqizës Lefter Alla do të fitonte respektin dhe admirimin e pjesëmarrësve, duke i dhënë Demir Rusit Çertifikatë Mirënjohje me motivacionin sinjifikativ: "Për veprimtari të shquar të spikatur në krijimtarinë e veprave letrare në poezi dhe në prozë."

Numri një i Bashkisë së Bulqizës që, falë drejtimit të saj me kompetencë, profesionalizëm e përkushtim qyetar ka bërë dhe po bën aq shumë punë të mira në dobi të komunitetit, s'kish se si të mos nderonte në këtë ditë të shënuar edhe Nderin e Kombit Margarita Xhepa, duke i dhuruar asaj simbolin e qytetit minator të Bulqizës.

Por autori i dhjetë librave Demir Rusi, do të vlerësohej në këtë ditë të shënuar të jetës së tij, me Çertifikata Mirënjohje edhe nga shoqatat "Bulqiza" e "Jehona Shqiptare" (me Presidente znj.Margarita Xhepa), përkatësisht nga kryetarët e tyre Bashkim Lami e Zamira Korançe.

Kësaj feste të bukur ia shtuan madhështinë dhe gjallërinë me interpretimet e tyre mjeshtërore këngëtarët Kristina Ndoji, Arben Sinoni e Hysni Hoxha, si dhe valltarët e vegjël shoqërues të këngëve, ndërkohë që atmosferën festive e ndezi dukshëm improvizimi i odës dibrane ku të gjithë sëbashku kënduan këngën "Na k'nojn pushkët nëpër kulla"...

DISA NGA VEÇORITË NË POEZINË E DEMIR RUSIT

Me nëntë vëllime me poezi dhe një libër në prozë, të botuara në harkun kohor të dhjetë viteve të fundit, Demir Rusi vjen para lexuesit si një poet i spikatur, që paraqitet me atributet e origjinalitetit të tij të patjetërsueshëm. Ai nuk është i ngjashëm me askënd, është plotësisht dhe thellësisht vetvetja. Këtë identitet ai e shfaq, jo në një e dy por në afro 1000 poezitë e përfshira në këto nëntë libra me tituj intrigues.

Kushdo që e lexon poezinë e D.Rusit do të konkludonte se ai është ndër të paktët poetë, i cili synon origjinalitetin dhe jo imitimin, konstrukton vetveten, për të mos qenë i ngjashëm. E kësisoj, si poet i dashurisë por edhe i dhimbjes njerëzore, ai jep edhe mesazhin e vazhdimësisë së jetës. Poezia e këtij autori është përçuese e përjetimeve njëçastëshme, por edhe e cilësive identifikuese të njerëzve që e rrethojnë apo edhe e atyre me të cilët i takon të polemizojë për ngjarje e problematika therëse.

Këto veçori në poezinë e tij janë evidentuar më së miri edhe nga kritika letrare.

Kështu, nëse Artemida Arbri Nako, administratore e "Botimet: Arte-Graphic", që ka botuar pesë librat e fundit të D.Rusit, në parathënien e vëllimit "Një grua po vuan" e vlerëson vargun e këtij poeti si galaktikë, ku me finesë shtrihen të gjitha ndijimet, përjetimet e gjendja shpirtërore në momente të caktuara, poetja e shumëtalentuar Barie Boba Çupi, evidenton natyrshmërinë e tij. Në parathënien e librit "Ditëlindja e përlotur" të D.Rusit, ndër të tjera Znj.Çupi shkruan se ky autor vjen natyrshëm si vëzhgues brengash dhe përjetimesh, pa lodruar në hapësira të largëta, nuk kërkon figuracion gjenial dhe aq më pak të tërhiqet nga ato. Ai është krejt origjinal në strukturën e ndërtimit të vargut me motive të ndryshme të llojit artistik, sarkaik, të thjeshtë gjithashtu".

Ndërsa Emrie Krosi në parathënien e librit të dhjetë "Borxhi që s'ka të paguar" të D.Rusit evidenton modelin poetiko-letrar të llojit liriko-saterik; një zhaner letrar, ku ironia dhe sarkazma janë topose të modernitetit në poezinë e sotme shqipe.

Në këtë veprimtari promovuese u konkludua se në nëntë librat e Demir Rusit ka poezi tradite në varg e motiv dhe ku motivet dhe temat zënë një vend në dukje dytësor por që të mbeten në mendje. Temat janë: Mëmëdheu, qyteti, liria, shpendet simbolikë, referimet e ndryshme të personazheve, vende që kanë një histori të caktuar, etj.

Ritmi në poezitë e tij lëviz për shkak të përdorimit të natyrave të ndryshme strofore. Poezitë e tij janë plotë metafora e krahasime befasuese.

BOTIMET M&B

mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283

Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose mund t'i porosisni online.

Posta brenda vendit është FALAS

Dëshironi të BOTONI PAK KOPJE LIBRI,
por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...
JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!
Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

botime

Gëzim LOKA: Kjo trashëgimi historike e Dheut është bërë pronë- e kujtesës kolektive të brezave luras dhe do të udhëtojë ende në shekuj e mijëvjeçarë, si një mesazhim vlerash që u krijuan në kohë të vështira për Lurën dhe që iu mbijetuan të gjitha kohëve.

"Kushtetuta e dheut të Lurës"

Nuk është e lehtë të shkruash për Kararet e Dheut dhe t'i shohësh në këndvështrimin tënd, kur rreth tyre ka pasur dhe ka ende orvajtje serioze të autorëve të njohur për të depërtuar në arealin e krijimit dhe funksionimit të tyre në kohë-hapësirën luriane.

Kjo trashëgimi historike e Dheut është bërë pronë- e kujtesës kolektive të brezave luras dhe do të udhëtojë ende në shekuj e mijëvjeçarë, si një mesazhim vlerash që u krijuan në kohë të vështira për Lurën dhe që iu mbijetuan të gjitha kohëve.

Ballafaqimi me të vërtetat e kësaj trashëgimie mbresëlënëse, të çojnë në shtigje të thepisura kohe dhe historie, ku hapësira etnike gjithëluriane shfaqet e vjen me vezullimin e largët të një komete. Faktet dhe detajet, edhe pse herë herë të mbuluara me pluhurin e kohës dhe jo rrallë me keqkuptime nga më të ndryshmet, janë kokëforta dhe tregojnë gjurmët e njërit prej përfaqësimeve më dinjitoze të së drejtës zakonore shqiptare, Karareve të Dheut Lurianë.

Dëshira për të shkruar një libër për kararet e Dheut Lurian, si një Kushtetutë harmonie dhe bekimi e të drejtës zakonore të një krahine të mençur e qëndrestare të pashoqe, është e vjetër sa vetë dëshira ime për të shkruar.

I vogël dëgjoja muhabetet në odat e burrave, ku piqej kafeja e fjalës"nënsëmutaf"zgjedhur dhe mesazhimet e Karareve të Dheut përcilleshin me aq mençuri dhe spontanitet nga burrat e fisëm lurianë, sa më dukej se përjetoja një mrekullim e fisnikërim shpirtëror të paskaj. Që këtu nisi udhëtimi im imagjinar drejt atij produkti cilësor të mendjes dhe shpirtit luras, duke bërë që të grumbulloja material e fakte, të kontaktoja me libra dhe shkrime të autorëve vendas e të huaj, që flisnin rreth kanuneve shqiptare e veçmas rreth Karareve të Dheut...

Por ndjenja në oda ishte për mua privilegji e nderi më i madh dhe këto kontakte të gjalla ishin mësimet e mia të para rreth asaj pasurie të paçmuar kolektive që fillohej në këto oda, që mbeten universitete të papërsëritshme, kryedije e dijeve të mia.

Puna përgatitore dhe ajo shkrimore e këtij libri më ka bërë me dije shumë autorë shqiptarë e të huaj, veçanërisht të huaj, që flasin me admirim për Lurën dhe për Kararet e Dheut, të cilat i shohin si një rezistencë e fortë e kësaj krahine për të ruajtur paqen dhe unitetin krahinor, fisnor e gjithëfetar, për ta bërë të drejtën një pronësi demokratike dhe lehtësisht të verifikueshme e kryesisht të zbatue shme për të gjithë bashkëkrahinorët lurianë.

Kararet e Dheut kanë ardhur në formën fillestare që në fillimin e ngulmimit të Lurës, por me kohë, kohë pas kohe, janë "lëmuar" e "pastruar", janë situr imët në sitën e mençurisë krahinore dhe janë pasuruar e përsosur, derisa kanë marrë atë trajtë përfundimtare dhe atë përmbajtje aq të veçantë ligjore, duke u bërë një Kushtetutë e Dheut Lurian.

Kararet kanë marrë parimet esenciale të së drejtës zakonore si nga Kanuni i Lekës ashtu dhe nga ai i Skënderbeut, por pas Kuvendit të Dheut, ku mori pjesë vetë Skënderbeu dhe pati përplasje të forta me Lekë Dukagjinin, për shkak se Kryeprijësi, ndryshe nga Leka, donte ta orientonte kanunin drejt bashkimit dhe faljes, Dheu ka anuar nga Kanuni i Skënderbeut, por kararet i janë nënshtruar një procesi selektiv dhe pasurues esencial. Në thelb, që në lashtësi, "kararet" janë shfaqur si modele të vetëqeverisjes së "Dheut".

Kararet kanë lindur dhe janë zhvilluar në Lurë, në një mal e krahinë më vete, që ka pasur kontakte me dy kanunet më emblematikë në veriun shqiptar dhe krejt botën shqiptare, Kanunin e Lekë Dukagjnit dhe Kanunin e Skënderbeut.

Kararet kanë marrë esencën e këtyre kanuneve, por duke i zhveshur ata nga çdo agresivitet dhe posedim të gjakmarrjes, duke e cilësuar këtë të fundit si "një të keqe që e kishte zënë" lurasin e etur për paqe dhe drejtësi dhe jo si një retorikë egërsie dhe shfrim të pasioneve të errëta kriminale, siç ndo dhte jo rrallë dhe siç ndodh dhe sot në disa kra hina, ku në emër të kanunit bëhen krime nga më të përçudnuarat, deri tek vrasje grashë e fëmijësh për hakmarrje e gjakmarrje, gjë që e përjashtojnë kategorikisht të gjitha kanunet shqiptare.

Kararet e Dheut kanë lindur nga përvoja e gjatë jetësore e brezave, janë situr hollë e gjatë në bisedat kokë më kokë të burrave, duke ndërruar "një cigare duhan" me njëritjetrin, janë përpunuar e perfeksionuar në odat luriane, në ndenje gëzimi e hidhërimi, janë shtruar për diskutim në Kuvendin e Dheut ku kanë marrë formë përfundimtare si ligje të pashkruara të Dheut.

Kararet nuk janë tjetër veçse ligje të pashkruara, të krijuara dhe të përsosura kohë pas kohe, gjersa kanë marrë formë përfundimtare ligjore, si kode të vetëqeverisjes luriane, si modele të së drejtës, si pasuri e madhe e kodifikuar e të drejtës zakonore të Dheut Lurianë.

Duke qenë trashëgimi e shpirtit kolektiv lurianë, ata shprehin botëkuptimin dhe psikologjinë e brezave të një krahine me tradita të lashta e të pasuruara në çdo kohë të vetëqeverisjes. Thënë ndryshe, ata janë një kushtetutë e pashkruar mbi të cilën është ngritur gjithë sistemi juridik, ligjet dhe aktet ligjore e nënligjore si dhe praktikat e vetëqeverisjes së kësaj krahine në gjirin e maleve tona. Pra, kararet e dheut janë akte e nënakte ligjore, të cilat shprehin dhe përfaqësojnë vullnetin e masës së gjerë të popullit, për probleme të caktuara të jetës, kryesisht me karakter shoqëror, politik, ekonomik, moral etj.

Siç do të shohim hollësisht e në mënyrë të detajuar në faqet e këtij libri, kararet ekzistonin si forma kanunore embrionale që në kohët më të hershme, në agun e qytetërimit lurian, por ata u fuqizuan dhe morën frymë ligjore në trajtën e ligjeve dhe nënligjeve të pashkruara në kohën e Skënderbeut, ku nevoja për kufizimin e keqbërjes e në këtë kuadër edhe të gjakmarrjes ishte urgjente, që të mund t'i bëhej ballë me qëndresë e unitet gjithëkrahinor zulmës pushtuese dhe frenetike të Perandorisë së Gjysmëhënës së Anadollit.

Rëndësia e Karareve të Dheut mund të dalë në pah e të kuptohet më mirë nga brezat e sotëm luras, nëse kemi parasysh regjimin shoqëror që sundonte në krahinën e Lurës dhe në gjithë shtrirjen e Malësive të veriut e të gjithë shqiptarisë në kohën e Kastriotëve në shek. XV, ku kanunet dhe kararet shprehën nevojën e ngutshme të popullatës së këtyre trevave për organizmin e luftës çlirimtare skënderbegiane dhe administrimin e paqes në pjesën e papërfshirë në luftë të popullsisë civile.



Nuk është rastësi që Skënderbeu e thirri Kuvendin e Dheut në Lurë, ku format kanunore kishin nisur të aplikoheshin në formën e kararеve dhe ç`është e vërteta, normat kanunore apo pleqërimet e mirëfillta të Gjergj Kastriotit, siç ka vërejtur edhe K. Frashëri, kanë shënuar një hap përpara në krahasim me parimet e lashta të së drejtës së pashkruar, që sundonin akoma në shek e XV. Me zbatimin e tyre, organizimi shoqëror i malësorëve i shërbeu më mirë se me normat e mëparshme, luftës antiosmane. Karakteri i tyre progresiv dhe shaarmi qëndrestar I pavdekshëm i Gjergj Kastriotit Skënderbeut janë dy arsye të forta që shpjegojnë përse emri i tij iu vesh mbarë së drejtës kanunore që sundonte në Lurë e Dibër dhe në krahina të tjera të Arbërisë.

Duke shkruar hollësisht e gjerësisht për kararet e Lurës, dua të përcjell edhe një herë në këtë libër modest admirimin tim për vendin e rrënjëve dhe degëve, respektin deri në përulje për atë trashëgimi të shkëlqyer të së drejtës zakonore që paraardhësit na lanë dhe që ne duhet ta ruajmë e t'ua lëmë të pastër dhe të ndriçuar brezave lurianë që do të vijnë.

NJOFTIM PËR SHOQATA DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre.

Kostot e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit të gazetës.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603** ose shkruani emailit: **rrugaearberit@gmail.com**

KËRKOHET GAZETAR/E

Kërkohen një gazetar/e me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.

Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Rruga e Arbërit nr. 193-195

histori

ME RASTIN E 80-VJETORIT TË FORMIMIT TË SAJ, 26 SHTATOR 1942

Çeta e Martaneshit

Nga **ZABIT LLESHI**

Martaneshi është një krahinë malore që shtrihet në grumbullin malor qendror midis Dibrës, Matit, Tiranës dhe Elbasanit e njohur për veprimtari patriotike brez pas brezi kundër Perandorisë Osmane dhe ushtrisë së saj deri në shpalljen e pavarësisë. Të njohur janë martaneshasit për heroizmin kundër Mahmut Pashës, Hurshit Pashës, Avdi Pashës e Dërgut Pashës për mbrojtjen e tokës amtare, bashkë me luftën për mbrojtjen e pavarësisë nga pushtuesit serbë, austrohungarezë, italianë e gjermanë. Për të fituar lirinë dhe pavarësinë e popullit të Martaneshit iu desh të sakrifikojë shumë jetë njerëzore, shkatërrim, grabitje e plaçkitje të pasurisë vendosur me shekuj me mund dhe djersë. Megjithatë armiqtë kurrë nuk e mposhtën patriotizmin, shpirtin luftarake e atdhedashës të malësorëve trima të trevës së Martaneshit.

Pushka e Martaneshit u dëgjua në Shkodër, Janinë e Follorinë, në Elbasan e Dibër, në Tiranë, Shkup e Prishtinë. Kur shtrohej problemi i trojeve shqiptare në rrezik, vullnetarët trima të Martaneshit ishin aty ku derdhej gjaku, ku bashkoheshin zemrat me heronjtë dhe dëshmorët e kombit.

Si kudo në vendin tonë pushtimi i Italisë fashiste më 7 prill 1939 u prit me shqetësim të madh edhe në Martanesh. Në fshatin Peshk, në Belik u mblodh kuvendi i burrave për të analizuar situatën lidhur me lajmet që ishin përhapur për vendimin që kishte marrë Italia Fashiste për pushtimin e Shqipërisë dhe zbarkimin e trupave të saj në Durrës. Kërkuan armë pranë postës së xhandarmërisë, nuk ja dhanë, vendosën të vetë organizoheshin dhe të shkonin në front. Më 7 prill u grumbulluan vullnetarët e parë, ndërkohë morën njoftimin se Italia hyri në Durrës, ushtria e saj ishte nisur drejt Tiranës. Malësorët vullnetarë pa armë, koha nuk premtonte të arrinin në Tiranë para trupave italiane.

Me dëshpërim u detyruan të ktheheshin në shtëpi, ishin tradhtuar nga qeveria që kishte braktisur popullin e Atdheun bashkë me mbretin.

Vendosja e regjimit fashist u shoqërua me rritjen e taksave për popullsinë fshatare, kështu me tagamledhësit filluan konfliktet.

Lindën tensionet e para të popullit me milicët, që do të vazhdonin me kundërshtimet, përplasjet e protestat ndaj urdhëresave për çarmatosjen e popullatës (dorëzimin e armëve). Arma ishte e shenjtë për malësorin, ishte gjetur e siguruar me sakrifica, ato ishin të vjetra, trofe të fituara në beteja, të ndryshme me ushtritë armike. Gjatë gjithë historisë as fuqitë e ushtritë e mëdha nuk kishin mundur t'i çarmatosin shqiptarët. Martaneshasit nuk hynë në shërbim, as pranuan të visheshin milicë, as të futeshin në radhët e Partisë Fashiste. Baba Faja i frymëzonte malësorët të kundërshtonin pushtimin e Italisë fashiste dhe qeverinë profashiste të Shefqet Vërlacit. Ai nuk i braktisi besimtarët, por u bashkua dhe u vu në krye të malësorëve duke qëndrua konsekuent idaleve patriotike për lirinë dhe pavarësinë e atdheut1. Në qershor 1940 Prefekti i Dibrës e ftoi Baba Fajën në Peshkopi. U takua gjithashtu me kryetarin e Bashkisë, oficerin Federal dhe inspektorin Rafaele Brenda. I bënë thirrje të përkrahte fashizmin, të vendosnin qetësinë në Martanesh, të respektonin normat dhe ligjet italiane, por nuk e gjetën gadishmërinë e Baba Fajës.

Ai doli dhe foli hapur kundër masave që kish marrë qeveria fashiste për forcimin e regjimit fashist në Shqipëri.

Më 31 korrik 1940 gjenerali (Agostinuçi) takoi në Tiranë Baba Fajën, i kërkoi mbështetje Teqes së Martaneshit e Bektashizmit për realizimin e programit fashist. Mbas dy javësh i çuan vendimin e autoriteteve fashiste "Të qëndrojë në banim të detyruar në mjediset e Kryegjyshatës pa të drejtë takimi me publikun deri në një urdhër të dytë"2. Malësorët protestuan kundër këtij vendimi dhe kërkuan me forcë kthimin e Baba Fajës në Martanesh për t'u shërbyer besimtarëve. Në krye të protestave qëndronin Sali Fejza, Bajram Quka, Rexhep Koxheri, Jonuz Isaku, Lam Cani, Beshir Bala, Qazim Alia, Hasan Grrica, Halil Alhasa, Jashar Muça etj.

Në korrik-gusht 1940 Italia fashiste mori me forcë disa të rinj ushtarë dhe i çoi në frontin grek. Ata si patriotë jo vetëm nuk luftuan kundër popullit grek, por dezertuan, lanë frontin duke sabotuar luftën për të afruar humbjen e ushtrisë italiane në Greqi. Siç ishin: Nasebi Rama, Hajdar Mali, Ibrahim Peshku, Abdyl e Avdi Bala, Jonuz Saliu, Destan Saliu, Tahir Koxheri, Hysen Alhasa, Hysen Çuka, Lam Bami, Xhafer Gaçi, Mehmet Cakoni, Ali Kurti etj., pas kthimit ng Greqia do të bëheshin propagandistët e zjarrtë të luftës së organizuar kundër pushtimit fashist në trevën e Martaneshit.

Milicët dhe karabinierët në Martanesh herë pas here tensiononin situatën për shkak të kontrolleve në shtëpi e familjeve të djemve që nuk kishin shkuar ushtarë në frontin grek, të të dezertuarëve, të cilët ishin larguar nga fshati dhe strehoheshin në pyje, në teqe etj. Kontaktet e Baba Fajës në Tiranë me Mustafa Gjinishin, Sami Bahollin e Qemal Stafën në Elbasan në nëntor-dhjetor 1941 siç tregon Baba Faja në kujtimet e tij lanë mbresa të thella, forcuan bindjet për luftën pa kompromis kundër pushtuesve italianë e tradhtarëve të vendit si bashkëpunëtorë të tyre.

Në Elabasan m'u krijua rasti të takohem me Sami Bahollin dhe herë pas here me QEmal Stafën, të cilët më furnizuan me lëndë propagande me broshura revolucionare, me komunikata, me trakte dhe të tjera materiale. I mora me vete dhe i shpërndava në Martanesh3.

Në mars 1942 Sami Baholli me pretekstin për të festuar ditën e verës erdhi disa ditë në teqen e Martaneshit. Bashkë me Baba Fajën organizuan një takim me njerëzit më të besuar të teqes siç ishin Nasebi Rama, Hasan Grrica, Ibrahim Rama, Bajram Gjoni, Beshir Bala, Qazim Alia, Halil Alhasa, Dervish Rrushi, Rrem Rama etj. "Ju jeni njerëzit më të besuar, më patriotë e më të vendosur për luftë kundër fashizmit. Martaneshi është zonë e thellë malore e strategjike. Forcat italiane duhet me i sulmue, por edhe me qenë në gadishmëri për të kryer aksione jashtë Martaneshit. Dalë nga dalë do të krijojmë edhe çetën si ajo e Myslym Pezës, tha Sami Baholli. Ky ishte njësiti i vogël partizan që përbënte dhe bërthamën e çetës së ardhshme të Martaneshit. Ky njësit me 20 mars do të organizonte aksionin e parë kundër forcave italiane në rrugën Elbasan-Bizë. Dy triçikla me ushtarë italianë kontrollonin çdo ditë rrugën, çonin njëkohësisht postën ushtarake. Në Linos dhe Kroi i kuq ishin dy grupe teknikësh italianë që ndiqnin punimet në rrugën Tiranë-Bizë.

Tek kthesa e Gurit të Zi u bë prita. Grupi u nda në dy pjesë. Sapo triçiklët i futën në kthesë u hap zjarr ndaj tyre. Njësiti udhëhiqej nga Nasebi Rama. Ushtarët dorëzuan armët dhe u liruan si robër.

Më 7 prill 1942 aksioni tek Kroi i Kuq Shëngjergj me objektiv djegia e depos së materialeve dhe kapanoni i ushtarëve italianë. Njësiti në mesin e natës së 7 prillit zbriti pranë kaparonit. Dervish Rrushi e Hajdar Mali izoluan rojën dhe i vunë zjarrin Kapanonit ku morën zjarr edhe dy depot. Njësiti u largua për Ballenjë të Vogël pa dëmtime. Italianët u alarmuan, kërkuan roje të përforcuara për vazhdimin e punimeve.

Baba Faja punoi me këshillin e Teqes, organizoi takime me kryetarë fisesh, me persona e njerëz me influencë, tashmë për ta zgjeruar lëvizjen antifashiste në mbarë Martaneshin4.

Në prill 1942 në kthim nga Peza, Haxhi Lleshi vjen në Martanesh. Gjatë gjithë muajit maj Teqja e Martaneshit u bë strehë e ilegalëve si Mustafa Kaçaçi, Haki Fejza, Hasan Bajraktari, Petrit Hakani, Qamil Guranjaku, Sofokli Buda, Tomor Sinani, Ramadan Çitaku, Kadri Hoxha etj. Me Baba Fajën u diskuan shumë probleme, më e ngutshme ishte krijimi i çetës partizane. Baba Faja i bëri thirrje popullit nga një pushkë për shtëpi të mblidheshin për luftë kundër pushtuesit dhe tradhtarëve të vendit, përjashtoheshin familjet që kishin një djalë. Lëvizjet vajtje-ardhje, përpjekjet për organizim të luftëtarëve antifashistë nuk kaluan pa u vënë re nga autoritetet fashiste në Martanesh. Për këtë thirret në Kuesturën e Tiranës Baba Faja për të shpjeguar: A mban armë Teqja e Martaneshit? A vjen Myslym Peza e Haxhi Lleshi? Po partizanë të tjerë? Përgjigjet mohuese dhe mungesa e provave e liruan Baba Fajën.

Në qershor vjen në Martanesh Vasil Shanto, i cili solli mjaft komunikata e trakte një radio me bateri, rikthehet Ramadan Çitaku tashmë me Miladin Popoviçin. Çdo ditë në Teqen e Martaneshit vinin miq, patriotë, komunistë, nacionalistë, partizanë, ilagalë e besimtarë. Filloi një aktivitet i gjerë propagandistik, njerëzve u bëhej thirrje hapur për luftë ndaj robërisë fashiste. Filluan aksionet e mëdha siç ishin ato të prerjes së linjave telefonike me 24 korrik 1942 ku njësiti i Martaneshit preu linjën Martanesh-Librazhd, LInos-Tiranë, Librazhd-Elbasan, Martanesh-Klos, Martanesh-Bulqizë, që trondit themelet e pushtetit fashist dhe e paralizoi plotësisht atë.

Më 3 gusht aksioni në qafën e Tjegullave, pritë 3 kamionëve me ushtarë italianë. Dy makina u dogjën pas 2 orë shkëmbim zjarri, u vranë 2 ushtarë italianë, u siguruan dhe morën shumë armë, disa granata dore, batanije, 2 arka makarona, oriz, fasule dhe 1 arkë me konserva mishi.

16 shtator 1942 aksioni i Dhoksit, Qazim Alia dhe Ferit Myrtezai organizuan sulmin ndaj kantierit të punëtorëve italianë (shoqëria italiane e minierave) Dhoks. Punëtorët i larguan nga kantieri. Morën 10 armë, 20 batanie, 20 kg dinamit, 100 kodonatorë, 100 m fitil dinamiti etj.

20 shtator, aksioni në Labinot-Fushë kundër një autoblinde tek Rrapat e Labinotit, por shpëtoi pa dëmtime, megjithatë pati jehonë në popull. Ishte një sinjal i fortë se populli po ngrihej, i përkrahte forcat partizane kudo, jo vetëm në Malësi, por edhe në fushë e afër qendrave të banuara.

Konferenca e Pezës, zgjedhja e Baba Fajës si anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar shtroi detyra të reja edhe për Martaneshin. Më 26 shtator 1942 ndonëse shumë martaneshas ishin bashkuar me lëvizjen, njësiti ishte rritur, u zyrtarizua çeta partizane e Martaneshit me komandant Baba Fajën dhe Komisar Ramadan Çitakun.

Nisi puna për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare dhe shtimin e radhëve të çetës. Martaneshi u bë një shqetësim i madh për regjimin fashist prandaj duhej sulmuar. Gjeneral Zannini, komandant i forcave për sigurimin publik të Mbretërisë, mobilizoi 400 karabinierë e milicë shqiptarë për të asgjësuar çetën e Martaneshit me mendimin se në Martanesh mund të strehohej dhe Myslym Peza me çetën e tij. Operacioni kishte për qëllim të rrethonte Martaneshin. Një kompani me milicë do të vinte nga Burreli, dy kompani nga Tirana do vinin nga Shëngjini. Me avionë do bëhej rikonicioni i terrenit, do të bombardoheshin pozicionet e partizanëve dhe Teqet. Të viheshin në gadishmëri stacionet e Karabinierëve dhe milicisë fashiste në Klos, Bulqizë, Zerqan, Lunik, Shëngjergj, Qafë Murriz, për bllokimin e shtigjeve nga ku mund të dilnin nga rrethimi forcat partizane. Baba Faja duke vlerësuar situatën vendosi të tërhiqej në Ballenjë, në pyjet e Kaptinës mbasi nuk mund të përballohej kjo fuqi e madhe ushtarake.

Në Teqe la pak njerëz. Më 5 tetor 1942 forcat fashiste kontrolluan Teqen dhe arrestuan gjithë personelin dhe i çuan në kuesturën e Tiranës. Operacioni dështoi, Baba Fajën nuk mundën ta arrestonin. Ai kaloi në ilegalitet të plotë. Gjatë muajve tetor-dhjetor Baba Faja bashkë me çetën organizuan punën për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare dhe shtimin e rradhëve të çetës. U shquan si veprimtarë të Këshillave Nacionalçlirimtare, në Val, Sali Fejza, në Peshk, Ali Lena, Sul Gjoni, në Gjon, Kamber Haslika, Staf Koxheri, në Lenë, Rrem Rrushi, Rremë Gjyla, në Kostenjë, Jashar Muça, Nezhdë Feta Alceni etj.

14 tetor 1942 aksioni Labinot-Fushë

Çeta e Martaneshit bashkë me çetën e Matit dhe Çermenikës në Labinot Fushë në rrugën Elbasan-Librazhd kishte lëvizje të mëdha me autokolona ushtarake. Me të hyrë në rrezen e pritës u sulmua autokolona me 5 makina, 2 makina u dogjën, plagosën disa ushtarë, çeta u tërhoq në Labinot Mal pa humbje. Milicia më 30 tetor i vuri zjarrin Teqes së Ballenjës.

31 tetor aksioni tek tre urat në Librazhd

Nën komandën e Kadri Hoxhës e Nasebi Ramës, 3 çetat (Martanesh, Mat, Çermenikë), zunë pritën tek 3 urat. U dogjën 3 makina, u arrestuan oficeri dhe 12 ushtarë, dy arka me municione, disa pushkë e ushqime.

16 nëntor aksioni tek ura e Murrashit

Në rrugën automobilistike Elbasan-Librazhd. Pas asgjësimit të rojeve partizanët sulmuan për 3 orë rresht kazermën. U vra një nënoficer dhe një ushtar, tetë italianë u dorëzuan, të tjerët u larguan luginës së Shkumbinit.

Në këtë aksion u sigurua një mitraloz, 28 pushkë, 60 bomba dore, 4 arka municionesh, 40 batanie. Në tërheqje shkatërruan linjën telefonike Elbasan-Librazhd.

Çeta e Martaneshint më 27 nëntor 1942 i erdhi në ndihmë çetës së Dibrës në rrugën Dibër-Strugë.

Më 16 dhjetor 1942 kjo çetë sulmoi postën e milicisë në qendër të Martaneshit i bënë

kujtese

(Me rastin e 80-vjetorit të vrasjes së heroit të popullit "Nazmi Rushiti"

thirrje komandës që të dorëzoheshin. Milicët u larguan natën dhe në fshehtësi, Martaneshi u gdhi pa milicë dhe asnjë këmbë ushtari të huaj. 17 dhjetor 1942 u festua si ditë e çlirimit të Martaneshit. Tani shtroheshin detyra për organizimin e pushtetit në zonën e çliruar. Më 23 dhjetor u zgjodh këshilli krahinor Nacionalçlirimtar me kryetar Sali Fejza dhe sekretar Bajram Muça.

Në çetë numëroheshin 55 partizanë. Në të gjitha fshatrat ishin dhjetëra veprimtarë që ishin gati të bashkoheshin me çetën rast nevoje.

Regjimi fashist nuk mund të pajtohej me gjendjen në Martanesh, prandaj më 20 shkurt 1943, 3000 forca të Divizionit Firence; sulmuan me avionë, u bombarduan Teqja dhe fshatrat, u vra Xhide Sallaku, arrestuan 60 burra në Staveç e Gjon, dogjën 20 shtëpi në Lenë, shumë të tjera u bastisën, pushkatuan Ramazan Alhasa, Demir Alhasa, Rrahman e Muharrem Alhasa, Riza Kenga me bashkëshorten Mereme dhe nënën e tij Farie Kënga. Teqja e Poshtme e Martaneshit u dogj plotësisht.

Flaka e Teqes së Martaneshit ishte pishtari i luftës Nacionalçlirimtare që ndezi akoma më shumë urrejtjen e popullit shqiptar kundër pushtuesve, shkruante buletini i "Zërit të Popullit", më 23 shkurt 1943.

Më 16 prill 1943 aksioni i Xibrakës në rrugën Elbasan-Librazhd. 3 makina u dëmtuan u plagosën 5 ushtarë italianë, një shaptilograf dhe disa pako letër ranë në duart e partizanëve. Tradhtarët dhe bashkëpunëtorët e pushtuesve megjithëse të pakët edhe në Martanesh bënë përpjekje për të sabotuar luftën Nacionalçlirimtare. Ata nxitën gjakmarrjet e vjetra, pakënaqësitë, ish kryepleqtë bënë përpjekje për të sabotuar luftën. Haxhi Llani zv/komandanti i çetës së Mataneshit ishte një nga dëshmorët që u sakrifikua nga reaksioni vendas në bashkëpunim me pushtuesit e huaj. Veprimtaria armiqësore e tyre u frenua nga vrulli dhe shpejtësia më të cilin u rrit lëvizja Nacionalçlirimtare. Vetë fshatarët demaskuan parinë dhe pasuesit e tyre. Baba Faja me autoritetin e respektin e madh që kishte në popull dha një kontribut të pazëvendësueshem.

Në shkurt 1943 në çetë erdhi komisioni i ri Llambi Dishnica. Krijua celula e Partisë me anëtarët e saj Avram Koja (Zv.komisar) Nasebi Rama, Qazim Alia, Jashar Muça e Hasan Bajraktari. Komisari ishte edhe sekretar i celulës së Partisë. Çeta u rrit me partizanë të rinj midis tyre edhe gra si Farie Shehu (qysh në ditët e para) Zenepe Goxheri, Fatime Ndreu, Zyhra Lena bashkë me Hanife Balën, Fatime Canin, Mine Peshku, Sajme Mali, Tane Ndreu, Hatije Peshku, Sajme Peshku, Tane Biçaku, që i dhanë një ndihmë të madhe lëvizjes Nacionalçlirimtare në Martanesh.

Aksioni kundër postës së xhandarmërisë Lunik-Librazhd. Kuestori i Prefekturës së Elbasanit në një njoftim për Drejtorinë e Policisë mbretnore nënvizon. Në orën 3.00 të datës 1 të këtij muaji (qershor) afro 80 vetë të armatosur të bandës komuniste të Babait të Martaneshit rrëzuan kazermën e e xhandarmërisë në Lunik. Partizanët morën të gjitha armët, municionet dhe materialet e tjera dhe u larguan drejt Orenjës për në Ballenjë (morën pjesë çeta e Martaneshit, Grykës së Madhe dhe Çermenikës).

Dëshmorë të çetës së Martaneshit janë Hasan Islami, Rihana Kenga, Rihana Kaca, Demir Alhasa, Shaban Kenga, Riza Kenga, Ramazan Alhasa, Muharrem Alhasa, Merjeme Hysa, Hysen Koxheri, Rexhep Kenga, Hajdar Mali, Rustem Hasa, Hike Sallaku, Myslym Grica, Zenel Koçi, Ramiz Fejza, Mahmut Lena bashkë me Ramazan Isakun, Naim Gjonin që u vranë pas çlirimit, por ndihmuan si fëmijë në vitet e luftës.

1. Alia, Lutfi, iranë 2018, f. 154
2. AIH. Epopeja e Luftës Nacionalçlirimtare, Tiranë 1980, f. 162.
3. Alia, Qazim, "Historia e Luftës Nacionalçlirimtare Martanesh", Kujtime, 1970.
4. Alia, Qazim "Kujtime, Historiku i Martaneshit", 1970.

Nuk e dua lirinë duke hedhur poshtë bindjet e mia

Nazmi Rushiti. Celula vendosi të formohet çeta e I partizane e Dibrës me 20 partizanë të pranishëm. Ajo zgjodhi komandant Haxhi Lleshin. Vullnetarët antifashistë të rinj vinin çdo ditë në çetë prandaj filluan menjëherë aksionet në vende strategjike e larg vendeve të banuara për të ruajtur luftëtarët, por edhe popullsinë e fshatrave nga ndeshjet me pushtuesit fashistë.

Aksioni i parë i çetës ishte tek "Gurët e Skënderbeut" afër qytetit të Bulqizës. Këtu kishte luftuar Skënderbeu 500 vjetë më parë kundër ushtrisë osmane. Sapo një kamion i Postës ushtarake që vinte nga Tirana u fut në pritë, çeta hapi zjarr. U vranë 3 ushtarë, u plagosën disa të tjerë. Atë ditë përveç postës, makina kishte gazetën Tomori, e cila ishte shpuar nga plumbat e armëve të partizanëve, kjo i detyroi fashistët të ndalonin shpërndarjen e gazetës.

Aksioni i prerjes së linjave telefonike me 24 korrik 1942. Administrata dhe garnizonet ushtarake u vunë në alarm, mbeten pa ndërlidhje të Dibër të Madhe Peshkopi, Gostivar, Zerqan, Burrel me Tiranën. Pranë çetës vërshuan dhjetëra e dhjetëra partizanë lufta çlirimtare rritej çdo ditë e më shumë.

Më 16 shtator në mbështetje të konferencës së Pezës, vetë Nazmiu udhëhoqi aksionin në minierën e Bulqizës. Nazmi Rushiti, Demir Gashi së bashku me 3 shokë nga Gryka e Madhe hartuan planin në shtëpinë e patriotit Cen Puca, për vrasjen e Stavri Jahos kapitenit fashist në Zerqan. Stavri Jaho ishte organizator i masakrave të popullsisë së pafajshme të Pezës, torturave në burgun e Tiranës, vetë Nazmiu ishte viktimë e këtij e xhelati. Në Dibër kishte ardhur si dorë e fortë "për të shkulë nga rrënjët lëvizjen antifashiste Nacionalçlirimtare. Këtë atentat e mori përsipër vetë Nazmiu me Demirin, Sul Hasanin, Veli Zogun e Mustafa Shehun. Me gjakftohtësi Nazmiu e kryeu misionin me sukses; Në tërheqje e sipër kapërcen një mur të lartë, u rrëzua dhe ra pa ndjenja. Fashistët e kapën, rezistenca dhe trimëria e tij i habitën dhe hutuan armiqtë. Një ditë më vonë e dërguan në burgun e Peshkopisë në një autoblind të shoqëruar nga dhjetra xhandarë. Trupi i të riut antifashist provoi torturat më të rënda; ai dha jetën, fjalët e fundit ishin Rroftë Lufta Nacionalçlirimtare, vdekja fashistëve dhe tradhtarëve.

Vepra e dëshmorëve, heronjve të popullit, si Nazmi Rushitit me shokë do të rrojë me shekuj, brez pas brezi në mendjet dhe zemrat e popullit të rinisë dibrane.

MORENA RUÇI
Drejtore e Muzeut
Peshkopi

Nazmi Rushiti lindi në një familje qytetare të Dibrës së Madhe. Babai i tij Rushiti punonte si lëkurëpunues (regjje lëkure) dhe ua shiste tregtarëve. Me pushtimin serb të Dibrës u detyrua të qëndrojë ilegalë herë arratisej në Shqipëri, në Greqi etj. Më 1922 kthehet nga Greqia dhe vjen në Dovolan. Me shumë përpjekje mundi të siguroj pak tokë dhe u muar kryesisht me bujqësi. Nëna Nebija krahas kujdesit për rritjen e 4 fëmijëve ndihmonte Rushitin për të siguruar mjetet e jetesës.

Nazmiu lindi më 1919, ishte 3 vjeç kur erdhën në Dovalan. Më 1928 në moshën 9-vjeçare hyn në punë shegert tek një këpucar në Dibër të Madhe. Ishte mosha për shkollë, por shkollat shqiptare ishin shumë të rralla. Ece e jaket e babait për të regjistruar Nazmiun në shkollë dështuan. Pas dy vjetësh sorollatjesh u pranua me shumë vështirë më 1930 në konviktin e Internatit në Kastriot.

Shquhej për zgjuarsi, vullnet të fortë në shkollë. Katër klasë i mbaroi në 2 vjet. Kërkesa për të vazhduar studimet nuk i miratohet, prandaj erdhi në Tiranë. Pranoi të punojë shërbyes tek një tregtar me shpresën se do të vazhdonte gjimnazin. Nota e shkëlqyer që mori në një konkurs i detyroi autoritetet shkollore të fitonte të drejtën për t'u regjistruar në Gjimnazin e Tiranës më 1933. Aty u njoh me Vasil Shanton dhe me bashkëvendasit e tij Demir Gashin e Irfan Hajrullain etj. Ra në kontakt me librat që siguroheshin ilegalisht nga shokët. U regjistrua në shoqërinë "Fryma e re" organizatë jashtëshkollore e nxënësve e krijuar më 1930 për bashkimin e të rinjve përparimtarë. Për të luftuar vjetrën, botën e varfërisë dhe mjerimit duhet luftë, guxim, trimëri, besë, vullnet, bashkim, vetmohim. Në vitin shkollor 1935-36 Nazmi Rushiti ishte skeduar si nxënës turbullues, i rrezikshëm për shoqërinë, rendin, qetësinë, xhandarmërinë, prandaj e transferojnë në gjimnazin e Shkodrës. Atje gjeti një ambient përparimtar më aktiv me Vojo Kushin, Emin Durakun, Hajdar Dushin, Tom Kolën, Xheladin Hanën etj. Regjistrohet në shoqërinë "Besa". Më 1936 shpërtheu kryengritja e Fierit, u bë demonstrata e bukës në Korçë, greva e punëtorëve në Kuçovë. Më 1938 alarmohet Drejtoria e Shkollës, sepse sipas një informacioni të xhandarmërisë nxënësit e gjimnazit nderojnë në mënyrë bolshevike. Nazizmit i tërhiqet vëmendja!

Nazmiu kishte një pjekuri të parakohshme, shquhej për dashuri ndaj njerëzve të thjeshtë dhe të punës, aftësi për të komunikuar me shokët, që ia rriste çdo ditë e më shumë autoritetin në mesin e studentëve dhe profesorëve por edhe vetë qytetarëve të Shkodrës. Kishte shpirt protestues e kryengritës kundër çdo padrejtësie, kundër regjimit, mbeturinave patriarkale e besëtytnive fetare.

Më 1938 bashkë me një grup shokësh arrestohet, dërgohet në burgun e Tiranës. Stavri Jaho oficer i xhandarmërisë këtu filloi torturat.

Trego shokët? Jeni komunist? Qëndrimi burrëror vuri në veprim kërbaçin. Në gjyq demaskuan regjimin feudo-borgjez, tradhtarët, spiunët që kishin treguar shokët në Organet e Xhandarmërisë si organizatë e prishës të rendit, kundërshtarë të Monarkisë e përmbysjes së saj me luftë, me forcë.

Demaskimi i qeverisë si shkaktare e varfëisë e mjerimit prej Vasil Shantos, Qemal Stafës e Nazmi Rushitit u dha krahë, kurajë e optimizëm shokëve antifashistë të burgosur. Në fund të shkurtit 1939 Nazmiun e gjejmë në Mbreshtan të Beratit për të vuajtur dënimin prej 4 vjetësh. Megjithëse në burg pushtimin fashist të 7 prillit e pritën me protestë, nuk na duhet jeta pa liri! Fashizmi burg për popujt etj. Arratisen së bashku me Vasilin, Eminin Mysafer Asqeriun, Ndoc Mazin etj. Për demagogji, fashizmi shpalli një amnisti prandaj disa prej studentëve u kthyen në gjimnaz.

Më 28 nëntor 1939 të rinjtë e gjimnazit të Shkodrës prishën manifestimin fashist dhe organizuan demonstrata në rrugën e qytetit me parulla "Poshtë fashizmi!". E filluan gjimnazistët më në krye Nazmi Rushitin, Tom Kolën, Esat Gjyli, Qazim Llazanin, pas tyre erdhën punëtorët, zanatçinjtë, populli i thjeshtë. Qytetarët shoqëruan himnin e flamurit nga dritaret e shtëpive të banimit deri në orët e vona të mbrëmjes. U alarmuan, por edhe frikësuan xhandarmëria, prefekti, drejtoria e shkollës, gjithë administrata fashiste. Filluan masa përjashtuese prej konviktit, ministria e Arsimit e pakënaqur nga Drejtoria e Shkollës i përjashtoi 1 vit nga shkolla. Masa diferencuese u morën për studentët më aktiv, Nazmiu dënohet me 2 vjet internim në Gaeta të Italisë në ishullin Ventotene.

Atje gjeti të burgosur politikë, komunistë, vagabontë, hajdutë, mashtrues, vrasës, antifashist të vendosur etj. "Nuk e dua lirinë duke hedhur poshtë bindjet e mia ishin fjalët e Nazmiut para kuestorit fashist të Kampit të Internimit". Faleminderit që më dhatë mundësi ta njoh fashizmin në vendin e vet se në vendin tim e kam njohur me kohë.

Në vjeshtën e vitit 1941 kthehet në Shqipëri:

Në shtator 1941 dy xhnadarë shoqërojnë Nazmiun në Maqellarë në zyrën e Prefektit. E priti me këmbët e para siç thotë populli. Zure mend andej nga erdhe? Hiq dorë nga udha e juaj e rrezikshme! Ju jeni shqiptarë zoti prefekt dhe i shërbeni fashizmit. Populli po përgatitet për hakmarrjen e madhe përgjigjet Nazmiu.

Burgu është pak për ju! Duhesh varur! Gjithë popullin nuk mund ta varni zoti Prefekt. Largohu nga Dibra, shko në Tiranë. Lufta kundër fashizmit kishte hyrë në një fazë të re. Ishte themeluar partia Komuniste e cila delegoi Nazmiun si militant të saj në Dibër. Me ide, trakte dhe bomba ishte armatosur. Bashkë me Irfanin, Demirin erdhën në qytetin e lindjen në Dibër të Madhe. Filluan punën, ngjiten traktet në rrugët e muret e qytetit, shtuan radhët me shegërtët, punëtorët, mësuesit e fshatarët. U krijuan grupet edukative me të rinjtë, me gratë dhe vajzat. Kërkohej durim dhe këmbëngulje; Duheshin bashkuar forcat me vullnetarët antifashiste, që kishin filluar veprimet luftarake kundër Italisë fashiste qysh më 6 prill 1941. Ideali për liri i bashkoi Nazmi Rushitin dhe Haxhi Lleshin. I dhanë besën njëri-tjetrit për të ndërmarrë një vepër, që i bëri të pavdekshëm luftën për liri dhe çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi fashist. Rrugë e gjatë me sakrifica të mëdha, një rrugë pa kthim. Pasi hartuan planet filluan pa humbur kohë për veprime e aksione konkrete. Ishin pjekur kushtet për krijimin e çetës partizane të Dibrës. Më 20 qershor 1942 në Zogje u mblodhën komunistët. Nazmi Rushiti, Qazim Prishtina, Zoi Themeli, Irfan Hajrullai, Veli Deva, Dali Ndreu, Esat NDreu, Abedin Shehu, Hilmi Çausholli ngritën celulën e Partisë komuniste për Dibrën, sekretar i celulës u zgjodh

Rruga e Arbërit nr. 193-195

kujtesë

KAJAN KARAFILI
e vërteta e origjinës dhe veprës së Heroit të Popullit

Nga **ARIF SHUTINA**, studiues

Një të diel, me tre bashkëpatriotë të tjerë intelektualë dibranë, u takuam për një kafe në Kinostudio, Tiranë. Në bisedë, ndër të tjera, ra fjala për figurat e shquara nga krahina jonë Kalabardha (Golloborda). Teksa unë përmendëm Mustafa Qemal Ataturkun, Qemal Stafën, Hazis Lilën, Hasan Muglicën, Elez Koçin, Murat Labunishtën, intelektuali i mirënjohur dibran Qamil Sula na kujtoi Kajan Karafilin.

- Kajan Karafili është dibran nga krahina e Kalabardhës, - tha ai. Këtë ma ka thënë para dy vitesh kur isha me pushime në Radhimë, Vlorë, një burrë i moshuar pogradecar, ish-ushtarak, që mbanë mbiemrin Karafili e që banonte te Kodra e Priftit në Tiranë. Ai më tregoi se gjyshi i babait të tij kishte dhe një vajzë për të martuar. Në atë kohë në fshat mbërrijnë një skuadër muratorësh nga Golloborda e Dibrës, të cilët i kishin ndërtuar gjyshit të tij një shtëpi, por edhe shtëpi të tjera në fshat. Duke ndenjur në fshat për një kohë të gjatë, ata krijuan një përshtypje shumë të mirë te banorët e fshatit, si punëtorë të palodhur e mjeshtër të shquar, njerëz të sjellshëm e humanë. Veçanërisht binte në sy për këto cilësi një djalë i ri beqar. Gjyshi i tij, pasi ishte konsultuar me të afërmit e shokët i ishte mbushur mendja që ta bënte dhëndër e tia jepte për nuse motrën e vetë. Dhe kështu motra e gjyshit të tij kishte përfunduar nuse te Oshafët në Gollobordë.

- Po, - i thash. Këtë e di mirë, se origjinën e ka nga fshati im, nga Gjinoveci i Kalabardhës. Kam dëgjuar disa të moçëm nga fshati im që më tregonin origjinën dhe historinë e të atit të Kajan Karafilit, bashkëfshatarit tonë.

Kjo kujtesë e mikut tonë më shtyu të hulumtojë edhe një herë rreth fakteve jetësore të Kajan Karafilit. Por për çudi, opinioni i gjerë e di që Orhan Kajan Karafili, i njohur si Kajan Karafili, është pogradecar. Dhe historiografia shqiptare kështu e njeh, nga Pogradeci. Këtu ka diçka të vërtetë, por nuk është e vërteta e origjinës.

Në historiografinë shqiptare të kohës së sistemit komunist ka shumë pasaktësi dhe shtrembërime të fakteve për Kajan Karafilin. Edhe në monografinë e tij ka të tilla. Prandaj në këtë shkrim do hedhim dritë mbi disa fakte historike rreth origjinës dhe jetës së tij.

***

Orhan Kajan Karafili u lind në fshatin Bllacë të Pogradecit më 1920. Babai i tij quhej Karafil Oshafi, i biri i Karafilit nga fshati Gjinovec i Kalabardhës. Këtë të vërtetë historike e kam dëgjuar në rininë time nga pleqtë e fshatit në konaqet kur mblidheshin në raste gëzimesh apo hidhërimesh. E tregon ende sot bashkëfshatari im, Bajram Oshafi, 87 vjeç, nga i njëjti fis i Karafilit, i cili shquhet për një memorie brilante.

- Gjyshi i Kajanit, Karafili, ishte mjeshtër ndërtimi dhe bashkë me disa bashkëfshatarë të tij iknin në kurbet, siç e kanë pasur traditë zona jonë, për të siguruar mjetet familjare të jetesës, - tregon Bajram Oshafi. Në vitet e Luftës së Parë Botërore ata punonin në fshatrat e Pogradecit. U pajtuan nga një familje e fshatit Bllacë të Pogradecit të ndërtonin shtëpinë e asaj familje. Bashkë me të atin ishte edhe Karafili, djalë i ri, i pashëm, i fuqishëm, i shkathët, burrëror. Familja e të zotit të shtëpisë e pëlqyen fortë Karafilin dhe menduan që tia japin vajzën e tyre për grua, duke e pranuar të rinte te ata. Këtë ia thanë të atit të Karafilit dhe ai pranoi. Kështu, Karafili u martua me vajzën e familjes nga fshati Bllacë i Pogradecit dhe qëndroi në atë fshat e nuk u kthye më në Gjinovec.

Dëshmi të tilla gojore për origjinën nga Gjinoveci i Kalabardhës të Kajan Karafilit gjen plot te bashkëfshatarët tanë të moçëm edhe sot.

Kështu, Karafili u martua me një vajzë nga fisi Ruzi e fshatit Bllacë të Pogradecit. Fshati i njihte me mbiemrin e tij të origjinës, Oshafi, ose Oshafllari sipas dialektit të zonës. Karafilit i lindën katër djem dhe një vajzë. Orhani, i cili mori mbiemrin nga emri i babait të tij, se kështu shënoheshin mbiemrat në atë kohë, në emrin e të atit, ishte i dyti nga fëmijët.

Karafili, i ati i Kajanit, "qe grindur me një farë Nezir Xhemollari, sepse ky i fundit i kish grabitur pushkën, dhe nga frika se mos e vriste Filja (se kështu e thërrisnin në fshat Karafilin – A.Sh.), emigroi në Turqi". Por si burrë fisnik e i pa nënshtruar, Karafilin nuk e donin "krerët, agallarët dhe bejlerët e krahinës". Disa njerëz, ndër ta edhe Sejfulla Agai nga Bratomira, për ta poshtëruar Karafilin dhe djalin e tij të madh, Nexhipin, e martojnë të fejuarën e djalit nga Podgoria me një tjetër. "Nexhipi, i prekur në sedër, e plagosi rivalin e tij. Sejfulla Aga dhe bejlerët e tjerë në këtë plagosje implikuan edhe Karafilin." Gjyqi i dënoi të dy me nga 20 vjet burg. Nexhipi vdiq nga kushtet e rënda në burg në vitin 1935, ndërsa Karafili vdiq i helmuar po në burg në vitin 1937. Megjithëse në moshë adoleshente, Kajanit i takoi barra e tërheqjes së trupave të tyre nga burgu dhe varrimit, si dhe mbajtja e peshës së familjes për mbijetesë.

***

Nezir Xhemollari, sapo mori vesh burgosjen e Karafilit, u kthye nga Turqia. Kajani, e mësoi një ditë rastësisht ndodhinë nga biseda e dajës së tij me një mik të tij në një lokal në Pogradec, kur kishte shkuar në pazar për të shitur vezë e për të blerë vajguri e kripë për familjen. Kështu e njohu Nezirin aty, e ndoqi pas te çezma dhe e gjakosi në kokë me një shishe qelqi, për të cilën e mbajtën në polici një ditë.

Më 1938, Kajan arratiset në Resnjë të Maqedonisë pasi vret xhandarin Sejfulla Aga në fshatin në Bratomirë, të Pogradecit, ka të ngjarë për shkak se kishte poshtëruar dhe arrestuar babain e vëllain e tij në burg. Në Resnjë njihet me Myslym Pezën, i cili kishte ikur në ekzil pas vrasjes së togerit të xhandarmërisë Osman Bali tek Ura e Tabakëve në Tiranë. Kajan Karafili, tashmë nëntëmbëdhjetë vjeçar, u kthye me Myslim Pezën dhe Haxhi Lleshin në Tiranë në korrik 1939 dhe qëndroi pranë Myslim Pezës dhe luftoi me çetën e tij për lirinë e Shqipërisë.

Kajan Karafili u bë një figurë e madhe e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, i cili dha edhe jetën në luftë për çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Ai "ka qenë një nga komandantët, luftëtarët dhe atentatorët më me zë gjatë LANÇ-it, i zgjuar dhe trim i rrallë, por dhe shumë i dashur, i papërtueshëm dhe i shpejtë në çdo aksion".

Rreth veprimtarisë së Kajan Karafilit gjatë LANÇ-it në zonën e Pezës ka mjaftë "të pavërteta dhe përgojime banale", sikur paska vrarë një inxhinier italian që merrej me ndërtimin e rrugës dhe gratë e fshatit luanin e kërcenin me kokën e tij; sikur Kajan nuk paska luftuar në ballë të luftës si trim që ishte. Pra, kërkojnë që ta njollosin, ta nxjerrin sot një njeri kriminel ordiner, që vriste këdo që i dilte përpara. Dhe ky është një turp për kalemxhinjtë e stisur e pamoral, që kërkojnë të kthejnë faqen e historisë përmbys, të denigrojnë luftën heroike të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare kundër nazi-fashizmit.

Kajan Karafili ishte luftëtari më i vjetër i çetës trime partizane të Pezës, atdhetar, patriot, që luftoi për lirinë e Shqipërisë. Ai kreu atentate të shumta kundër pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre si vrasja e spiunit fashist Sinan Bultica më 14 tetor 1941, asgjësimi i spiunit në Varosh të Ndroqit; kreu aksione të vazhdueshme me çetën e tij si aksioni për prerjen e rrjetit telefonik për gjithë vendin më 24 korrik 1942; aksioni për vrasjen e kapiteni fashist Kapllan bej Deliallisi në qytetin e Shijakut më 7 dhjetor 1942; sulmin ndaj autokolonës ushtarake që udhëtonte nga Tirana për në Durrës duke vrarë 16 fashistë, 30 të plagosur dhe 60 vetë të çarmatosur më 27 nëntor 1942; goditjen kundër forcave fashiste të drejtuara nga nëntogeri fashist Ramazan Bali në 20 dhjetor 1942, që "torturoi me qindra dhe vrau më tepër se 22 fshatarë nga Pajana, Greca, Gorrëzi etj. në kuadrin e operacionit të "spastrimit" në zonën e Pezës dhe vrasja më vonë e tij më datë 23 maj 1943; goditjen e postës së karabinierisë në Kavajë më 8 janar 1943; aksioni për goditjen e përqendrimit të forcave të mëdha ushtarake, milice dhe karabinierësh në qytetin e Rrogozhinës më 13 shkurt 1943; aksionet për asgjësimin e vrasësve e grabitësve të popullit të fshatrave të Kavajës Dik Bagosi, Muharrem Sinometa, Him Kanoshi apo fashistit të njohur Irfan Bej Ohri; luftimet në operacionet e fashistëve kundër forcave partizane të zonës së Pezës si operacioni famëkeq i qershorit 1943, në të cilën për morën pjesë rreth 14 mijë trupa të pushtuesit fashist ku mbetën të vrarë dhjetëra fashistë, ndër to edhe koloneli i kavalerisë Ludoviko de Bartolomeo dhe shumë oficerë të tjerë fashistë etj. Në këtë operacion spastrimi 9-ditor, ku armiku dogji mbi 400 shtëpi të fshatrave dhe pothuaj gjithë grurin nëpër arra, përmendim "aktin heroik të Kajanit me njësitin e tij kundër qindra milicëve mercenarë në mëngjesin e datës 17 qershor, në pyllin e Fiollës, për të shpëtuar nga rrethimi një grup grash, fëmijësh dhe pleqsh, që rrezikoheshin nga asgjësimi i sigurt". Aksione e sulme të tilla Kajani kreu e drejtoi pa fund.

Më 13 mars 1943, me krijimin e pesë kompanive apo çetave të tjera të Çetës së Pezës, Kajani u bë komandant i një kompanie/çete. Në gusht të vitit 1943 në fshatin Kryezi u inaugurua formimi i batalionit të tretë të grupit të Pezës, komandant i të cilit ishte heroi Kajan Karafili. Kjo kompani e ky batalion partizan, nën drejtimin e Kajanit, me përpjekjet dhe luftimet që zhvilluan, u bënë tmerr për armikun në zonën e Ndroq-Kavajë-Rrogozhinë. Përpjekje të tilla me fashistët e mercenarët ballistë ishin ajo e datës 25 korrik 1943 në afërsi të fshatit Sulzotaj të Divjakës, goditja e grupit italian të artilerisë kundërajrore në kodrat e Saukut të Tiranës, goditja e trupave italiane që pas kapitullimit. Kaluan nën urdhrat e nazistëve gjermanë, sulmi i 20 shtatorit 1943 në kazermat e artilerisë Tiranë, luftimet në rajonin e Urës së Beshirit e të Farkës më 7-9 tetor 1943 etj.

Sipas dëshmisë së bashkëluftëtarëve të tij, Sali Verdha, Safet Kurti etj., Kajan Karafili u vra në përpjekje me forcat gjermano-balliste më 10 janar 1944, në fshatin Lis-Patros në rrethinat e Kavajës. Gjermanët dhe ballistët kishin inat të madh me Kajanin dhe batalionin e tretë të Pezës, sepse ishin bërë tmerri për zonën e Kavajës. Në këtë përpjekje u vranë edhe komisari i batalionit të tretë Mustafa Lleshi dhe partizanët Bajram Tusha dhe Myrvete Peza, e fejuara e Kajan Karafilit, e cila besohet se vrau veten nga hidhërimi po në atë betejë sapo mësoi se ai ishte vrarë. Të vrarët u varrosën larg fshatit, që të mos gjendeshin nga armiku. Por mbas disa ditë kërkimesh, kolaboracionistët nën drejtimin e komandantit të Ballit për Kavajën, Ram Habili, ish-anëtar i Çetës së Pezës, në bashkëpunim edhe me forcat naziste, "në kundërshtim me normat dhe traditat morale të popullit shqiptar", i gjetën varret e tyre, i përdhunuan duke i nxjerrë trupat nga varri. Me qëllim për ta ç'mitizuar në popull, trupin e Kajanit e morën dhe për katër ditë e ekspozuan në Kavajë dhe një ditë në Shijak, ndërsa trupat e tjerë i lanë në sipërfaqe, përfshi edhe atë të Myrvetes. Më pas janë rivarros nga fshatarët e Lis-Patrosit. Por populli i Kavajës, "duke mos përfillur urdhrat e autoriteteve pro naziste të qytetit, e ngriti trupin e Kajanit dhe e vendosi në varrezat e qytetit".

***

Fakt është se Kajan Karafili ishte anëtar dhe atentator i Lëvizjes Nacional-Çlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai ishte një "prej luftëtarëve më të sprovuar të Çetës së Parë Partizane të Evropës në luftën kundër fashizmit". Luftoi kundër pushtuesit të huaj dhe ra dëshmor me armë në dorë për lirinë e Shqipërisë. Kajan Karafili është shpallur "Hero i Popullit".

kujtesë

Abdulla Musa Hoxha i Dibrës...

Shënime për një qytetar të thjeshtë të qytetit tim... Dhe një dokument i rrallë -1946

Ata ishin dy vëllezër, Musai dhe Abazi, me rrënjë jetese shekullin XIX.

Musai la pasardhës Abdullain, Hatijen, Shemsiun, Ismailin dhe Verën...

Abazi la pasardhës Remen, Hajriun dhe Sulën...

Bedrika, bashkëshorte e Musait dhe Terja, bashkëshorte e Abazit deri pas viteve '60 kanë qenë qytetare të respektuara të Peshkopisë si motra...

Hajri Hoxha, kushëri i parë i Abdullait, në kujtimet e tij (në dorëshkrim) përcjell një pamje të gjerë të kohës dhe rrënjëve të gjakut të tyre në Dibër...

Ai shkruan: "Me qindra familje nga Dibra e Madhe u detyruan që më 1913 e deri në 1922 të linin vatanin e të gjenin mikpritjen tek vëllezërit e tyre në Shqipëri vëllezër që hapën portat e tyre me zemrën bujare me çfarë kishin: bukë e kripë e strehim duke mos u marrë as edhe një cent qira, familje që në muajt parë e shtronin bukën së bashku në sofrën e tyre.

Kujtoj gjithmonë amanetin e gjysh Nazif Kurtagës (i ati i nënës) e të xhaxhait tim Musa Hoxhvoglit (Hoxha):

"Kurrë mos e harroni ta kujtoni bujarinë e popullit të Tiranës e të gjithë shqiptarëve që bënë për ne dibranët. Këtë amanet kalojeni brez pas brezi".

Dhe sa herë kemi kaluar dhe kalojmë në një rrugë kryesore të Tiranës që të çon drejt spitalit e deri tek këmbët e malit të Dajtit, rrugë që tiranasit ia kanë vënë emrin "Rruga e Dibrës", i sjell ndërmend ato fjalë. Rruga e Dibrës ishte rruga që ndoqën familjet dibrane drejt Tiranës e zonave të tjera, ishte rruga që në histori quhet "Rruga e Arbrit", rrugë e cila lidhte kombin shqiptar nga bregdeti në thellësi të Ballkanit...

Kështu familja jonë me mbiemrin real që është shënuar edhe në Gjendjen Civile të Peshkopisë në atë kohë është "Abaz e Musa Shemsi Hoxhvogli".Në vitin 1920 u strehuan dhe gjetën zemrën bujare të qytetit të Peshkopisë që në ato vite nuk kishte më shumë se 2-3 mijë banorë vendas. Gjyshi jonë quhej Shemsi dhe gjyshja Mereme, të vdekur në Dibrën e Madhe. Këta kanë pasur dy djem dhe një vajzë: Abaz (babai ynë) dhe Musai (xhaxhai) si dhe Reitka (vajza). Të dy vëllezërit janë martuar në Dibër të Madhe, respektivisht me Atere Nazif Kurtagën dhe me Bedrije Çeliku si dhe Reitka me Rustem Hamen (fshat në afërsi të Banishtit ku janë dhe llixhat termale).

Kur prindërit kanë ardhur në Peshkopi Abazi dhe Aterja kanë pasur një vajzë Meremen që ka lindur në Dibër të Madhe më 1916-tën, ndërsa xhaxhai kishte një djalë të lindur në Dibër të Madhe më 1919-tën. Ndërsa vëllai Sula dhe unë, Hajriu, kemi lindur respektivisht në Peshkopi më 1922 dhe 1925. Po ashtu ka lindur edhe motra e vogël më 1927 po në Peshkopi, Qefserja, por na ka vdekur në vitin 1929 në Kavajë pas vdekjes së babait në vitin 1928. Po ashtu, në Peshkopi kanë lindur edhe fëmijët e xhaxhait: Atija, Shemsiu, Pranvera dhe Ismaili. Motra jonë ka pasur emrin e gjyshes, Mereme, dhe djali i xhaxhait ka pasur emrin e gjyshit, Shemsi.

Mbiemri i familjes sonë është "Hoxhvogli"...

Prindërit tanë janë marrë në Peshkopi me tregti të vogël (tezga) me shitje çikërrimash, këna e të tjera, ndërsa Musai ka pas hapur një dyqan me shitje manifakture.

Babai ynë vdiq në vitin 1928 dhe nëna jonë, e paharruara Aterja, mbeti e ve me

katër fëmijë; Meremen, Sulen, Hajriun dhe Qefseren. I ra barra shumë e rëndë në moshën 25 vjeçe të rrisë jetimët. Kështu ajo u bë Nënë edhe babë. I shoqi i la vetëm 20 napolona flori.

Në këtë kohë përveç kujdesit të kunatit të saj –Musajt, pati menjëherë dorën e babait të saj –Nazif Kurtagës, që kishte imigruar dhe banonte në Kavajë..."

(Hajri Hoxha: Kapitulli "Familja")

* * *

Në 100 vjetorin e lindjes, Musa Hoxha, trashëgimtar i emrit të gjyshit i përlotur shkruan:

Gjithnjë në zemrat tona i dashur baba!

I ndodhur larg vendit tim në këtë 100 vjetor më duket sikur jetojmë në të njëjtën botë, të të gjallëve...

Dua ta harroj atë moment kur ti ike nga ne 20 vite të shkuara i dashuri babai ynë i mirë.

Vitet ikin shume shpejt, ashtu pa kuptuar, duke lënë gjurmë dhe mall në memorien tonë

Kujtoj gjyshen (Nana) kur me tregonte për momentet kur u larguat nga Dibra e Madhe.

I vogël, atëherë ishe vetëm 13 vjeç. Përshkuat rrugën nga Shkalla e Tujanit për tu vendosur më pas në Peshkopi si qiraxhi tek Shehlerët, por gjithnjë me shikimin prapa...

Duke mbetur jetim, vetëm 15 vjeç, të ra barra e mbajtjes së familjes me atë biznes që ta la babai.

Ishte pasioni yt tregtia dhe pak mund ta dinë që ti solle ndoshta kamionin e parë në Dibër të cilin pas çlirimit më 1947 ua shtetëzuan.

Duke pasur një trashëgimi tregtare natyrshëm ishit ndër të parët drejtues që ndihmuat në krijimin e strukturave të tregtisë në Dibër siç ishin Kooperativat e Konsumit. Më vonë u morët me një lloj tjetër "tregtie" atë kulturore. E kishit pasion Librin të gjithë ju vëllezër dhe motra sa edhe shoqëritë e familjes siç duket ishin ndërtuar me dashurinë e përbashkët për kulturën e librin ku spikat ajo me shkrimtarin e mirënjohur Haki Stërmilli.

Punuat për afro dy dekada Përgjegjës Rajonal i "Libraria Populllore" për Dibrën dhe Burrelin. Dashamirësit tuaj ju kujtojnë gjithnjë në këtë detyrë dhe ndjehemi shume krenar kur ato shprehen edhe sot me konsideratë dhe nderim për punën që ju keni bërë për shpërndarjen e librit dhe afrimin e tij sa më afër lexuesit.

Iu kthyet përsëri Ndërmarrjes Tregtare ku qëndruat deri sa dolët në pension gjithnjë i vlerësuar për korrektësinë e madhe në kryerjen e detyrës.

Sa herë ju sjell në mend është e pamundur t'ju mendoj pa librin në duar, qoftë ai artistik, historik apo politik, siç kujtoj pasionin tuaj për filatelinë, rregullin me të cilin mbaje çdo seri të pullave sipas kronologjisë, kategorive dhe vlerave që ato mbanin.

Ju ishit korrekt në përmbushjen e përgjegjësive zyrtare, shoqërore si i zgjedhur, ashtu dhe atyre familjare. Ju ishit gjithnjë kërkues i më të mirës tek ne fëmijët e tu por asnjëherë imponues. I rregullt në çdo gjë por rregulli është një temë e gjatë që më sjell shumë kujtime...shumë herë dhe të qeshura...

Kështu duke qeshur dua ta mbyll këtë memorie për ty i dashur baba në këtë 100 vjetor të ditëlindjes tënde.

I paharruar do të mbetesh në zemrat e pasardhësve të tu.

Faleminderit baba!

* * *

Tash, pas kujtesës së Hajri Hoxhës jeta e të cilit po i afrohet shekullit, dhe dedikimit emocionues larg nga Kanadaja të Muçit, më vjen këtu, njëmijë kilometra larg nga Dibra, Abdulla Hoxha i gjallë, i shëndetshëm, me atë vështrimin e tij ku shkruhej mirësia, me atë buzëqeshjen që i ishte ngjitur në fytyrë në mënyrë të pashqitëshme.

Abdullai më vjen më i gjallë dhe më xhentil se kurrë prapa banakut të librarisë në qytetin e vogël të Peshkopisë. Të hyje në Librarinë Popullore siç shkruhej asokohe në tabelën e dyqanit dhe të mos dilje pa një libër në dorë ishte e jashtëzakonshme. Abdulla Hoxha ta lexonte me vështrim të parë dëshirën për shkencën që doje, për romanin që të pëlqente, për poezinë që të ngacmonte shpirtin.

Unë, asokohe student, isha një ndër klientët e tij të veçantë, madje të çuditshëm për kërkesat e mija në atë qytet të vogël.

Në banakun e Abdullait asokohe kishte disa katalogë kërkesash për libra në gjuhën ruse. Mund të shënoje librin që doje, artistik, gjuhësor apo shkencor. Abdullai e merrte kërkesën dhe e përcillte në adresat që shënoheshin, larg në vendbotimet në Rusinë e largët.

Nga ato kërkesa, fryt i korrektësisë së Abdulla Hoxhës, në bibliotekën time kam disa fjalorë, disa libra shkencore për agronominë, një album pikturash që ia dhurova një miku për djalin e tij të talentuar në pikturë. Kam edhe Pushkinin në origjinal me poezitë disa prej të cilave edhe sot i di përmendsh...

Unë aplikoja asokohe edhe në "Librin ndërkombëtar" në Tiranë por korrektësia e Abdulla Hoxhës ishte një mrekulli shërbimi...

Të shtunën, më 8 janar 2000 do të shënoja në Ditar...

"Pasdite bëmë disa vizita. Të parën tek Remja e Vogël ku ishin edhe Rizai me Fatimen dhe me Iridën, Astriti me Engjëllushen, djalin dhe vajzën. Remja ishte mjaft mirë me shëndet.

Prej andej shkuam tek Abdulla Hoxha, i Madhi. Ishte i paralizuar në shtrat por me kujtesë të plotë. Ishte edhe Serja me Muçin dhe fëmijët"

Ishte ky takimi i fundit me Abdulla Musa Hoxhën e Dibrës së Madhe dhe të Peshkopisë.

Pak kohë më vonë, në prill 2000 më erdhi në Athinë lajmi për ikjen në përjetësi të Abdullait.

Bashkë me Natashën e kujtuam ashtu të gjallë, të qeshur e të gëzuar.

Bashkuam dhimbjen tonë me Musain dhe familjen e tij, me Lindën dhe Dhuratën, vajzat e tij të mrekullueshme, me të shoqen, Seren, që i qëndroi pranë me përkushtimin e një gruaje të vërtetë dibrane.

Abdurahim Ashiku

Athinë, 22 prill 2020

Kurt Zebi, ushtaraku që ruajti deri në fund vlerat e larta të dibranëve

Para disa ditësh u nda nga jeta në moshën 88 vjeçare Kurt Zebi. Ai vinte nga një familje e njohur për traditat atdhetare, ndeshmërinë dhe bujarinë e saj, nga fshati Dohoshisht i rrethit të Dibrës. Familja e tij ka qenë qysh në fillim mbështetëse dhe bazë e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Vetë Kurti, pasi kreu arsimin shtatëvjeçar në vendlindje, vijoi studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" dhe më pas në atë të Bashkuar të Oficerëve. Fillimisht shërbeu në repartet e Flotës Luftarake në Vlorë dhe më vonë në Njësinë e Mbrojtjes Bregdetare të Durrësit, ku qe caktuar në detyrën e drejtuesit të batalionit efektiv të Shënavlashit, dhe pastaj u caktua shef i Shtëpisë së Ushtarakëve.

Në këto detyra Kurti shpalosi jo vetëm aftësitë e tij profesionale, por edhe vlerat e tij njerëzore. I thjeshtë, energjik, punëtor i palodhur, mjaft komunikues me vartësit, ai fitoi respektin dhe dashurinë e të gjithë atyre me të cilët punoi.

Mbi të gjitha, ai u bë një kuadër i respektuar nga intelektualët e Durrësit dhe sidomos nga shkrimtarët dhe artistët me të cilët organizoi shumë veprimtari të përbashkëta. Kurti dallohej për korrektesë, inisiativë dhe mbi të gjitha si humanist i pashoq. Atë do ta shihje përherë në lëvizje, duke ndihmuar këdo që kishte nevojë.

Kudo që shërbeu, ai dinte t`i mbronte me guxim vartësit e vet, sikurse dinte të mbronte para kujtdo edhe bindjet e tij. Kurti, krenar për vlerat e larta të dibranëve, dhe përfaqësues i palëkundur i tyre, ishte shumë i lidhur me bashkëfshatarët e tij, të cilët ndiheshin tek ai si në shtëpinë e tyre. Edhe kur ndonjë dashakeq, u përpoq ta denigrojë e ndëshkojë atë, deri me shpifje të ulta, ai mbeti deri në fund oficeri dinjitoz, punëtor dhe krenar se ishte bir i një treve që mbi të gjitha dinte të ruante të paprekura cilësitë e larta morale dhe atdhetare. Pas daljes në pension,

Kurt Zebi ishte mishërues dhe përçues i vlerave më të mira intelektuale dhe njerëzore. Kudo ku shërbeu si dhe në mjedise shoqërore e familjare demostroi urtësinë e mençurinë dibrane, si themeli i "Universitetetit të Dibrës", të përvetësuar prej tij nga mexheliset e odave të kësaj treve, ndër më të njohurat në rang kombëtar.

Kurti drejtoi me sukses Shoqatën "Për të rënët e Kombit". Në jetë u shqua si një familjar shembullor, si bashkëshort besnik i gruas së tij vlonjate Lirisë dhe baba i tri vajzave të mrekullueshme e djalit Arben i cili u nda nga jeta në moshë të re, duke i shkaktuar atij një brengë të madhe. Për merita e tij në jetë dhe punë, Kurt Zebit i janë akorduar urdhra e medalje të ndryshme.

Me vdek jen e tij, familja dhe të afërmit humbën njeriune tyre më të dashur, shokët dhe miqtë, shokun dhe mikun e tyre të ngushtë, që do t'ju mungojë shumë.

Lamtumirë Kurt Zebi!.

Parajsa qoftë vendbanimi yt i përjetshëm!

SHPENDI TOPOLLAJ
BASHKIM KADIU
HALIL RAMA

BOTIME TË REJA

AGRON TUFA
Paqja e përgjakur e Adamit

Roman
Shtëpia botuese: Onufri
Çmimi: 1200 lekë

Romani i Agron Tufës “Paqja e përgjakur e Adamit” është një rrëfim elegjiak për fatin e njeriut të drejtë që përpiqet të meritojë “hisen e tij nën diell”, që sakrifikon e flijohet për të afërmin, që ëndërron të ndërtojë strehën e tij në paqe me këtë botë dhe që gjen në realitet vetëm tradhtinë, poshtërimin dhe mosmirënjohjen.
Jeta e qetë e Adam Zaganjorit tronditet pakthyeshëm kur çdo gjë që ai ka ndërtuar me sakrifica i shkulet duarsh me forcë e dredhi. Goditjen e fundit fatale ia jep e shoqja duke e privuar nga gjithçka që përbënte botën e tij. Adam Zaganjori përfaqëson të dëbuarin e përjetshëm që ëndërron dhe përmallet për një strehë shtëpiake. Romani shkapërcen shpejt tonet e para idilike. Vrapi rrënues i ngjarjeve na kalon para syve si shthurja e një thurime me shtiza, të cilën nuk mund ta ndalosh, derisa Adamit i mbetet vetëm një dëshirë për të cilën qe lutur: “të zinte vend i pari përbri së ëmblës, mamasë së tij të vetmuar, në rreshtin e paplotësuar të varreve familjare”.

BIGmarket
një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani
GJITHMONË ME OFERTA...
PESHKOPI MAQELLARË

NJOFTIME

- Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Për të dhënat bankare shihni njoftimin më poshtë ose në faqen 2.
- Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!
- **KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE.** Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.
- Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t’i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**
Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.
Shtyp butonin **“NDIHMO EDHE TI”** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.
Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.
Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës “Rruga e Arbërit”, lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK. PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE... BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen **VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE** që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë.
SWift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin “Rruga e Arbërit”, duke skanuar QR Code ose përmes lidhjes: https://tinyurl.com/lcc3e2f

cyan magenta yelloë black